Rruga Arbërit

GAZETË E PAVARUR. NR. 3 (35). MARS 2009. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO

AURORA GROUP

PROJEKTIM - ZBATIM

koha kalon, cilësia mbetet

Autostrada Tirane - Durres, Km.9
Tel: +355 48 30 2046
Tel: +355 48 30 2040
www.auroragroup.com.al
e-mail: auroragroup@auroragroup.com.al

DOKUMENTE

Çfarë dinte Mbreti Zog për veprimtarinë komuniste në Shqipëri?

Nga: **SAIMIR SHATKU** - FAQE 12

"ONE WORLD - NJË BOTË"

Shqipëria përfaqësohet me veshje popullore nga Dibra

Nga: **BEQIR SINA** - FAQE 9

PROFIL

Riza Tefiku - poeti dhe filozofi që ka hyrë në fondin e kulturës botërore

Nga: **MOISI MURRA** - FAQE 13

Shtatorja e Skënderbeut hedh shtat në bronx

Skënderbeu po udhëton drejt vendlindjes. Këtë pranverë mbi shtatin e tij prej bronxi do të derdhen lulet e gjithë kombit. Në studion e piktorit të talentuar Sadik Spahia, dekan i Fakultetit të Arteve, vepra ka kohë që ka mbaruar. Ajo tashmë ndodhet në Bullgari dhe pret që të derdhet në bronx.Shumëkush e di se atëherë kur mundohesh të fikësh qiriun, ai bën dritë më shumë.

Nga **NAIM PLAKU**

Ka disa muaj që nëpër organet e ndryshme të shtypit të shkruar dhe mediave televizive po diskutohen figurat simbol të kombit shqiptar, midis tyre dhe ajo e Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriotit, Skënderbeut. Shumë prej këtyre shkrimeve dhe diskutimeve, ashtu si pjesës më të madhe të shqiptarëve brenda dhe jashtë vendit, këto paçavure kanë lënë një shije tepër të hidhur, që, ndonëse me dashje apo pa dashje, po bëjnë atë që kanë bërë armiqtë tanë këtu e qindra vjet më parë. Ata kanë synuar të fshijnë qëndresën heroike të popullit tonë për liri e pavarësi, ata janë munduar të fshijnë nga faqet e lavdishme të historisë sonë figura të rëndësishme me të cilat mburret e do të mburremi tërë jetën ne, pasardhësit e tyre, ata janë munduar të falsifikojnë historinë, të shtrembërojnë të vërtetën. Më vjen sinqerisht keq që, pikërisht disa njerëz që mbahen të llogores apo të kalemit, ta shndrrojnë kaq lehtë diamantin në karbon.

Mit apo realitet është historia e Skënderbeut?! Historia duhet parë dhe duhet lexuar. Është per të ardhur keq që shumë historianë, duke filluar që nga Barleti e Fan Noli, të cilët ne i mbajmë si më të besueshmit e historisë së Heroit, nuk kanë shkelur kurrë në trojet ku lindi Gjergji, ku ishin Kastriotët, ku ndodhet Sina dhe Gardhi i Poshtëm, ku është ajo, mikrotoponimia, nga më të besueshmet histori të tilla e aq më tepër kur ngatërrohen kaq keq miti me legjendën, legjenda me realitetin.

(Lexoni në faqen 3-4)



FAQE 2



SHENIME

Mysafirë në çadër

Nga: **VESEL HOXHA** - FAQE 10,11

ESE

"Si mësoi, o karrocë e Dylit.."

Nga: **AGRON TUFA** - FAQE 6

SPORT

Gjetan Keta, bëhet kampion i Gjermanisë në KIK dhe TAJBOKS

Nga: **DEFRIM METHASANI**

Faqe 16

"Që Peshkopia nuk ndodhet në të dy anët e Lumit Drin, këtë e dinë jo vetëm vendasit por edhe ndonjë udhëtar i rastit që kalimthi ka kaluar nëpër këtë qytet."

PËRFUNDOJNË ZGJEDHJET VENDORE NË DIBËR TË MADHE

ARGËTIM FIDA: T'ia kthejmë Dibrës qytetarinë e merituar



Në foto: Argëtim Fida dhe Nizamedin Papraniku.

Pas shpalljes së rezultateve zyrtare nga Këshilli komunal zgjedhor, Argëtim Fida, fitues I zgjedhjeve për kryetar komune të Dibrës së Madhe, më date 24 mars 2009, para përfaqësuesve të mediave, deklaroi se: "Falenderoj tërë qytetarët e komunës së Dibrës së Madhe pa marë parasysh përkatësine e tyre etnike e fetare. Të gjithë ata dëshmuan dhe votuan kryetarin e komunës së tyre pa dallim përkatësie partiake, votuan punën, transparencën, votuan atë opsion që garanton ardhmëri më të mirë për Dibrën dhe banorët e Dibrës së Madhe.

Më tej Fida falenderoi Nizamedin Papranikun shefin e shtabit komunal të BDI-së, dhe bartësin e listës për këshilltarë, të gjithë bashkëpunëtorët e shtabit sëbashku me 600 aktivistët e tjerë.

Opsioni ynë, shtoi Argëtim Fida, u dëshmua se garanton ardhmëri më të mirë dhe se është i kapshëm për tërë shtresat e qytetarëve, për intelektualët, biznesmenët, zejtarët, tregtarët, bujqit dhe banorët e vendbanimeve më të largëta. Ne i garantojmë ata se po me këtë intensitet që kemi punuar në katër vitet e kaluara do të vazhdojmë të punojmë edhe në të ardhmen. Ftoj përfaqësuesit e të gjitha partive politike që prezentohen në Këshillin Komunal, që me dinitet dhe për interes të Dibrës të punojnë në katër vitet e ardhëshme dhe Dibrës së Madhe t'ia kthejmë qytetarinë që e meriton", tha në fund Argëtim Fida.

REXHEP TORTE

Vëzhgim

NJË ÇUDI NGA INTERNETI!?

- Peshkopia e paska marrë emrin nga greqishtja!?
- Peshkopia u ndodhka në të dy anët e lumit Drin!?



Një mik i viteve të emigracionit, lexues i pasionuar i gjuhës shqipe, megjithëse ka pesëdhjetë vjet larguar, më thoshte se në qoftë se donë të vlerësosh një enciklopedi apo një libër kërko atë që njeh më shumë.

Më është bërë zakon një gjë e tillë sa herë hap faqet e ndonjë enciklopedie apo futem në internet. Kështu më ndodhi edhe kur një ditë u futa në faqen e www.shqipëria. com. Pashë që në adresën e qyteteve të Shqipërisë ishte edhe qyteti i Peshkopisë. E shtypa "miun" dhe para meje u shfaq:

...Një fotografi që e sheh Peshkopinë pas pemëve të një blloku të vjetër frutorë...

Një tjetër që sheh malet në lindje të ngarkuara me borë me Valivarin e bjeshkët e bardha të Hynoskës...

Një tjetër me një hurdhë uji dhe një mal të panjohur me plloça bore...

Dhe një shënim:

Peshkopia ndodhet në pjesën verilindore të Shqipërisë. Fjala Peshkopi rrjedh nga greqishtja e vjetër "episcopi", që do të thotë residence e peshkopit. Për here të parë është përmendur në një dokument të shekullit të XV. Qyteti është një bazë për të vizituar parkun kombëtar të Lurës si dhe është i njohur për Llixhat (ujërat termale te tij).

Më poshtë...

Peshkopia është qytet në Shqipërinë verilindore. Peshkopia ndodhet në të dy anët e Lumit Drin. Lugina e Drinit është pjesa më e ulët e rrethit. Në afërsi të Peshkopisë ndodhet dhe mali më i lartë i Shqipërisë , Mali i Korabit (2751m)

U befasova. Emrin Peshkopia e paska marrë nga greqishtja e vjetër, nga fjala "episkopi" !?

Gjatë këtyre viteve emigrimi në shtetin Helen di që shumë e shumë shqiptarë (madje edhe prej Dibre, Shkodre apo Tropoje), me falsifikime dokumentesh (duke i ardhur për shtat qarqeve ekstreme vendase) janë bërë "vorioepirotë", kanë ndërruar emër e atësi, janë kunguar në kazanin e priftit dhe janë bërë "ortodoksë". Nuk i akuzoj e gjykoj. E kanë bërë dhe e bëjnë për të mbijetuar ashtu siç e ka bërë në shekuj shqiptari duke e ndërruar fenë nga katolik në ortodoks e më pas në mysliman, madje duke qenë dy vëllezër të një nëne e babai, njeri katolik dhe tjetri mysliman, siç ka ndodhur në Lurë.

Por ajo që më çudit është pse ndonjë intelektual i vendit tim i dashuruar pas fjalëve të huaja e nxjerr Peshkopinë "episkopi", e nxjerr sikur ajo është krijuar nga kisha greke, e shtrinë "vorioepiritizmin" në rrëzë të Korabit?

Nuk e di pse gjuhëtarët tanë nuk e kërkojnë fjalën Peshkopi tek dialekti vendas, ai i fushës dhe i maleve të Dibrës, tek shqiptimi Peshpaj apo Peshpoj që një gjuhëtar dhe historian dibran e lidh me fjalën e drejtshkruar sot: - Pesë-shtëpi, Peshkëpi, Peshkopi...

Shumë fjalë të të folmes dibrane ka ndodhë që të "përkthehen" jo vetëm nga sllavishtja apo nga ndonjë ndikim turk por edhe nga shqipja e thjeshtë. Gjuricasit i thërrasin katundit të tyre Gjuricë në kuptim të gurëve që sjellin Drini i Zi dhe Zalli. Ne, në regjistrat zyrtarë i themi Gjoricë...

Nuk do të vazhdoj më tej, po ia lejë vendin Hajri Shehut të hulumtojë... Tjetër gjë përsëri më mërzit...

Peshkopia ndodhet në të dy anët e Lumit Drin. Lugina e Drinit është pjesa më e ulët e rrethit...

Që Peshkopia nuk ndodhet ***në të dy anët e Lumit Drin***, këtë e dinë jo vetëm vendasit por edhe ndonjë udhëtar i rastit që kalimthi ka kaluar nëpër këtë qytet.

...Kështu ndodh kur historia, gjuhësia dhe gjeografia shkruhen me këmbë...

A. ASHIKU

Lezhë, përkujtohet "Kuvendi i Lezhës"

Në kuadwr tw 565 vjetorit të Kuvendit të Lezhës, dibranwt nw komunwn e Balldrenit u mblodhwn pwr tw kujtuar kwtw ngjarje historike, ku Gjergj Kastriot Skënderbeu mblodhi në Lezhë princat shqiptarë.

Takimi u organizuar nga Zef Doçi e Sefer Koçi, që drejtojnë grup seksionin e shoqatws "Dibra" nw Lezhw me mbwshtetjen e z. Lirim Torba. Veprimtaria u zhvillua mw 1 mars 2009 në restoranti "Drini" të biznesmenit Agim Damsi.

Fillimisht mirëseardhjen e bëri z. Zef Doçi, në emër të Shoqatës Dibra pasi mbulon dhe funksionin e Kryetarit të Shoqatës të Balldrenit. Në këtë mbledhje mernin pjesë bordi drejtues i shoqatës "Dibra", anëtar të Kryesisë së Shoqatës, Kryetarë të lagjeve "Besëlidhja, Kodër Marlekaj dhe Iliria" banorë të këtij komuniteti dhe të komuniteteve të tjera.

Për të përshëndetur këtë takim mori fjalën kryetari i shoqatës "Dibra" z. Fatmir Delishi, i cili i uroi të pranishmit për shumë vite gëzuar, e se ky takim për neve ka një rëndësi të madhe. Gjithashtu ju uroj mirëseardhjen në këtë takim edhe përfaqësues të forcave politike, këshilltarëve dhe veçanërisht Kryetarit të Këshillit të Komunës z. Alfred Gjoni. Gjithashtu në këtë takim e morën fjalën veteranë e banorë të këtij komuniteti duke nxjerr në pah dhe ndonjë problem që e shqetëson këtë komunitet.

Në vazhdim e morën fjalën për të përshëndetur dhe z. Hasan Muça zv. Kryetar i Shoqatës, Ymer Keta sekretar i kësaj shoqate. Gjithashtu përshëndeten dhe z. Lirim Torba, Hasan Kaloçi, Shefik Avdia dhe Asllan Manjani.

Këtij takimi hijeshin ia dhanë grupi i orkestrës që drejtohej nga Pëllumb Rajta dhe rapsodi i mirënjohur Shaban Mëziu, duke kënduar disa këngë, me atë ritin popullor të trevës së Dibrës. Ky takim mbetet si një nga takimet më të rëndësishme të këtij komuniteti, ku do të shërbejë më mirë, për forcimin e unitetit, paqes, tolerancës dhe mirëkuptimit midis nesh, si dhe midis komuniteteve të tjera si atij mirditor, zadrimor e malsor.

Në këtë takim e mori fjalën dhe z. Prena Sejdiaj, duke thënë se për aq kohë sa unë jetoj në këtë zonë, asnjë nga banorët e këtij komuniteti s'ka patur probleme me ligjin apo me pronën. I ndjeshëm qe dhe fjala e veteranes Baftie Marku, e lodhur nga dallgët e jetës por e re me koncepte për jetën, duke porositur që të mos e turpërojmë Dibrën, të punojmë pa u lodhur që traditat e Dibranit t'i çojmë më tej.

Kënga, vallja dhe hareja s'pushuan për rreth dy orë. Tek mokrofoni afroheshin, veteranë, intelektualë, këshilltarë, të zgjedhur në organet vnedore, duke treguar episode për jetën e tyre e lidhjet që ata kanë me komunitetet e tjera. Dibra është shquar për punë, dije e kulturë, përparim e zhvillim dhe trimëri. S'ka qenë e rastit që luftëtarët dibranë të kenë luftuar përkrah forcave progresiste të vëllezërve lezhjanë e shkodranë kundër hordhive serbomalazeze, ku eshtrat e tyre prehen në Kakarriq e në Bërdicë. Këta pra ishin të parët tanë që për atdheun s'kanë kursyer asgjë.

Y.Keta

Posta e Rruga Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 3 (35). 1- 31 Mars 2009

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Redaksia u kujton bashkëpunëtorëve të saj, zotërinjve Viron Kona, Dukagjin Hata, Isa Halilaj, Agron Tufa, Abdurahim Ashiku, Xhelal Roçi, Odise Plaku, Ali Koçeku, Kujtim Boriçi, Ymer Stojkuetj, se shkrimet e tyre, për arsye vendi nuk janë botuar në këtë numër.
Ato do të botohen në numrat e ardhshëm të gazetës "Rruga e Arbërit".

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

DREJTOR:
Rakip Suli

Këshilli Botues:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Bashkëpunuan në këtë numër:
Rexhep TORTE,
Naim PLAKU
Agron Tufa
Abdurrahim ASHIKU,
Beqir SINA
Vesel HOXHA
Selman MEZIU
Moisi MURRA
Saimir SHATKU
Ymer KETA
Qeram CIBAKU
Sakip CAMI
Ymer STOJKU
Defrim METHASANI

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

aktualitet

SHTATORJA E SKËNDERBEUT HEDH SHTAT NË BRONX

Nga **NAIM PLAKU**

Përmendorja e Skënderbeut ka disa ditë që ka shkuar në Bullgari. Skulptori Sadik Spahija ka përfunduar gdhendjen e shtatores. Pak ditë më parë në studion e piktorit në Tiranë kanë qënë disa specialistët bullgarë, të cilët kanë "paketuar" shtatoren e Skënderbeut, për ti dhënë formë përfundimtare në bronx në Bullgari.

Burime pranë grupit organizator thanë se tani po punohet në punimet për gdhendjen e bazamentit të gurit, ku do vendoset shtatorja në Peshkopi. Gjithashtu, burimet nuk mund të konfirmojnë datën e saktë të vendosjes së shtatores, por nuk do jetë e largët dita kur në qytetin e Peshkopisë, ashtu si në shumë simotra të saj europiane, do vendoset shtatorja madhështore e Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Ndoshta në Qershor ose Korrik, Skënderebeut do kthehet në Dibër, jo më si një luftëtar për të organizuar ushtrinë kundër pushtimit osman, por për të qëndruar përgjithmonë mes vëllezërve!



Shtatorja e Skënderbeut gjatë punimit

Ka disa muaj që nëpër organet e ndryshme të shtypit të shkruar dhe mediave televizive po diskutohen figurat simbol të kombit shqiptar, midis tyre dhe ajo e Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriotit, Skënderbeut. Shumë prej këtyre shkrimeve dhe diskutimeve, ashtu si pjesës më të madhe të shqiptarëve brenda dhe jashtë vendit, këto paçavure kanë lënë një shije tepër të hidhur, që, ndonëse me dashje apo pa dashje, po bëjnë atë që kanë bërë armiqtë tanë këtu e qindra vjet më parë. Ata kanë synuar të fshijnë qëndresën heroike të popullit tonë për liri e pavarësi, ata janë munduar të fshijnë nga faqet e lavdishme të historisë sonë figura të rëndësishme me të cilat mburret e do të mburremi tërë jetën ne, pasardhësit e tyre, ata janë munduar të falsifikojnë historinë, të shtrembërojnë të vërtetën. Më vjen sinqerisht keq që, pikërisht disa njerëz që mbahen të llogores apo të kalemit, ta shndrojnë kaq lehtë diamantin në karbon.

Mit apo realitet është historia e Skënderbeut?! Historia duhet parë dhe duhet lexuar. Është per të ardhur keq që shumë historianë, duke filluar që nga Barleti e Fan Noli, të cilët ne i mbajmë si më të besueshmit e historisë së Heroit, nuk kanë shkelur kurrë në trojet ku lindi Gjergji, ku ishin Kastriotët, ku ndodhet Sina dhe Gardhi i Poshtëm, ku është ajo, mikrotoponimia, nga më të besueshmet histori të tilla e aq më tepër kur ngatërrohen kaq keq miti me legjendën, legjenda me realitetin. Më vjen keq gjitashtu, që diskutime të tilla bëhen brenda katër mureve të zyrave, studjove apo podiumeve ku ligjërojnë të ashtuquajturit analistë apo historianë, shqiptarë këta , që nuk kanë shkelur kurrë në ato vende ku gjënden e ku lindën këta mite a legjenda e ku ngulmon një realitet historik i padiskutueshëm.

Shumë kohë më parë, krejt rastësisht u ndodha në një udhëtim që shkrimtari ynë i mirënjohur Sabri Godo po njihej me vendet ku dëshmonte historia për të shkruar më pas romanin e tij për Skënderbeun. Unë aso kohe isha fare i ri, por më bënte përshtypje se si ky burrë kishte marrë mundimin të shkelte në ato vise që gjallëronte ende historia e kryeprijësit në kujtesën e njerëzve, në vendet ku ishin zhvilluar betejat e famshme, në Sinë, në Kalanë e saj, në Qidhën, në fshatin Kastriot e Kuke, në Stelush, në Fushën e Torviollit, tek Jadra e Pashës, tek Fusha e Pelave, në Grazhdan, etj., etj., ku kishte gjurmë të historisë së këtij Heroi, që kohërat e bënë e do ta bëjnë të pavdekshëm, sepse ai nuk është mit as legjendë, por një realitet i gjallë që flet në çdo grykë e në çdo shteg të hapësirë shqiptare nga vinin e hynin turqit për të hequr qafe "**rrebelin kryengritës"** që po i pengonte në marshimin e tyre . Kush s'ka mend, ka këmbë. Historianët tanë e analistët piçirukë flasin me dokumentet e shkrimet e historianëve dhe të albanalogeve të huaj, që erdhën këtu e vite më parë dhe shkelën vend më vend e çdo pëllëmbë toke ku vlonte historia, por ata nuk mund të bënin gjithçka, e, sidomos, nuk mund të bënin atë që mund të bëjë bashaktdhetari, ai që banon e jeton në trojet stërgjyshnore, ai që di ku i vret kalit samari.

Më vonë historiani i mirënjohur Kristo Frashëri u bind se vendlindja e Skënderbeut është pikërisht në Dibër, sepse ai, me hulumtimet e tij, gjeti fijet e asaj historie, që dashakeqët tanë i kishin këputur. Në monografinë e tij voluminoze ai nënvizon faktin se Gjergj Kastriot Skënderbeu ishte i biri i Gjon Dibranit. Historia tashmë e ka ngulitur

Monumenti është gati. Shumëkush e di se atëherë kur mundohesh të fikësh qiriun, ai bën dritë më shumë. Kështu ka ndodhur edhe me Skënderbeun, me shenjtorin e kombit shqiptar, që, kur ndokush mundohet t'ia shuajë apo t'ia zvogëlojë vlerat, ai rritet e rritet gjer në lartësitë e përjetësive të përjetshme.

fort në themelet e saj: " **Skënderbeu ka lindur dhe është rritur në Kastriot të Dibrës, aty ku ishte dhe babai i tij".** Për këtë u ngrit dhe muzeu i trojeve të Palit, Gjinit e Gjon Kastriotit në Sinë të Dibrës, ku u ruajtën gjer vonë dhe disa relika ta kësaj historie. Sot e asaj dite kemi në Sinë dhe toponimin Gardhi i Poshtëm, që përmendet në të gjithë dokumentet



Zaim Krosi dhe Sadik Spahija para shtatores së Skënderbeut

osmane të asaj periudhe dhe një sërë toponimesh e veçanërisht mikrotoponimesh si Kepi i Skënderbeut, Guri i Vashës, Fusha e Pelave, etj.

Në fshatin Kastriot janë një sërë mikrotoponimesh që lidhen me këtë familje. Në rradhë të parë vetë emri i fshatit Kastriot nuk është aq i parëndësishëm apo i rastësishëm në këtë histori. Përse duhet ta kërkojmë diku në Kastrat, Kastër, Has e gjetiu. Kësaj i **thonë ne të tregojmë ujkun e ti na tregon gjurmët.** Përse të lëvizim kaq larg, kur atë e kemi kaq pranë?! Në fshatin Kastriot, 10 km në veri të qytetit të Peshkopisë, është e gjallë dhe e freskët çdo gjurmë e familjes dhe e bëmave të Heroit. Unë po përmend vetëm disa: Kuke, emër fshati nga ishte dhe Pal Kuka, fare pranë fshatit Kastriot, Ferra e Pashës, Troja, Jeliasi, nga thonë dokumentet osmane që është vendlindja e Gjergjit, në fshatin Kastriot, pasi i ati zbriti nga Sina dhe u vendos në këtë vend që ishte më i sigurtë dhe më pjellori në krahasim me Sinën. Pak më përtej është Kodra e Pareve, ku thuhet se aty ishte vendosur thesari i familjes së Kastriotëve dhe ruhej nga njerëzit më besnikë të saj. Po këtu kemi Pusin e Gjinit, Kullën e Gjinit, ende në këmbë pas një restaurimi kohë më parë. Këtu kemi dhe mikrotoponimet Trullishtja (trualli, troja) e Gjonit, Vneshtat e Gjonit, Arat e Gjinit, Gështenjat e Gjinit, përroi i Gjergjit, etj. Këta dhe të tjerë emërtime janë me qindra, por unë përmenda vetëm disa që, lidhen me gjenealogjinë e familjes së Kastriotëve, toponime që shihet qartë se kemi të bëjmë me familjen e Kastriotëve. Njëri ndër këta fise është sot i pranishëm në fshaatin Kastriot dhe kemi të bëjmë pikërisht me fisin Gjini. Pastaj kemi po në këtë fshat fisin Pana, i njohur në kohën e Skënderbeutt, fisin Hasi, Noka dhe Shini. Pjetër Shini ishte nga fshati Brezt i Dibrës, shumë afër fshatit Kastriot, i njohur si trim legjionaar në armatatat e Skënderbeut. Po t'i kërkojmë rrënjët e Skënderbeut, i kemi të gjalla në Dibër të Poshtme dhe në Dibër të Epërme.

M'u dha rasti që të shprehem rreth diçkaje që i ka çoroditur historianët. Unë mendoj se ata nuk do të çoroditeshin aspak, po të kishin parasysh patronimet. Po përmend vetëm disa fise që sot e asaj dite mbajnë emërtimet që na çojnë në epokën e Skënderbeut: Gjini, Kastri, Maneshi, Hasi, Qidhna (Jovan Qidhna), Pana, Gjoni, Kaloshi, Prifti, Bardhi, Përgjergji, Përkola, Përleka, Përnezha, Shpali, Noka, Raska, Tavani, Lusha, Tanushi, Derti, Tota, Koltraka, Gjika, Kacani, Kukeli, Krrashi, Pira, Zogu, Skana, Doçi, Kada, Mena, Buci, Berisha, Gropa, Golemi, etj. Këtu do të veçoja fisin Spata që nuk mund të jetë tjetër nga ai që e kanë përkthyer gabim sipas tingullimit dialektor Spata në Shpata, sepse ky është fisi më i afërt i familjes së Kastriotëve dhe ndoshta më nderuari që la emër në histori duke e ndryshuar sipas keqshqiptimit nga spata në shpata,(Kujto princin Gjin Shpata).

Nuk mund të jetë rastësi që mbi 2/3 e betejave madhore që bëri Skënderbeu janë zhvilluar në Dibër dhe në rrethinat e saj. Historianët tanë që shkruajnë nga studiot e tyre të kërrusur mbi faqe shtypi të zvetënuar duhet të shkelin me këmbë kalatë e famshme, rrënojat e të cilave fatmirësisht po mbijetojnë: në Sinë, në Stelush, në Koxhaxhik, në Zhuparrë, në Trojak, në Grazhdan, në Kojavec, në Voles, në Qidhën, në Lashkizë, në Lurë,etj.,etj. Po përmend një fakt interesant. Në fshatin Lugje, përballë Zall - Dardhës në anën tjetër të Drinit, ndodhen Vorret e Xhorxhe (ose në gjuhën letrare Varret e Gjergjit). Këta, siç shprehen banorët as që mbahen mend, janë varre të harruar. Ndaj ka mbetur dhe shprehja "**si vorret e xhoxhe",** d.m.th. të humbur, varre që s'kanë zotër. Këta ndodhen jo shumë larg vendit që quhet Jadra e Pashës, ku qëndroi në fushim me ushtrinë e tij të madhe Evranozi për të thyer Skënderbeun dhe për të shuar qëndresën shqiptare. Pak më në jug u zhvillua beteja e famshme e Torviollit, ku mbeti e vrarë gati e tërë ushtria turke dhe të gjithë u varrosën në këtë vend, që më vonë u quajtën Vorret e Gjergjit, pra, varret që kishte hapur ushtria e Gjergjit tonë për të mos shkaktuar ndonjë epidemi. Këtë e thoshin dikur pleqtë dhe kështu duhet të jetë e vërteta.

Nuk është vendi të merremi me shumë e shumë fakte të tjera që e çmitizojnë dhe e bëjnë reale figurën e Skënderbeut. Desha të ndalem tek diçka, që edhe nga historianët më të specializuar, më duket se bëjnë një gabim duke e zhvendosur origjinën e Kastriotëve nga Dibra, në ndonjë vend që për plagjiaturë quhet Has.

Fjala **"has",** sidomos në Dibër, është shumë polisemike. Edhe në **" Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe"** nuk janë dhënë të gjitha kuptimet leksikore të saj, bile në ndonjë rast ka dhe pasaktësi. **1. HAS,** ndajf. Tamam, pikërisht, e njejtë me diçka: *Qenka has pambuk (mëdafsh, najlon, lesh, etj...).* **2. HAS/I**, em. bot. Një lloj bime me fije të gjata deri 20-30 cm që rritet në vende të thata e në fillimet e pranverës thahet. *P.sh. U tha hasi.* Ndryshe në Dibër i thonë dhe fang. **HASJA/HASET.**

(Vijon në faqen 4)

Skënderbeu po udhëton drejt vendlindjes.
Këtë pranverë mbi shtatin e tij prej bronxi
do të derdhen lulet e gjithë kombit

SHTATORJA E SKËNDERBEUT HEDH SHTAT NË BRONX

(Vijon nga faqja 3)

Vendi ku rritet kjo bimë: *Po i çoj dhentë nga Haset. U dogj Hasja, etj*. Nga fjala **HAS** janë formuar fjalët **HASËR,** një shtroje që bëhet me fije të gjata hasi të thata dhe fjala **HASËLL**, një korrje e parakohshme pranverore e grurit, thekrës, tërshërës, etj, që thahet e bëhet hasëll për ushqim dimëror ose pranveror për bagëtinë. Në **"Fjalor"** kjo nuk është shpjeguar qartë. Ka dhe një kuptim figurativ për të treguar që një person i qëndron besnik origjinës së tij: *Është has dibran*.

Prandaj emri "**HAS**" nuk duhet kërkuar lart e poshtë, sepse e kemi pikërisht në fushën e madhe poshtë fshatit Kastriot, një fushë e thatë ku rritej e thahej hasi, prandaj është quajtur sot e asaj dite **Fusha e Hasit të Thatë, Fusha e Thatë, Hasi i Thatë.** Duhet të kuptojmë se Sinën me Hasin e Thatë apo Kastriotin i ndan vetëm lumi Drin dhe një urë kalimi mbi të. Po këtu është Gardhi i Poshtëm, Qidhna, Kuket, Brezti, etj.

FRYMËZIM PËR NJË VEPËR MADHORE

I sollëm një pjesë të këtyre patronimeve e mikrotoponimeve sa për të treguar se nuk duhet luhatur në ata diskutimet e famshme **"akademike"** se gjoja Skënderbeu, emri i tij i madh, betejat e tij triumfuese kundër armikut më të madh të qytetërimit evropian na qenkan një mit, një legjendë, apo më keq, përralla për të vënë në gjumë fëmijët. Skënderbeu ka qenë, është e do të jetë realiteti më sublim e më madhështor i shqiptarizmit. Nuk i nxitëm ne ata qindra shkrimtarë, poetë e artistë nga të katër anët e globit ta gdhendin figurën e tij me pene, me tinguj, me daltë e penel.

Ai është madhështor dhe njeri i jashtëzakonshëm që nga kohërat e hisoritritë më bujare për njerëzimin e gjer në në kohërat që na e sjellin aq vigan e madhështor në analet e tyre, siç sollën Krishtin e Muahamedin, Jul Qezarin, Bonopartin apo Robinsonin. Të tillë njerëz historia i pjell rrallë. Por patriotët, ata që luftojnë për të vënë në vendin e merituar figurat e ndritura dhe historitë e kombit, nuk mungojnë.Ndaj dhe erdhi, ashtu i qeshur e i gëzuar, plot humor e këngë, plot pasion e dashuri, plot respekt e krenari për ta sjellë në Dibrën ku lindi dhe u urrit, ku u edukua dhe u kalit Heroi ynë, që ne e quajmë e do ta ta quajmë sa të jetë jeta, Hero Kombëtar. Ky njeri me një kulturë të gjërë, me një përkushtim të thellë, me një dashuri të pakufishme dhe një krenari legjitime për të parët tanë, bëri atë që ndoshta as shteti dhe shoqëria jonë nuk do ta bënte. Ishte një nismë individuale, një nismë që buronte nga shpirti i një patrioti të flaktë për vendin dhe vendlindjen që të bënte çmos që një monument madhështor për Heroin tonë kombëtar, Gjergj Kastriotin - Skënderbeun të ngrihet dhe të vendoset në Dibër, aty ku ka le. As që mund të merret me mend sakrifica e këtij njeriu, që ndonëse i pamundur për të ndjekur e bërë punë të tilla, ka udhëtuar natë e dite, dhjetëra herë, për të gjetur në rradhë të parë artistin që do të gdhendëte përmendoren e pastaj për ta ngritur këtë shtatore në mes të qytetit të Peshkopisë, para Pallatit të Kulturës, simbolin e rezistencës për çlirim kombëtar.

Ky është Zaim Korsi, biri i denjë i Dibrës, një patriot që do ta kishte zili gjithkush, një njeri i pajisur me dijet dhe shijet artistike të kohërave moderne, një altruist, njeri i arsimuar dhe i përgatitur për sfidat e artit bashkëkohor, që shkriu një pjesë të pasurisë së tij për të vënë në pjedestalin e nderit një figurë kombëtare, me të cilin krenohet bota. Kur po bëheshin këta **"diskutimet e famshme"** atij as që i kishte shkuar mendja se po diskutohej për Heroin, se ajo që kishte menduar ishte nisur tashmë e do të merrte udhë.

Në studion e piktorit të talentuar Sadik Spahia, dekan i Fakultetit të Arteve, ka kohë që vepra ka mbaruar.Ajo tashmë pret që të derdhet në bronx. Është një vepër monumentale me bazament guri 1.8 m i lartë. Është një shtytje përkushtimi e këtij artisti, i këtij skulptori, që kjo vepër të realizohej ashtu siç kishte dëshirë sponsorizuesi, Zaim Korsi. **"Mos lë gjë mangut, i dashur Sadik"!** – i thoshte një ditë Zaimi. **" Do të shkojmë në Dibër, në minierat e mermerit, të gjejmë gurin më të bukur për të vendosur monumentin e Heroit. Dhe shkuan e shetitën mal më mal, deri sa gjetën gurin e përshtatshëm, bazamentin e mermerit prej 60 kv që së bashku me të, shtatorja madhështore e një bukurie të veçantë të ngrihet lart e më lart në ata male ku shkëlqeu lavdia e tij"**

Zaimi ka thirrë herë pas here në studjon e skulptorit për të thithur mendimet më të specializuara të artistëve, historianëve, arkitektëve, etj.

Monumenti është gati. Shumëkush e di se atëherë kur mundohesh të fikësh qiriun, ai bën dritë më shumë. Kështu ka ndodhur edhe me Skënderbeun, me shenjtorin e kombit shqiptar, që, kur ndokush mundohet t'ia shuajë apo t'ia zvogëlojë vlerat, ai rritet e rritet gjer në lartësitë e përjetësive të përjetshme.

Ja pra, që historia është kaq bujare, që të mërr dhe të jep. Ja pra, që na del një patriot si Zaim Korsi dhe një talent si Sadik Spahija që përjetëson e lartëson figurat që nderojnë kombin.

Keni për të parë... Skënderbeu po udhëton drejt vendlindjes. Këtë pranverë mbi shtatin e tij prej bronxi do të derdhen lulet e gjithë kombit. Do të shikoni dhe dorën e tij të fuqishme që na përshëndet e duket sikur na thërret:

— Lirinë e gjeta mes jush. Ju, stërnipërve të mi, ju takon ta ruani si sytë e ballit!



Një kuvend historik

Nga: **YMER STOJKU**



Rruga e Arbërit nga ëndërr po bëhet realitet. Po ofron mundësi biznesi dhe zhvillimi për rrethin e Bulqizës

Hapja e dritës jeshile pas disa shekujsh për ndërtimin e Rrugës së Arbrit na mbushi me gëzim e krenari. Dhe kjo është meritë kryesisht e Shoqatave dibrane. Kuvendi shkencor i mbajtur në majt të vitit 2007, ishte një nga eventet më të rëndësishme të këtyre shoqatave. Ky do të mbetet një kuvend historik si për projektet dhe variantet më optimale për të ndërtimin e saj, ashtu edhe për mundësitë e zhvillimit e të biznesit që ofron me ndërtimin e saj. Ndaj unë nga lartësitë e viteve përshëndes dhe përgëzoj për këtë kontribut të madh që kanë dhënë gjithë intelektualët e shquar të kësaj shoqate me tituj e grada shkencore si Prof. Dr. Valter Shtylla, Dr. Inxhi, Faruk Kaba, inxhi. Piro Bedo, Prof. Dr. Bashkim Lleshi, inxhi. Tefik Jegeni, Dr. Organ Sakiqi, Mcs Ekon Edmond Alite, Dr. Vesel Hoxha, Prof. Dr. Ilir Alliu, inxhi. Sefedin Shabani, Dr. Naim Karaj etj. Përshëndes gjithashtu edhe Kryetarin e Shoqatës së Lidhjes së Intelektualëve Dibranë zotin Nuri Abdiun me gjithë stafin e tij drejtues.

Por Kuvendi tekniko-shkencorë i majit 2007 do të mbetet historik edhe për faktin se me ndërtimin e kësaj rruge do të hapen perspektiva të mëdha zhvillimi e biznesi gjithë këtyre zonave e rajoneve nga ku ajo do të kalojë dhe në mënyrë të veçantë për rethin e Bulqizës, si rezultat i vënies në qarkullim ekonomik i të gjitha atyre pasurive të çmuara që fsheh toka dhe nëntoka e këtij rajoni.

Mbi bazën e këtyre studimeve e projektimeve të kryera nga këto intelektualë të shquar që përmendëm pak më lart si dhe të mbështetjes nga ana e shtetit shqiptar, duke siguruar firma e investitorë të fuqishëm për ndërtimin e saj, u bë e mundur fillimi i punimeve për ndërtimin e saj në segmentimin e saj, u bë e mundur fillimi i punimeve për ndërtimin e saj në segmentin e rajonit të Bulqizës qysh në pranverën e vitit 2008.

Ky fakt jo vetëm na mbush me gëzim, por na bën optimistë dhe na ngjall shpresat se tashmë në një të ardhme jo shumë të largët po bëhen realitetet ëndrrat dhe dëshirat e dibranëve dhe e të tjerëve për të ecur së shpejti në një rrugë të tillë me parametra evropiane. Kjo sipas parashikimeve do të shkurtojë shumë distancën Dibër-Tiranë nga 183 km, në 75 km. Jo vetëm kaq. Ky aks rrugor, duke kaluar sipas projekteve nga Qafa e Buallit, Ura e qytetit, ura e Çerenecit-Gjoricë e më tej në Dibër të Madhe Maqedoni e gjerë në Bullgari, do të bëjë të mundur lidhjen e Shqipërisë me vendet e lindjes përmes Portit të Durrësit. Duke kaluar nëpër këto zona e rajone, ajo sikurse thamë, do të hapë perspektiva të mëdha zhvillimi e biznesi dhe do të ndikojë fuqishëm për zhvillimin e gjithanshëm të tyre.

Megjithëse puna akoma është në hapat e para dhe mbetet edhe shumë për të bërë, edhe unë si dibran dhe qytetar i këtij vendi, që e kam shkelur vite me radhë këtë vend, e ndjej të nevojshme që të shfaq disa mendime se çfarë mundësish dhe shance të mëdha ofron për biznesmenët dhe zhvillimin ekonomik të vendit, vënia në qarkullim ekonomik e këtyre pasurive të çmuara të rajonit të Bulqizës.

Në radhë të parë vëmendja duhet përqendruar sipas meje në rifillimin sa më parë të punimeve minerale në ato vendburime kromi që vazhduan me punime deri në vitin 1990. Dhe të tilla, sipas projektit janë: Objekti Zabeli në veri të fshatit Vajkal, Maja e Bregut po këtu, Mali i kuq në Juglindje të hidrocentralit nr. 2 të Fushë-Hutrës etj.

Por rajoni i Bulqizës është i pasur edhe në pasuri të tjera të çmuara të materialeve të ndërtimit, në ato ujore etj. Kështu, siç dihet tek Ura e qytetit ndodhet një mal i tërë me gurë gëlqerorë, që e bënë të domosdoshme ndërtimin e nj fabrike të madhe çimentoje.

Te 3 çezmat e Soroçanit është gjithashtu një mal tjetër me gurë gëlqeror, ku në të kaluarën kanë qenë ndërtuar disa furra gëlqereje. Edhe këtu mund të ndërtohet një linjë e fuqishme për prodhim gëlqereje.

Në Zallë-Sopot ka sipërfaqe të gjera tokash argjilore për prodhim tullash e tjegullash në sasira të mëdha. Edhe këtu dikur banorët kanë pas prodhuar tjegulla vendi. Edhe ky shans nuk duhet të shpëtojë pa u shfrytëzuar.

Në ish-guroren e fshatit Strikçian ndodhen rezerva të mëdha rëre granili shumë e kërkuar për ndërtim, e cila e bënë të domosdoshme ndërtimin e një linjë të tillë për shfrytëzimin e saj.

Rezerva të mëdha rëre për prodhim inertesh etj., ndodhen mbi Urën e Çerenecit, gjë që është me interes dhe shumë fitimprurëse për biznesmenët vënia e kësaj pasurie në qarkullim ekonomik.

Veç këtyre rrethi i Bulqizës është i pasur edhe në bimë të shumta mjekësore, në rrëshirë dhe esencë pishe, në vende të përshtatshme pë zhvillimin e bletarisë etj. Ndaj kërkohen studime, fonde dhe ngritja e linjave të ndryshme për vënien e tyre në qarkullim ekonomik, si në krahinën e Grykës së Madhe, të Gollobordës, Okshtunit etj.

Liqeni i Zi i Tërnovës gjithashtu është një pasuri tjetër me vlerë, si për prodhim rosash, peshku, ashtu edhe për turizëm dimëror etj.

Një pasuri tjetër me vlera të mëdha është dhe ajo ujore. Për fat të mirë rrethin e Bulqizës e përshkojnë dy lumenjtë, zalli i Okshtunit dhe ai i Bulqizës. Në këto dy lumenj mund të ndërtohen disa hidrocentrale të vegjël. Por unë do të sugjeroja sae më me leverdi dhe kosto më të ulët do të ishte ndërtimi i një hidrocentrali me kapacitet të madh për furnizim me energji elektrike gjithë rrethin e Bulqizës. Dhe ky vend ndodhet te ish Ura e vjetër në afërsi të fshatit të Çerenecit të Epër dhe në fundin e arave të Mallakastrës në veri, në ngushticën e Zallit të Okshtunit. Por ky vend duhet prapë me kujdes, sepse mendoj se do të ketë një kosto më të lirë. Veç kësaj edhe nga liqeni artificial që do të krijohet do të mund të sigurohen rezerva të mëdha peshku.

Shfrytëzimi dhe vfënia në qarkullim ekonomik i këtyre pasurive jo vetëm do të jenë shumë fitimprurëse për biznesmenët e ndryshëm, por do të bëjë të mundur edhe hapjen e shumë vendeve pune për njerëzit dhe do të ndikojë fuqishëm në rritjen e mirëqenies dhe nivelin e jetesës së këtyre banorëve.

Për opinione dhe komente mund të na shkruani në adresën: "rrugaearberit@gmail.com". Tel. 00355 4 22 33 283.
OPINIONET DHE KOMENTET E BOTUARA NUK SHPREHIN DOMOSDOSHMËRISHT QËNDRIMIN E REDAKSISË

intervistë

Mes shumë dibranëve që japin kontributin e tyre në qeverisje, është edhe Shpëtim Cami, nënkryetar i njësisë bashkiake Nr.1, Tiranë. Në një intervistë për gazetën "Rruga e Arbërit" ai vë në dukje pikërisht këtë kontribut

Faktor të bën nevoja e përbashkët



Pyetje: Prej dy vjetësh jeni nënkryetar i Njësisë Bashkiake nr.1, Tiranë. Si e gjetët njësinë dhe çfarë keni ndryshuar?

Përgjigje: Në këtë funksion erdha pas një përvoje prej 8 vitesh (1992-2000) si anëtar i Këshillit të rrethit Kurbin dhe 7 vjet (2000 – 2007) si kryetar i Këshillit të Njësisë Bashkiake nr 1. Kjo përvojë më ndihmoi që të vija në zbatim idetë që unë kisha shfaqur në pozicionin e vendimmarrësit dhe këshilluesit dhe tashmë përballë mijëra qytetarëve duhej të bëja zbatuesin. Bashkia Tiranë dhe Njësitë Bashkiake të Tiranës janë organizuar dhe funksionojnë me ligj të veçantë kështu që hapi i parë ishte të informonim qytetarët për konpetencat tona, për administratën tonë, detyrat e saj, aktet ligjore që vinin nga organet më të larta si Parlamenti, Këshilli i Ministrave, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Prefektura Tiranë, Bashkia Tiranë etj. Hapi i dytë ishte trajnimi i administratës dhe rritja e nivelit të saj. Nga 25 punonjës, vetëm dy prej tyre gëzonin statusin e nëpunësit të shërbimit civil. Tani të gjithë punonjësit e kanë fituar këtë status dhe ndjehen nëpunës shteti. Hapi i tretë ishtë administrimi i të gjitha kërkesave dhe nevojave të banorëve dhe njohja e gjithë problematikës së kësaj njësie të pushtetit vendor. Gjëndja e Njësisë Bashkiake nuk përputhej me këtë mendësi të re. Për këtë qëllim, që në ditët e para botuam gazetën "Tribuna Qytetare" me informacion të shumtë për banorët. Që prej dy vjetësh tani ka dalë në botim numri 30. Kryetarja e njësisë dhe unë, në cilësinë e nënkryetarit, që prej dy vjetësh nuk kemi orar pritje, por në çdo kohë jemi në shërbim të qytetarëve, bile edhe jashtë orarit të punës. Çdo ditë zgjidhim problemet që kanë të bëjnë me kompetencat tona, udhëzojmë, këshillojmë, sugjerojmë, shkruajmë edhe vetë në kompjutër kërkesat e tyre duke bërë rolin e avokatit dhe kështu gjatë gjithë kohës jemi pranë tyre. Kjo kërkon shumë energji, por deri tani e kemi përballuar. Edhe në administratë kemi krijuar frymën komunikimit me çdo qytetar.

Pyetje: Megjithëse Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë ligjin e legalizimeve, në njësinë tuaj që ka shumë objekte informale a ka nisur ky proces apo jo?

Përgjigje: Njësia jonë në rreth 2/3 e teritorit të saj është zonë informale. Sektori ynë i Infrastrukturës dhe Kontrollit Urban bëri një punë voluminoze vullnetare për të plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të banorëvë që kishin aplikuar. Pas gjithë kësaj pune në terren dhe në zyrë një ditë të bukur Agjensia e legalizimeve mori të gjithë dokumentacionin e këtij procesi dhe që nga ajo kohë ne nuk kemi asnjë informacion zyrtar se çfarë bëhet me legalizimet përveç TV dhe gazetave si çdo qytetar tjetër i Tiranës.

Pyetje: Në Tiranë ka një komunitet të madh dibranësh të cilët kanë ardhur vitet e hershme. Në njësinë tuaj shumica ka ardhur pas viteve '90. Sa janë integruar ata në jetën qytetare të metropolit?

Përgjigje: Integrimi është një proces që zgjat në kohë por nga natyra dibranët e kanë cilësinë e integrimit dhe kjo më ka bërë të ndjehem mirë edhe mua si dibran. Konstatoj që ata trokasin kudo, janë të prirur për tu arsimuar, e kërkojnë njëri – tjetrin, janë të gatshëm të marrin pjesë në çdo aktivitet kulturor, artistik, politik etj. Duke patur parasysh që harta e Dibrës shtrihet nga Kalaja e Dodës e deri në Steblevë, Njësia Bashkiakr Nr. 1 ka komunitetin më të madh të Gollobordasve në Tiranë. Kur u bënë zgjedhjet lokale në vitin 2000, në njësinë tonë bashkiake të dy drejtuesit e këshillit ishim dibranë, unë dhe Lulzim Çela edhe kryetarja e grupit të këshilltarëve ishte dibrane. Edhe sot në këshill ka shumë dibranë, gjë që tregon për integrimin e tyre në shoqërinë e sotme demokratike.

Në këtë botim paraqes para lexuesit konceptin tim për punën, politikën, administratën, shoqërinë, historinë. Jam i drejtpërdrejtë me shembuj nga jeta ime dhe e atyre që kanë punuar me mua. Jam përpjekur të jem mes njerëzve dhe realitetit që më ka rrethuar dhe më rrethon çdo ditë. Jam përpjekur të jap një model ndërmjet mijërave që na rrethojnë dhe që heshtin.



Pyetje: Çfarë është bërë nga ana juaj për adresat e shtëpive? Po emërtesat e rrugëve?

Përgjigje: Në zbatim ligjit dhe urdhërit të urdhërit të Ministrit të Brendshëm për sistemin e adresave, tek njësia jonë unë u caktova kryetar i grupit të punës për emërtimin e rrugëve. Ndoqa një rrugë demokratike duke zhvilluar disa konsultime me ndërlidhësit me komunitetin dhe banorët. Propozimet u bënë të lira dhe të motivuara duke respektuar kontribute njerëzore në vite dhe të njohur nga historia. Duhej të emërtonim rreth 84 rrugë. Sigurisht këto propozime ju paraqitën këshillit të njësisë bashkiake. Me vendimin nr.13 datë 26.09.2008 këshilli i miratoi të gjitha propozimet tona dhe ju dërguan për miratim përfundimtar Këshillit Bashkiak të Tiranës. Ky këshill me vendimin nr.41 datë 29.09 2008 ka miratuar vendimin tonë pasi është konfirmuar edhe nga Prefektura e Tiranës me shkresën nr 2260/1 datë 27.10.2008. Me këtë rast dëshëroj të bëj me dije opinionin dibran dhe për këtë ndjehem mirë që me propozimin tim një rruge në njësinë tonë bashkiake i është vënë emri RRUGA "KONGRESI I DIBRËS" . Tani shumë banorë të lagjes "Ali Demi" do ta kënë në adresën e tyre emrin "Kongresi i Dibrës".

Pyetje: Janë krijuar mjaft shoqata dibrane në Tiranë por dhe jashtë saj. A ka ardhur koha të ngrihet dhe një lobim i cili të dalë mbi shoqatat dhe partitë politike ku në një të ardhme të bëhet vërtet faktor?

Përgjigje : Kam lexuar që ka shumë shoqata dibrane. Unë jam anëtar i Lidhjes së Intelektualëve Dibranë dhe kam marrë pjesë sa herë jam ftuar. Një aktivitet që më ka lënë mbresa shumë të mira ka qënë Kuvendi "Rruga e Arbrit" për të cilin të qënit dibran më bën krenar. Aty ishin së bashku të gjithë dibranët pavarësisht nga anëtarësia në shoqata apo parti të ndryshme. Në këtë kuptim koha për të qënë së bashku ekziston sa herë ka nevoja të tilla si ajo e Rrugës së Arbrit. Faktor të bën nevoja e përbashkët, jo dëshira. Ndërkohë që secili duhet të aderojë aty ku ndjehet mirë.

Pyetje: Sivjet është njëqind vjetori i Kongresit të Dibrës. Kush duhet ta organizojë këtë jubile të madh sipas mendimit tuaj. Shoqatat apo vetë qeveria.

Përgjigje: Jam informuar për këtë veprimtari nëpërmjet Kryetarit të Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, Nuri Abdiu dhe nga gazeta "Dibra". Për mua dhe gjithë dibranët, e rëndësishme është që ky 100 vjetor të përkujtohet siç e meriton dhe të pasurohet më tej historia e tij. Do të ishte në nderin e qeverisë, të akademisë së shkencave dhe të të gjithë shoqatave dibrane që ashtu si në rastin e "Rrugës së Arbrit" të kontribuonin në këtë aktivitet shumë të rëndësishëm për ne dibranët. Unë jam i gatshëm të kontribuoj sa të mundëm për këtë ditë historike.

Pyetje: Deri dje një ëndërr e dibranëve, tashmë jemi pranë realitetit. A besoni se Rruga e Arbrit do të përfundojë me këto përmasa dhe pa e devijuar projektin?

Përgjigje: Besoj se rruga jonë do të bëhet. Koha e përfundimit dhe ecuria e projektit kam vënë re se janë bërë shpesh objekt debati. Tek ky debat buron edhe besimi im. Dibranët janë aq të mençur që ashtu siç bënë Kongresin e Dibrës apo Kuvendin "Rruga e Arbrit" të dinë të lobojnë edhe për të përfunduar me sukses një projekt.

Pyetje: Lexuesi shqiptar është njohur me librin tuaj "KANADA". A do të presim ndonjë libër tjetër nga ana juaj?

Përgjigje: Sapo ka dalë këto ditë në qarkullim libri "Njerëz dhe Realitete" me rreth 240 faqe me ilustrime. Aty paraqes para lexuesit konceptin tim për punën, politikën, administratën, shoqërinë, historinë. Jam i drejtpërdrejtë me shembuj nga jeta ime dhe e atyre që kanë punuar me mua. Jam përpjekur të jem mes njerëzve dhe realitetit që më ka rrethuar dhe më rrethon çdo ditë. Jam përpjekur të jap një model ndërmjet mijërave që na rrethojnë dhe që heshtin. Këto lloj botimesh që unë kam paraqitur para lexuesve deri tani kanë të bëjnë me faktin që unë vazhdoj jetën aktive. Që nga viti 1991 jam votuar në drejtime të ndryshme kështu që ka qënë në konceptin tim që, atyre që ju kërkoj votë t`ju them së pari kush jam, nga vij dhe ku shkoj. Çfarë kam bërë dhe çmund të bëj. Ndaj dhe ju prezantohem herë pas here. Ju jap jap shëmbuj nga jeta jonë dhe përvoja ndërkombëtare që ata pastaj, të mund të zgjedhin. Lexoni librin e presidentit amerikan Barak Obama " Guximi për të shpresuar" dhe do të bindeni sa larg jemi ne në konceptin e prezantimit para publikut kur kërkon që të jesh një njeri publik.

Pyetje: Jeni një lexues i rregullt i gazetës "Rruga e Arbrit". Mendimi juaj për këtë gazetë dhe a e ka kryer deri tani misionin e saj.

Përgjigje: Gazeta "Rruga e Arbrit" është një kontribut i çmuar në historinë dibrane dhe asaj kombëtare. Misioni i saj për të na dhënë informacion për Dibrën dhe dibranët ka qënë shumë i mirë. Unë e lexoj me kujdes dhe mësoj prej saj. Gjithashtu ajo ka luajtur një rol të padiskutueshëm edhe për rritjen e zërit dibran për problematika që i shqetësojnë banorët dhe kanë gjetur zgjidhje. Përvojat pozitive të qeverisjes lokale nuk kane munguar. Po kështu krijimtaria letrare dhe historia e figurave dibrane ka qënë prezente ne gazetë. Meqë "Rruga e Arbrit" fillon në Tiranë dhe përfundon në Dibër të Madhe, mendoj që edhe gazeta të përfshijë gjithë këtë rajon dhe pse jo, le të kontribuojmë të gjithë që të mund ta bëjmë një gazetë kombëtare. Kështu unë kam vetëm fjalë të mira dhe uroj të ecni në këtë rrugë duke ju falenderuar për mundësinë që më dhatë sot të komunikoj me lexuesit e shumtë të kësaj gazete.

Bisedoi: Shaqir Skarra

Rruga Arbërit nr. 35
kujtesë

Nxënës dhe veteranë të arsimit bënë homazhe dhe vunë kurora me lule mbi varrin e patriotit, teologut, iluministit dhe mësuesit të popullit Said Najdeni, alias Hoxhë Voka.

DIBËR E MADHE - U SHËNUA 7 MARSI, DITA MËSUESIT

Homazh mbi varrin e iluministit Said Najdeni

Solemnisht në Dibër të Madhe u shënua 7 Marsi-Dita e mësuesit. Udhëheqës të pushtetit vendor, arsimtarë, nxënës dhe veteranë të arsimit, bënë homazh dhe vunë kurora me lule mbi varrin e patriotit, teologut , iluministit dhe mësuesit të popullit Said Najdeni, alias Hoxhë Voka, i cili tërë jetën e tij e vuri në shërbim të atdheut, të pavarësisë dhe të përhapjes së shkollave shqipe në Dibër të Madhe e më gjerë.Jeta e këtij patrioti, teologu dhe iluministi qe e shkurtër, por e mbushur plot me sakrifica e burgosje.Në fjalimet e tij nëpër trojet shqiptare, thoshte"Do vijë dita që bilbilat dhe te ne të këndojnë lirisht në gjuhën shqipe.Nuk duhet të rimë në gjumë, duhet të bashkohemi, të vëllazërohemi, të lidhim besë për të mbrojtur atdheun dhe nderin e shqiptarit". Said Najdeni (1868-1903) autor i Fe-Rrëfenjëses së Muslimanëve dhe i Abetares së gjuhës shqipe, është sinonim i arsimit shqip dibran dhe mbarëkombëtar.

Pas udhëtimit me Ismail Qemalin në Tripoli, u këthye në Dibër të Madhe i rraskapitur dhe i sëmurë rëndë dhe vdiq në moshën 35 vjeçare, më 21 nëntor 1903.Para se të ndërojë jetë la amanetin, "Në vorrin tem mos më vini gurë derisa të çlirohet Shqipnia, dhe kur të fitohet liria, i vini gurët tue mi shkrue shqip.Në këto gurë ngulni flamurin e kombit me shqipen dykrenore". Këtë amanet dibranët ia kanë plotësuar me kënaqësi.

Pëllumb Frangu, drejtor i Shkollës fillore "Said Najdeni", me këtë rast , tha se:"Përkujtojmë Said Najdenin mësuesin tonë të madh I cili gjithnjë na jep frymëzim dhe shembuj krenarie dhe atdhedashurie.Vet vepra e tij na udhëzon si duhet të punojmë për gjuhën, për shkollën, popullin dhe atdheun.

Argëtim Fida, kryetar i komunës, shtoi se:"Nxënia është forca e vetme që do të na xjerr nga kjo apati.Ju që edukoni gjeneratat e reja dhe ne si pushtet vendor, do të krijojmë kushte të mira për ju dhe nxënësit, që Dibrës t'ia kthejmë shpresën dhe traditën e arsimdashurisë me çka ka qenë shembull në trojet shqiptare.Shumë shpejt në qytetin tonë do të kemi edhe arsim sipëror".


Në foto: Homazh te varri I Said Najdenit

Shkolla fillore "Said Najdeni" dhe Shkolla fillore "Vllazrim Bashkim" për nder të 7 Marsit shfaqën një program kulturor artistik me ekspozita vizatimesh, me këngë valle e recitime.

Rexhep TORTE

Ese

"Si mësoi, o karrocë e Dylit.."

Nga: **AGRON TUFA**

Sapo u ulëm në aeroportin "Nënë Tereza", unë dhe miku im ndjemë se hapësira psikologjike e terminalit tallazitej nga një shqetësim i fshehtë. Njerëzit flisnin me zë të ulët, thuajse me pështpërimë, me gjeste e me fjali të papërfunduara, prej të cilave nuk mund të kuptoje farë gjëje. Të vetmet fraza me zë të lartë të policëve dhe nëpunësve të shërbimit, fërkoheshin, ndizeshin e fikeshin me vrull në ajrin e shqetësuar: "Shpejt, shpejt, shpejt!"; "hape krahun"; "drejt daljes!"; "bagazhet në kontroll"; "hiqni xhaketat, orët, kuletat, rripat, sendet metalike!" etj. Tek-tuk, ndonjë polic hapte radion dhe dëgjohej raportimi energjik: "Po! Po! Po! Situata nën kontroll!"; "Lajmërova Qendrën!"; "Siurdhëron, shef! Marrje!"; "Jemi në ndjekje të precedentit!".

Te kontrollori i bagazheve pyetëm një nëpunëse të zellshme e vigjilente:

- Si ndodhi zonjushë?

- S'ta shpjegoj dot... - tha, duke kryer një grumbull gjestesh pa lidhje. – Por ju mund të pyesni më mirë Uniformat Blu. Ata e dinë.

Në dalje miku im iu drejtua në mirëbesim një polici, i cili sapo mbaroi së foluri me "Qendrën".

- Çfarë ka bërë vaki more mik?

- Me vjen keq, nuk jam i autorizuar të flas. Pyesni më mirë bluzat e bardha.

Të zhgënjyer e kuriozë, bëmë drejt taksive dhe sapo u rehatuam në sendilje, pyetëm shoferin thuajse në një gojë:

- A di gjë ç'ka ngjarë more burrë? Këtu s'të përgjigjet askush.

- Valla-hi, e rëndë, por hajt ma...

- Për se është fjala?

- Valla-hi, - shtërzoi me përtesë shoferi, një xhaxho i ngeshëm zeshkan, - s'po ia di una fillin. Ishëm tu pa neshjen: bardhë-e-blutë me demat e kuq - dhe s'pata kohë me pa lajmet.

- Po për çfarë është fjala? Për vrasje, aksident, kontrabandë... çfarë fatkeqsie?

- Ku di gja una mër çun... Por thonë (tashi nuk e di sa osht e vërtet, por thonë), se njana na kto trija qi përmene tina ka ndodhë... hec mo.

- Kush thotë? Ty të thanë gjë, për shembull?

- Skuadrat e gjelbra. Kishin lënë punën ene kishin dalë m'b'rrugë. Ata e kishin pa mqinën e ambuloncës...

- E di çafrë ke ti, na e ndiz radion të kapin ndonjë lajm, o burrë, - nuk iu durua mikut tim.

Shoferi kërkoi stacionet dhe u ndal në njërin prej tyre, ku raportonte shkurt, energjikisht e me përgjegjësi folësja, e ndërprerë në fund nga tinguj të rëndë si varé:

"...Dora e zezë e krimit goditi sot pasdite terminalin *"Nënë Tereza"*. **Rryt!** Emisarët e vdekjes kanë shtënë në darë të hekurt për 20 minuta pistën e fluturimit dhe ambientet e shërbimit, duke mbjellë terror e pasiguri për jetën e pasagjerëve. **Rryt!** Sipas burimeve të besueshme mësohet se preja e antarëve të bandës "Skifteri" është një nga bukuroshet pjesëmarrëse në spektalin "Miss Bota". **Rryt!** Gjatë operacionit të pasuksesshëm janë lënduar dy uniforma blu, të cilat, siç na informojnë Bluzat e Bardha nga spitali *"Nënë Tereza"*, janë në rrezik për jetën. **Rryt!** Skifterët së bashku me prenë janë larguar drejt kaltërsive të Adriatikut. **Rryt!** Menjëherë në vendin e ngjarjes ka mbëritur Kryespiuni i shërbimit sekret shqiptar. **Rryt!** Ndërsa kreu i Selisë Rozë, ka mbledhur simpatizantët në një miting proteste në sheshin *"Nënë Tereza"*. **Rryt!** Ai ka akuzuar drejtuesit e Rendit për sjellje të mefshtë e të papërgjegjshme, gjë e cila i jep një goditje tjetër të rëndë imazhit tonë në sytë e Europës. **Rryt!** Shefi i opozitës ka aluduar se vullneti i Selise Blu për të luftuar krimin ka qenë veçse një fiasko dhe demagogji elektorale. **Rryt!** Këtë e vërteton mungesa e dënimeve nga Togat e Zeza". **Rryt! Rryt! Rryt!**

"Kreu i diplomacisë sonë sqaroi sot para pushtetit të katërt keqkuptimet e krijuara në lidhje me statusin e shtetit më të ri të Ballkanit. **Rryt!** Ai tha se "nuk mund të kritikoj në armën e tij më të fortë që nga fëmijëria: dashurinë dhe vetëm dashurinë mitike që i kanë edukuar gjyshërit ndaj vëllezërve tanë të shtetit që pritet të marrë pavarësinë. **Rryt!** Kreu i Kremlinit dhe i Shtëpisë së Bardhë duhet të shohin një deklaratë të ekuilibruar që, në fakt, gjen pikëtakimin psiko-mental në Bruksel. **Rryt!** Së këndejmi, deklarata ime kushtëzohet nga temperatura e politikës rajonale, europiane e më gjerë. **Rryt!** Opinionet e nxituara të të vetëquajturve "ambasadorë kulturorë", duhen marrë si viktima naive të hipersensibilitetit metafizik. **Rryt!** Ne na duhet t'i qasemi problemit me delikatesë dhe në mënyrë pragmatike, theksoi Kryediplomati shqiptar, duke e siguruar pushtetin e katërt se nuk ka asnjë kontradiktë midis qëndrimit të tij dhe të Kryeministrit për këtë çështje". **Rryt! Rryt! Rryt!**

Zëri i folëses u zëvendësua nga një zë i theksuar, gripal dhe hundor:

"Labi sulmues, fantazisti i Kuq-e-Zinjve i ka dhënë fitorën në shtëpinë e tij ekipit të Vestfalisë lindore ndaj skuadrës kryesuese bavareze, duke ngjitur kësaj herë dy shkallë më lart në superioren e Bundesligës gjermane. **Rryt!** Në Apenine Zi-kaltrit kanë fituar në transfertë minimalisht, në sajë të një penalltie të realizuar me mjeshtëri nga perandori brazilian. **Rryt!** Demat e kuq e kanë mbyllur me rrjeta të paprekura përballjen me të kaltrit e rusit Abramoviç. **Rryt!** Skuadra veriore u ka shkulur një dypikësh të çmuar bregdetarëve. **Rryt!** Ka qenë një predhë e Gary Mylerit shqiptar, e lëshuar në minutën e 89-të ajo që ka shkatërruar ëndrrat e bregdetarëve. **Rryt!** Tashmë veriorët buzëqeshin të vetëm në ndjekje të kryeqytetasve. **Rryt! Rryt! Rryt!**

- Kontrollo një stacion tjetër, pashë Zotin, - e luti shoferin miku im.

Ndërsa ai kontrollonte stacionet, miku im foli i xhindosur, sikur t'ia kisha fajin unë:

- Nuk po marr vesh as i llafe. Ti kuptove gjësend?

- Jo, por...

- Çfarë por! Të gjith flasin sikur të jenë pjesë e një sekti të fshehtë. Kam katër vjet që jetoj larg Shqipërisë dhe ja, dëgjoj shqip dhe nuk marr vesh çfarë ka bërë vaki, e shplaftë dreqi!

- Shëëët! – paralajmërova, sapo u dha një stacion tjetër informacioni.

Tani raportonte një zë i butë, i paqtë, vaj e mëndafsh, sa mund të imagjinoje lehtë dhe fytin e bardhë alabastër me damarë blu, dhe gojën e lëngshme, dhe buzët e njoma vajzërishte të folëses timbërgjumashe:

"...Kryespiuni i shërbimit sekret shqiptar ka nisur shqyrtimin e çështjes në dy pista hetimi njëherësh. "Skifterët" e dehur me *prenë* ndoshta sillen rreth pikës më blu të Adriatikut, pasi mendohet që një rrëmbim i tillë të ketë pasur një plan strategjik dhe një mbështetje logjistike. Burime të pakonfirmuara thonë se Skifterët kanë patur në dispozicion, jo shumë larg aeroportit, një helikopter. Mësohet se në duart e uniformave blu të aeroportit ka rënë një letër që bën të ditur se rrëmbyesit janë të lidhur me organizatën islamike të Bin-Landenit. Bukuroshja e rrëmbyer, informohemi se është miss Dubai dhe se do t'i dorëzohet kryeterroristit, për ta patur pjesë të haremit të tij. Interpoli shqiptar është lidhur me shërbimet analoge të shteteve të Adriatikut dhe Mesdheut. Dyshohet se në këtë plan janë të përfshirë dy kriminelët serbë të luftës, Mlladiç dhe Karaxhiç. Megjithatë kreu i Rendit e hedh poshtë këtë version, duke theksuar se nuk ka ndonjë konfirmim nga Dubai dhe se mund të mos jetë i vërtetë lajmi i rrëmbimit të miss Dubait. Ndërka mundësia e zbardhjes së aktit terrorist zvogëlohet gjithnjë e më shumë, pasi njëri nga uniformat blu, mësojmë se sapo u shua në spitalin "Nënë Tereza". Kolegu tjetër i lënduar, ndodhet sipas mjekëve, në gjendje kome. Kjo ngjarje nuk ka lënë pa prekur dy kampet kryesore të politikës shqiptare. Akuza të forta e të njëpasnjëshme artikulohen nga lideri i selisë rozë në adresë të kryeministrit demokrat. Fill pas protestës në sheshin "Nënë Tereza", ai tha se "Skifterët nuk kanë rrëmbyer thjesht bukuroshen miss Dubai, por ata kanë rrëmbyer paqen dhe sigurinë e rreme qytetare që na servir regjimi demagogjik dhe i paaftë i kryeministrit. Për këtë precedent qeveria shqiptare duhet t'i çohet për dënim Tribubalit të Hagës".

- A na shpjegon ndonjë gjë më tepër, - e pyeta shoferin, pa ndonjë shpresë të madhe.

- Se ka nodhë nji gjo, këthough s'e lun topi, - tha i bindur ai, duke tundë kryet gjithë nënkuptime të fshehta.

- Se ka ndodhë diçka, po e kuptojmë edhe ne, por se çfarë, s'po na e thonë tamam.

-Ç'ne mre çuno, ene una sa ti nigjova... po hec mo... – tha, duke kërkuar një stacion me muzikë.

E ndali, ngriti volumin dhe tingujt e përmallshëm kundërmuan si barna ngushëllimesh të vjetra nën vargjet: *"Si mësoi, o karrocë e Dylit...!"*

emigracion

Profile emigrantësh të suksesshëm: jeta e përditshme dhe dashuria për vendlindjen

RRËNJËZA NGA RRËNJËT E ARTUR LIKSALËS

Nga: **ABDURAHIM ASHIKU**

Pinim kafe në sheshin qendror të Iraklios, shesh i madh, më i madhi nga sheshet që më ka takuar të shoh në hapësirën greke. Për një moment, nga një fjalë, nga një toponim që përmendi Arturi, mendja më fluturoi larg me atë shpejtësi që deri sot nuk kam dëgjuar të ketë masë matjeje, as me kilometra, as me milje detare dhe as me vjet dritë në hapësirën e universit.

Ai përmendi fjalën Kuplon dhe unë nuk mund të rrija pa u ngjitur menjëherë atij mali lajthish. Desha ta shoh vendlindjen e tij – Begjunecin nën "këmbët e mia", desha ta shoh qytetin tim ku kalova rininë dhe burrërinë (për të ikur në pleqëri) nga "qielli". Kush është ngjitur atje nuk ka si të mos ta kërkojë e ta gjejë në arkivin e kujtesës ndjenjën që të zgjon ajo pamje...

Në Kuplon së fundi, në verën e vitit 1991, ende pa u vënë tehu i mprehtë i sëpatës mbi trungjet e pemëve frutore të Dibrës, isha ngjitur me Sali Roshin. Por, më parë se me Saliun isha ngjitur me Haki Kolën e me Met Ramizin. Në fillim në projektin e tyre për kthimin e Kuplonit në një bllok me qershi "Napolon" dhe lajthi "Visoku" dhe më vonë me punëtorët që formuan brezaret, hapën gropat dhe mbollën qershitë e lajthitë. Kuploni konsiderohej atëherë blloku më i lartë frutorë i mbjellur në Shqipëri, bllok që niste në 1200 metra mbi nivelin e detit, vend ku qershia piqej shumë vonë duke mbyllur konvejerin e pjekjes së saj nga muaji maj në luginën e Drinit, në gusht – shtator në lartësitë e Kuplonit...

...E kisha humbur Kuplonin ashtu siç i kisha humbur edhe kujtimet që lidheshin me Sali Roshin dhe me Haki Kolën e Met Ramizin...

Ma gjeti dhe ma solli në Iraklio të Kretës, në breg të detit, në kuotën e lartësisë gjeografike zero Artur Likasala...

Vëllai i Arturit, Xhevati, ishte ngjitur në Kuplon, kishte hap tokën dhe kishte mbjellur qershi. I ujiste, në ditë të nxehta vere, me krahë shumë herë, e me bidonë në anë samari herë të tjera. Arturi ishte ngjitur me të një ditë vere dhe i ishte dhimbsë...

... Kishte ardhur në Greqi, kishte kërkuar dhe kishte gjetur një pompë të fuqishme uji. E kishte marrë duke kaluar me të detin, fushat, kodrat dhe e kishte ngjitur mbi fshat, atje ku kishte një vijë që e merrte ujin nga burimet e përroit të Bellovës. Kishte marrë tuba nga ato të zjarrfikësve dhe i kishte shtrirë në të përpjetën e malit. Kishte ndezur motorin dhe uji ishte ngjitur malit përpjetë.

- Po kjo, i kishte thënë Xhevati, ujitka të gjithë malin!

- Mbaje mirë, i kishte thënë. Dhe mos të të shoh më të mbash ujë me krahë...

Po kush është Artur Liksala ? Është një njeri i zakonshëm, një emigrant që punon e jeton në Iraklio të Kretës, një njeri që e ka mendjen të kthehet një ditë për të mbushë një shportë me qershi ushqyer nga dheu i të parëve....

Megjithatë disa detaje janë të nevojshme për të formuar portretin e tij...

* * *

Si i kalove gjithë këto male, gjithë këto dete dhe erdhe në Kretë?

Si të gjithë njerëzit. Herë me këmbë duke ecur natën dhe ditën, herë me makina dhe së fundi me traget. Tani jemi stabilizuar me letra. Shyqyr Zotit, kalojmë në kufi e nëpër dogana si njerëz.

Sa vjet tu bënë këtu?

Unë këtu kam gjashtëmbëdhjetë vjet.

Që në fillim këtu erdhe?

Jo, jo. Fillimisht kam ardhur në Verie, pastaj në Selanik pastaj në Katerinë. Në vitin 1998 kam përfunduar në Kretë.

Atje me çfarë u more?

Me punë të ndryshme, me bujqësi, me ustallëk, çfarë të dilte.

Po këtu si e nise?

Merrem me ndërtime, me punë të ndryshme, me çfarë të dalë, vetëm të mos ngelemi pa punë.

Ndërtimet i merr vetë përsipër apo je pjesë e ndonjë grupi?

Varet. Disa herë i marrim vetë përsipër, disa herë argatë. Kështu është kjo punë.



Tani ke ndonjë grup që punoni bashkë?

Po, kam një grup prej 7 vetësh, grup timin që merremi me ndërtime.

Çfarë ndërtimesh kryesisht?

Shtëpia guri, avllia, shtrim pllakash, suvatime.

Nga i ke pjesëtarët e grupit?

Të shumtët janë dibranë, por kam edhe nga Mirëdita, nga Kukësi.

Nga dibranët kë ke?

Kam njerëzit e mi; Armand Liksalën, Dashamir Ahmetin, Nazmi Totën prej Blliçje. Kam edhe disa çuna të tjerë prej Mirdite, nga Fani.

Qenkan mbledhë malet në Kretë?

Po. Veriu.

Vetë apo me familje je?

Kam gruan me dy fëmijë. I madhi është 5 vjeç kurse i vogli një vit e gjysmë. Gruan e kam në shtëpi, merret me fëmijët. Djalin e madh e kam çuar në shkollë.

Kur bisedonim pak më parë më more prej këtu dhe më ngjite në Kuplon me një motopompë në krah. Më ka marrë malli ta shoh Begjunecin e Peshkopinë nga "qielli" ?

Qesh me shpirt.

Ta tregova. Prapë e do ?

Jo, jo. Vazhdo. E kam regjistruar në qelizat e kujtesës. Nuk humb siç mund të humb në shiritin e diktofonit.

Këtu jemi por mendjen e kemi në Shqipëri, në vendin tonë, atje ku një ditë do të kthehemi. E dua vendin tim...

Kjo do të thotë se nuk je prej atyre që ke bërë "rrënjë"?

Mbjellë jam se kam gjashtëmbëdhjetë vjet i ikur, me fëmijë të lindur e që po rriten këtu, por rrënjë nuk dua të bëj sepse nuk më pëlqen t'i lë rrënjët në një vend tjetër, dua t'i lë në vendin tim.

Donë t'i çosh atje ku i kanë të parët.

Po, atje dua t'i kthej dhe t'i lë. Mbi të gjitha jam shqiptar.

Çfarë të ka ngelë në Peshkopi ?

Më kanë ngelë fara dhe fisi, tokat e gjyshit dhe e stërgjyshit, njerëzit dhe dashamirët.

Nëpërmjet gazetës kë do të përshëndesje prej këtu?

Dua të përshëndes familjen time, babën tim Rexhep Liksalën, nënën time Hatixhe Liksalën, vëllezërit me gra e fëmijë, Astrit Liksalën, Meritën, Xhevatin, dhe të gjithë njerëzit e tjerë që kam në Peshkopi dhe në Shqipëri.

Prindërit me se merren?

Baba dhe nëna janë në pension.

Vëllezërit nga janë shpërndarë?

I madhi merret me tregti, Astriti, kurse Xhevati është mekanik në park.

Ato qershitë në Kuplon kush i ka mbjellë?

Xhevati.

Janë pjekur qershitë?

Jo, ka nja dy vjet që janë mbjellë, nuk kanë hyrë akoma në prodhim. Kur të bëhen...

Do të marrësh edhe ti ndonjë shportë.

Patjetër. Edhe mua një shportë do të ma japin.

Për kë të ka marrë malli në Peshkopi?

Më ka marrë për të gjithë, për njerëzit e mi, për farefisin, për vendin tim.

Faleminderit!

Faleminderit edhe ju. Të uroj suksese. Gëzohem!

E-mail: a_ashiku@yahoo.gr
00306938103747.

Dibër

Dibrës ia kthym shpresën për të ardhmen

Në restorantin "Penestia" në Qendrën kulturore në Dibër të Madhe më date 11 mars 2009, u promovua Monografia "Aktivitetet e pushtetit vendor në Dibër 2005-2009"nga Dr. Argëtim Fida.

Siç thuhet në këtë libër, kjo është monografia e parë për Dibrën pas më shumë dekadave.Qëllimi ynë për të bërë një monografi katërvjeçare faktografike e kronologjike, është bazuar në angazhimet dhe të arriturat tona si pushtet vendor i BDI-së për këto katër vite të kaluara nga njëra anë , dhe nga ana tjetër për të mbetur një periudhë e shkruar dokumentuese historike për gjeneratat e sotme dhe të ardhshme, për të treguar përpjekjet dhe sakrificat tona për ta ruajtur dhe përparuar Dibrën.

Këto punë e sakrifica janë bërë me qëllim të krijimit të kushteve më të mira të jetës publike, infrastrukturore, administrative, arsimore, kulturore e sportive për të gjithë ne.

Poeti Nebi Samarxhiu duke I bërë një qasje kësaj monografie, tha se:" Duke shfletuar këtë Monografi shfletojmë një pjesë të ndërgjegjes tonë, ndjejmë frymëmarrjen e qytetit tonë të dashur që na kënaq për gjithçka që është arritur të bëhet për një të ardhme më të mirë. Dr. Argëtim Fida me këtë monografi dëshmon një shkallë të lartë kreativiteti, figurë të kompletuar intelektuale që din të shpreh dhe realizon vizionet e veta në çdo dimension të angazhimit të tij jetësor, dëshmon punë të palodhshme, bashkëpunim me të gjithë ata që janë në rrugë të drejtë të sendërtimit shpirtëror të qytetarrit dibran. Duke lexuar këtë monografi jo vetëm që na kënaq gjithçka që është arritur të bëhet, por më e bukura qëndron në formimin e një besimi të fortë për të ardhmen.Do të përfundoj me fjalët e autorit të shënuara në fund të këtij libri "Ju na e dhatë besimin, ndërsa ne përparimin dhe zhvillimin.Këtë jemi të gatshëm ta bëjmë edhe në të ardhmen".

Dr. Argëtim Fida, duke u falenderuar para të pranishëmve, shtoi se:"Të arriturat tona për katër vitet e kaluara janë pasaporta për shpresën e Dibrës për të ardhmen e lumtur.Unë për këtë i falenderoj tërë bashkëpunëtorët e mij për punën dhe sakrificëen e tyre.Është shumë vështirë të administrosh një familje të varfër e lene më një komunë të varfër.Arritjet tona nuk janë të rastësishme. Unë ndoqa Institutin ndërkombëtar për demokraci "Medlin Olbrajt", ndërsa kur erdha në postin e kryetarit të komunës sëbashku me nëpunësat e mij ndoqa të gjitha trajnimet dhe seminaret e nevojshme", tha në fund Fida.

Rexhep TORTE

Tiranë

Promovohet libri "Nëpër Udhët e Shqipërisë"

Në kuadrin e javës kulturore franko-fone Programi kulturor zvicerian për Ballkanin me datë 23 mars në orën 18 në një nga mjediset e Akademisë së Arteve organizoi promovimin e librit "Nëpër Udhët e Shqipërisë" me autore Helenë Pitand(Noëlle Roger pseudonimi) dhe përkthyer nga Ilda Poda(Cami).Në këtë promovim merrnin pjesë ambasadorja e Zvicrës në vendin tonë zonja Ivana Enelor, avokati i popullit Ermir Dobjani, ministri i punës Anastas Duro si dhe antarë të shoqatës së miqësisë Shqipëri-Zvicër, studiues, historianë e analistë të mediave.Në fillim përshëndeti të pranishmit ambasadorja zviceriane zonja Ivana e cila foli gjatë dhe mbi jetën e veprën e Helenë Pitand e cila bashkë me bashkëshortin e saj shkeli Shqipërinë në ato vite të trazuara e në kushte dhe të vështira për një çift që vinte nga Zvicra.Të dy ishin dhe studiues por bukuritë e Shqipërisë i magjepsën ndaj shkelën më së shumti edhe me këmbë këtë vise të bukura.Në të gjitha librat e botuara prej saj është përdorur pseudonimi Noëlle Roger me të cilin e njeh tashmë dhe lexuesi shqiptar..Shkrimtari Nasho Jorgaqi në fjalën e tij tha se padyshim Roger është një Edit Durham të cilën ne nuk e kemi njohur.Sikur të ishin takuar vërtet Edit Durham me zonjën Noëlle do të ishte një mrekulli. Kjo zonjë zviceriane bëri aq shumë për vendin tonë sa vështirë në ato vite se mund të bënim dhe vetë ne shqiptarët. E për ne kjo deri tani ishte e panjohur por e njohëm tashmë falë punës së madhe të zonjës Ilda Poda(Cami) e cila punoi gjatë nëpër arkivat e Zvicrës. "Padyshim Roger është një zbulim për ne, tha në fjalën e tij analisti Roland Qafoku, dhe këtë zbulim na e solli në vendin tonë zonja Ilda.Këtë që duhej ta bënte vite më parë Akademia e Shkencave ja që na e bëri Ilda dhe kjo nuk është pak.Në fund pqër të pranishmit u shtrua dhe një koktej ku dhe në prani të ambasadores zviceriane u tokën gotat e verës në shenjë të miqësisë së madhe mes dy popujsh .

BËHUNI PJESË E GAZETËS!

www.**dibra**.org

Në Filadelfia u bë promovimi i librit "Përjetë me Ty"
të autorit Ivzi Çipuri. Babë e bijë poetë të njohur në Amerikë

"Përjetë me ty", poezi e dhimbjes dhe dashurisë

***Nga:* BEQIR SINA, New York**



PHILADELPHIA - PENSILVENIA: Vitet e fundit, një sërë aktivitetesh me titull "U promovua libri", po organizohen në shumë qytete të shteteve amerikane. Aty ku më së shumti janë edhe të përqëndruar shqiptarët, kryesisht komuniteti i shkrimtarëve, poetëve, tregimtarëve, eseisteve, novelistëve, monografive, biografive, dhe publicistëve shqiptarë në SHBA-ës. Emigrimi i një numëri të madh të tyre, është bërë burim frymëzimi dhe ka qënë i begatë për shumë autorë, të gjejnë kohën e lirë të shkruajnë libra. Dhe t'i promovojnë, më pasë ato me ceremoni të bukura e tërheqëse. Që do t'i kishin zili edhe autorët në Shqipëri, Kosovë e viset shqiptare.

Këtu ditë komuniteti shqiptarë, u njohë nëpërmjet medias elektronike se: Shoqata Atdhetare - Kulturore Shqiptare – Amerikane "Bijtë e Shqipes" , Këshilli Drejtues i Shoqatës, në bashkëpunim me autorin, ditën e Dielë më 15 Mars 2009 organizoi në Qendrën Kulturore të shoqatës, promovimin e librit "Për jetë me ty", të poetit dibran Ivzi Çipuri.

Promovimi është shoqëruar me recensime, fjalë përshëndetëse, opinione, dhe një koktel të vogël, ku kanë marrë pjesë, liderë të komunitetit, biznesmen, gazetarë, shkrimtarë, adhurues të librit , arsimtarë, prindër dhe nxënësit e klasave të shkollës shqip, në këtë qendër. Poeti Ivzi Çipuri, është babai i poeteshës së talentuar, Iva Çipuri, një emër mjaft i njohur edhe në literaturën amerikane, emigruar në vitin 2000 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

PROMOVIMI I LIBRIT "PËRJETË ME TY"

Ideja për promovimin e këtij libri u rekomandua nga miqtë e shoqatës së siperpërmendur, nisur nga dëshira për të bërë të njohur këtë libër për vlerat e veçanta dhe mesazhet që përcjell për lexuesin në ditët tona kur baza e shoqërisë - familja, ka hyrë dhe po thellohet në një krizë të vërtetë sociale, kulturore, ekonomike, etj. Motivi i miqve ishte: përderisa autori bëri sakrificën më të madhe duke hapur zemrën dhe i dhuroi publikut botën shpirtërore të jetës së tij familjare, dhe me qenëse vlerat e mesazheve në këtë libër kalojnë dimensionin personal familjar dhe mund t'i shërbejnë shoqërisë, u ngul këmbë që të bëhej promovimi i këtij libri.

Në promovim recensuan: Llazar Vero, kryetar i shoqatës, i cili hapi dhe drejtoi gjithë aktivitetin, sekretari i shoqatës, Vlashi Fili, i cili lexoi tekstin e plote të artikullit dërguar nga Albana Melyshi Lifschin "Përkushtim i një bashkëshorti" botuar më parë në gazetën "Iliria", Mehill Velaj paraqiti materialin "Vargje malli të një mërgimtari", Raimonda Moisiu paraqiti materialin "Një vëllim që të tërheq nga mënga me shumë tinguj serenata dashurie....", Pr.Dr. Besnik Budaj, Sadik Elshani- anëtar i kryesisë së shoqatës "Bijtë e Shqipes" etj.

Pas recencave të sipërme shumë diskutantë vlerësuan vëllimin me poezi për vlera të veçanta në përmbajtjen e tij, mesazhin që jep libri si dhe nivelin e lartë artistik të veprës. Llazar Vero lexoi dhe tre mesazhe drejtuar vetë autorit Ivzi Çipuri dhe organizatorëve e pjesëmarrësve në promovim dërguar nga zoti Adnan Mehmeti - president i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë, nga Dalan Luzaj - kryetar i shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikane, Iliriana Sulkuqi- shkrimtare, poete dhe publiciste me banim në Nju Jork.

AUTORI "RREFEHET" ...

Çipuri thotë se tragjedia që goditi shpirtin tim më 17 Mars 2003 është krejtësisht e pamundur të përshkruhet për t'ia dhënë lexuesit. Ajo është pllakosur e vulosur thellë në shpirtin tim dhe askush nuk mund ta lexojë.

Që javën e parë të tragjedisë ndjeja se duhej të bëja diçka të shenjtë për njeriun e shenjtë për mua dhe që tashmë e kisha humbur përgjithmonë. Pa vetëdije dhe spontanisht, por vazhdimisht, me dilte nga brenda shpirtit pyetja se çfarë duhej të bëja për të vazhduar të jetoj me Licen (Alijen) time, të humbur vetëm fizikisht. Ky mendim sa i rëndë dhe i vështirë, më mundonte, por s'mund ta ndaja me askënd; as me dy vajzat e mija të shtrenjta, sepse s'mund t'i lëndoja më tej, përkundrazi, më shqetesonte mendimi dhe halli tjetër se si mund t'i ndihmoja ato për t'u lehtësuar sadopak dhimbjen e humbjes së nënës së tyre ideale.

Fillova të angazhoj mendjen me kujtimet më të bukura nga jeta jonë që nga dita e njohjes dhe deri në ditën e fundit pranë saj. Sa më shumë që vazhdoja të mendoja dit' e natë, akoma më shumë dhimbje më jepte edhe mendimi semos një ditë, me kalimin e kohës, edhe unë mund të perfundoja si gjithë të tjerët, në rutinën e jetës, në rrugën e harresës spontane që njerëzit e quajnë "sherim" me kalimin e kohës - se koha bën të veten. Pikërisht në momente të tilla mendimesh më rrëmbente ideja e tmerrshme që më bënte të pyesja veten: Pse, dhe Licja ime do të përfundonte si gjithë të tjerët - në harresë - sikur nuk kishte ekzistuar?!

Jo, këtë mendim s'mund ta duroja dhe pranoja në asnjë mënyrë. Nuk mund t'i lejoja vetes t'i mbetej gjithçka kohës si "shëruese". Kjo me jepte dhimbje dhe vetëm dhimbje, që sa vinte e bëhej më përveluese.

Rezultat i gjithë kësaj endërre llahtaruese ishte që në një moment të caktuar më pushtoi ideja e dokumentimit dhe përjetësimit në një formë a tjetër të gjithë jetës tonë me të gjitha bukuritë e saj, peripecitë, vështirësitë e pengesat, dhe mbi të gjitha ajo lumturi që ne kishim arritur të ndërtonim dhe në ditët më të vështira të jetës tonë bashkë në 35 vjet, veçanërisht 10 vitet e fundit.

Dhe sa më shumë kujtoja momentet më të lumtura, më shumë më digjte e përvëlonte dhimbja. Pa e kuptuar dhe gradualisht po filloja të bisedoja me veten time - por jo me zë në formën e një krize mendore, duke i thënë vetes që gjithçka duhet ta hedh në letër, çfarëdo që të ndjej ta shkruaj menjëherë. Dhe kështu fillova të veproj. E nisa në formë ditari për disa javë e muaj, duke shënuar momentet më kryesore, që ngërtheheshin nga fillimi i dashurisë tonë, deri në vitet dhe ditët e fundit të luftës për të fituar mbi mallkimin. Shkruaja ditën, shkruaja edhe natën vonë.

Në një prej netëve të tilla ndjeva se këto ide po më vinin në formë vaji poetik, me vinte të vajtoja me zë dhe shpejt rrëmbeva lapsin të shkruaja. Të shkruaja në vargje. Kjo më bëri të qëndroja më shumë vetëm në një ide, kujtesë apo mendim të përqendruar, dhe kështu mund ta përshkruaja siç e ndjeja në vargje. Kështu filloi dhe kështu vazhdoi herë pas here. Kisha raste kur nuk ndjehesha përsëri në gjendje për t'i shprehur ato në vargje dhe kthehesha tek ditari. Kam shkruar plot kujtime në ditar dhe përshkrime të veçanta, që ndoshta do më duhen më vonë.

Kur kisha arritur të ndjehesha dhe të bindja veten se vërtet kisha shkruar mjaftueshëm për të realizuar një vëllim me këto poezi, m'u desh një kohë relativisht e gjatë për të vendosur nëse duhej t'i bëja publike këto shkrime tepër personale dhe shumë prej tyre intime. Problemi i parë që hasa ishte se nuk kisha me kë të shkëmbeja mendime e të këshillohesha. Në fillim luftova me vetveten, duke kaluar nga njëri mendim për t'i botuar, në tjetrin që si mund ta bëja një gjë të tillë kaq intime e personale dhe që nuk kisha dëgjuar ta kishte bërë dikush tjetër më parë.

Njëra nga vajzat pranoi me guxim dhe t'i lexonte ato. Pas kësaj i vura si objektiv vetes që ta realizoja botimin e vëllimit.

"PËRJETË ME TY"

Vëllimi përmban 33 poezi të vendosura në tri pjesë në libër. Vendosja kryesisht është bërë kronologjikisht. Në pjesën e parë janë 13 poezi që pasqyrojne disi jetën tonë që nga njohja e parë dhe në vazhdim deri në kohën kur Alija u sëmur. Qëllimi në këto poezi ishte të kujtoja, shprehja dhe rrefeja disi ndjenjat e mija për Licen time, për dashurinë tonë, për filozofinë tonë për dashurinë dhe jetën familjare, për konceptin bazë mbi familjen, si lind, forcohet, ruhet dhe mbrohet dashuria e vërtetë në çfarëdo rrethanash sociale, ekonomike dhe lufte për mbijetesë.

Jam përpjekur gjithashtu të bëj një lidhje të jetës dhe përvojës tonë në marrëdhëniet familjare në raport me shoqërinë në përgjithësi dhe me të veçantat dhe problemet që kjo shoqëri has sot, në radhë të parë në aspektin e ndërtimit të familjes në raport me vetë këtë shoqëri që jemi sot e ku do të veje ajo në të ardhmen. Këto probleme kryesisht i gjen të shprehura në poezitë: "Betimi i parë", "Puthja e parë", "Betimi në martesë", 'Dyluftim opinionesh", "Lumturia", etj. Në fillim të kësaj pjese kam venë dhe një mesazh orientues: "...Sa kohë që je me të, kurre fundin s'e mendon..."

Në pjesën e dytë është vënë poezia e gjatë me titullin e vetë librit "Përjetë me Ty". Aty ka shumë dramë, shumë tronditje shpirtërore dhe nota pesimizmi, që herë pas here mund ta bëjnë lexuesin të dyshojë në përfundimin tim. Një mesazh të tillë e kam marrë dhe nga ndonjë lexues gjer tani.

Megjithatë, e gjitha kjo duhet marrë në kompleks me gjithë vëllimin, sepse në mbyllje të kësaj poezie, si dhe në pjesën e tretë, kjo situatë kalohet dhe triumfohet mbi pesimizmin dhe heqje dore nga jeta. Dhimbja, vaji, i heshtur, i dukshëm dhe i padukshëm, qoftë dhe pesimizmi i përzier me të gjitha këto, janë pjesë e realitetit, e jetës vete, dhe nuk kemi përse të tregohemi ndryshe. Sinqeriteti njerëzor është ajo që unë vlerësoj mbi të gjitha. Unë jetën po e vazhdoj aq sa mundem normalisht, jam i motivuar të jetoj për vetë dhe fëmijët e mi, t'i ndihmoj, mbroj e gëzoj ato, por dhe për të dashurit e tjerë të dy familjeve tona dhe më gjerë.

Në pjesën e tretë duhet kuptuar mire mesazhi që kam cituar në fillim: "Mbetesh përjetë Ajo që ishe për mua. Mbetëm përjetë Ai që isha për ty." Ky është direkt një reflektim i mesazheve nga poezitë e pjesës së parë. Filosofia ime që kam shpjeguar atje për dashurinë e vërtetë, etj. nuk ka ndryshuar assesi, përkundrazi, ajo konfirmohet dhe më tej. Në të gjitha këto poezi të pjesës së tretë reflektohet jeta ime e vërtetë shpirtërore me të gjithë ndjenjat komplekse dhe reale. Secila prej tyre ka dhimbje, ka bukuri, premtim, besnikëri, vazhdimësi jete, interpretim filosofik konceptesh, ka të ardhme, dhe pse jo optimizëm, sa kohë që vazhdoj të rroj i motivuar dhe në pritje për t'u bashkuar përsëri me Licen time, nëse gjithçka vërtetohet ashtu siç besojmë dhe shpresojmë të jetë në botën tjetër.

AURORA GROUP SH.P.K

PROJEKTIM - ZBATIM

koha kalon, cilësia mbetet



Autostrada Tirane - Durres, Km.9

Tel: +355 48 30 2046

Tel: +355 48 30 2040

www.auroragroup.com.al

e-mail: auroragroup@auroragroup.com.al



Neë Jersey, mbahet festivali"Dita Ndërkombëtare e Trashëgmnisë" për fëmijë, me emrin "One World - Një Botë"

Shqipëria përfaqësohet me veshje popullore dibrane

Për herë të parë edhe një fëmijë shqiptarë 8 vjeç, me kostum popullor e flamurin kuq e zi përfaqëson Shqipërinë

Nga: **BEQIR SINA**

EMERSON - NEW JERSEY : Më 23 janar, në sallën e teatrit dhe të koncerteve në qytezën Emerson, të New Jersey-it, u mbajt festivali "Dita Ndërkombëtare e Trashëgmnisë", për fëmijë, me emrin "One World - Një Botë". Kjo nuk është hera e parë që shkolla fillore Patrick M. Villano, është nikoqire e këtij festivali, andaj ai tashmë lirisht mund të quhet një traditë e kësaj shkolle, që të mbajë për çdo vjet një festival të tillë kaq të larmishëm, me fëmijët nga e gjithë bota.

Në edicionin e sivjetëm të këtijë festivali u paraqitën me veshjet e tyre popullore, dhe simbolet e tyre kombëtare, rreth 25 vende : Panamaja, Filipinet, Hungaria, Kanadaja, Portugalia, Kina, Kroacia, Izraeli, Italia, Tailanda, Arabia Saudite, India, Spanja, Meksika, Rusia, Ukraina, Polonia, Porto Riko, Skocia, Armenia, Afrika e Jugut, Australia, Indonezia, Koreja e Jugut, Egjypti, Libani e tjerë. Mes tyre për herë të parë është përfaqësuar edhe një fëmijë shqiptarë, i lindur në Amerikë, me kostumin popullor dhe flamurin kuq e zi të Shqipërisë.

Përfaqësimi i Shqipërisë, në këtë festival u pritë me shumë interes. Kostumi popullor dhe flamuri kombëtar entuziasmoi jo vetëm fëmijët shqiptarë në këtë shkollë, me prindërit e tyre, por edhe të pranishimit të cilët me ovacione përcollën përfaqësuesin e Shqipërisë, 8 vjeçarin Bahri Hoxha, me origjinë babai nga Tropoja dhe nëna nga Dibra.

Ky festival kosiderohet si një aktivitet për prezantimin e traditave kulturore artistike të fëmijëve të emigruar nga vende të ndryshme të botës, të cilët nuk do të harrojnë të paktën për një çastë se nga çfarë vendi kanë ardhur në Amerikë. Festivali tha drejtori i kësaj shkolle ka si qëllim zgjimin e jetës kulturore të fëmijëve nëpërmjet këtij kompeticioni. Gjithashtu, edhe kontributi i drejtpërdrejtë i prindërve të tyre për të ruajtur edhe në emigrim traditën dhe kulturën e vendeve të ndryshme. Nëpërmjet këtij festivali, synohet përfshirja e një numri sa më të madh fëmijësh. Po ashtu krijimi i mundësive për të provuar këto vlera kulturore, edhe në mjedise të tjera të rëndësishme në SHBA-ës.

Drejtuesit e këtij festivali që janë mësuesit e kësaj shkolle, duke ndjekur traditën e para-ardhësve të tyre, thonë se suksesi i kësaj performance, është në masë të madhe, për shkak se mësuesit, nxënësit dhe prindërit, arrijnë për çdo vjet të mbajnë këtë paradë folklorike. Paradë, e cila po tërheq për çdo edicion qindra nxënës dhe prindrit e tyre, të ardhur nga vende të ndryshme të botës, e që jetojnë në Amerikë. Kjo, jo vetëm për faktin se që fëmijët e tyre duhet të vishen në veshje tradicionale të vendit nga ata janë(origjina) që ata përfaqësojnë vendin nga emigruan prindërit e tyre, por ata gjithashtu duhet të sjellin edhe diçka nga simbolet kombëtare ose të përgatisin ushqime autentike nga vendi i tyre. Midis dhjetëra fëmijëve përfaqësues nga vende të ndryshme të botës , në këtë paradë folklorike, mori pjesë edhe një fëmijë shqiptarë 8- vjeçarë. Ai quhet Bahri Hoxha, me origjinë nga Dibra. Ai është i biri i Afrim dhe Emira Hoxhës, nipi i Jonuz Ndreut dhe Imam Isa Hoxha. Fëmija, i cili me veshjen popullore të krahinës së Dibrës, dhe me vallen famëshme të burrave të Dibrës"Valle dyshe Dibrane", kishte nderin e përfaqësonte vendin e tij Shqipërinë, shkruante një gazetë lokale.

Gjyshii i tij Jonuz Ndreu, një emigrant i herëshm, dhe që ka shërbyer në ushtrinë amerikane, patriot e atdhetar i shquar, ishte në gjendje të kontaktonte me një nga nipat i tij në Shqipëri, për sjellur një veshje tradicionale të fëmijëve që i përket krahinës së Dibrës. Ai e bëri këtë që t'ja dhuroi nipit të tij Bahriut, këtë kostum karaterisitk me ngjyra të bukura, në mënyrë që nipi i tij 8 vjeçar Bahri Hoxha, nxënësi i Shkollës Patrick M. Villano, e cila gjendet në qytetin Emerson, të New Jersey-it, të veshi këtë veshje folklorike shqiptare, gjatë këtij festivali ndërkombëtar të fëmijëve nga e gjithë bota në këtë shkollë . Për çka ai ishte dhe fëmija që përfaqësojë Shqipërinë në këtë paradë. 8 vjeçari shqiptarë me këtë kostum të prezantuar gjatë shfaqjes, shkruan gazeta lokale, u duartrokit nga qindra fëmijë, prindër e mësues dhe në fund të shfaqjes u nderua edhe me një kup dhe çertifikat nderi.

Fotoalbumi i gazetarit: TRI FOTOGRAFI NGA DHJETORI 1967...

Një mësuesi nga Reçi, Faiku i Prençëve, me të cilin herë - herë ulemi e pimë nga një birrë shqeto dhe bredhim me mend maleve e luginave të Dibrës, seç i shkrepi në mend dhe më mori e më gdhiu trasesë së kanalit të njohur në histori si kanali Fushalie - Vakuf.

Unë atë natë e pata gdhirë diku mbi fshatin Përgjegje kurse ai diku mbi fshatin Blliçe nga merrte dy krahë kanali i njohur që nëpërmjet një sifoni solli për vite me radhë ujin e Setës deri në Vakuf...

Unë asokohe isha mësues në shkollën e mesme bujqësore "Nazmi Rushiti". Me një aparat "Zorkij" bëra shumë fotografi tri prej të cilave më kanë ndjekur edhe këtu, larg vendlindjes e larg Atdheut, bashkë me shumë fotografi të tjera.

Në fotografi janë nxënës dhe punonjës të Shkollës së Mesme Bujqësore. Është vargu i gjatë i njerëzve, puna dhe përkushtimi i të cilëve nuk duhet vdirë...

Kjo, edhe në qoftë se kanali është vdirë dhe uji nuk ujit tokat e Kastriotit, Kishavecit, Vakufit e Fushën e Çidhnës deri në kufi me Lugjejt. / Foto: A. ASHIKU







Shënimet e një inxhinieri: Jeta dhe vështirësitë në kërkimet gjeologjike në malet e Korabit…

Mysafirë në çadër

Nga Vesel HOXHA*

Ishte korriku i vitiit 1976. Bazën e ekip it e kishim ngritur afër postës verore të Venishtit, në Bjeshkën e Abazallarëve të Vleshës, në bjeshkën e fisit të dajave të gjyshit tim, emrin e të cilit mbaj. Kishim rreth dy muaj që vazhdonim të punonim ne Bjeshkën e Shehut, në vendin e quajtur Gurët e Pëllumbave, për mineralizimet okside te hekurit. Me punën e bërë kishim zgjeruar konturet e zonës së kërkimeve edhe në vende të tjera. Sapo ishim kthyer nga një marshutë e lodhshme, bashkë me Aliun, kolegun tim të punës prej vitesh. Kishim dalë nga çadra herët në mëngjes dhe u kthyem në orët e vona të pasdites. Të dhënat e marra disa ditë më parë, në zonën e Bjeshkës së Gramës, për praninë e mineralizimeve okside të manganit, na kishin nxitur për të vazhduar kërkimet deri në afërsi të Dersës, përballë Llapshnikut. Mineralizime të tilla nuk ishin takuar nga punimet e rilevimit të kryera vite më parë. Disa copëra të gjetura nga komandanti i postës verore të Venishtit, Kozma Ziu, u bënë shkasë që Aliu të gjente shfaqjen e parë jo shumë larg copërave, në shpatin aty pranë, në afërsi të vendit të quajtur Guri i Kuq, përballë Liqenit artificial të Gramës, rreth një orë larg vendit ku kishim ngritur çadrat. Disa ditë më vonë, gjetëm dhe një shfaqje tjetër disa qindra metra larg saj, sipas shtrirjes së trupit të mineralizuar manganmbajtës, ne afërsi të Liqenit të Zonjave.

* * *

Nuk mbaj mend pse na mungonte guzhinieri ato ditë korriku, por kujtoj se Isuf Dobi, nga Mururri, punonjësi me kafshë që furnizonte ekipin, na gatuante, gjersa të vinte kuzhinieri Gani Kolgjini nga Cereni i Kalasë së Dodës. Ndërsa po bëheshim gati të hanim drekë, Sufa na thotë se sonte do të kemi miq. Në darkë do të vijnë disa njerëz nga Tirana. Pa u shprehur plotësisht Sufa, ndërhyn Aliu si me habi, mysafirë në çadër! Po po vazhdoj Sufa, mysafirë në çadër, bile janë shumë shtoi ai. Por ju mos u bëni merak. Komandanti që na e solli lajmin, tha se bukë kemi në furrë sa të keni nevojë, të tjerat brenda mundësive (Në atë kohë ne furnizoheshim me bukë nga furra e postës kufitare. Me raste, furnizoheshim nga posta, edhe me energji elektrike nëpërmjet një motogjeneratori të vogël që punonte me mishell). Unë do të vijë pa ftuar -i thuaj inxhinier Veselit, do vij për muhabet. Këto ishin fjalët e tij dhe u largua pasi kishte punë –përfundoj Sufa. Njoftimi nuk është i saktë – ndërhyra në bisedë. Me sa duket fjalët kanë ardhur gojë më gojë dhe kanë devijuar nga origjinali. Megjithatë e sigurt është se do të kemi mysafirë, e pa sigurt është se cilët do të jenë ato. Ç'është e vërteta siç jam shprehur dhe në tregime të tjera, unë nuk mbaja raki në çadër, por rakia të nxirrte faqebardhë në ato male, kur vinin miq që e pinin. Në male, ku bënë ftohtë dhe në verë, e pinë vendi rakinë, më thoshte i ndjeri Lik Skarra, një punonjës veteran gjeologjie nga fshati Shumbat, ndonëse dhe Lika vetë nuk e pinte, por mikut i'a vinte përpara. Lika ishte bujar i madh dhe punëtorë. Se pinë Veseli rakinë por e pinin të tjerët, kjo ishte çështja që bluja në mendje. Kur punoja në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, byrazeri im nga Lura, profesor Sabri Hoti më thoshte me humor: Se pinë Veseli, por e pinë Halimi për Veselin dhe shokët e tij. Vete tek komandanti për ta sqaruar më hollë punën por, fjalët që na tha Sufa nuk lëviznin. I them të lidhemi dhe njëherë me Degën e Punëve të Brendshme mos bëjmë ndonjë sqarim. Ashtu bëmë. U lidhëm më DPB në Peshkopi. I kërkuam të lidhet me Bulqizën për të na sqaruar më shumë. Për fat, nga që ishte dhe vonë na thonë se nuk përgjigjet njeri. Tentojë komandanti të lidhet me postën dimërore në fshatin Venisht, por përsëri qe e pamundur. Ta lemë ketë punë i them. Mirëse të na vijnë, ne do ti presim me ato mundësi që kemi, dhe -shtova unë -do të marrim masa për ti rregulluar për të fjetur. Në male kjo është gjëja më e vështirë, pasi është ftohtë dhe në verë, sidomos nata, me të tjerat bëhet si bëhet. Ndera po vrisja mendjen për të gjetur se cilët do të jenë mysafirët -ndërhyri komandant Kozmai duke më thënë se me ndonjë batanie dhe çarçaf ju ndihmoj dhe unë. E falënderoj për pritjen dhe largohem nga posta duke i thënë me shaka: Ftesë nuk po të bëjmë, do vije pa ftuar. Ku ta dija unë se do të vinte një ditë që lidhja telefonike nuk do të ishte mundim e vështirësi për njerëzit, por do të ishte një gjë krejt normale. Me një aparat të vogël, me celular, sot mund të flasësh me gjithë botën. Asokohe këto ishin kushtet dhe as që e çonte njeri në mendje se do të vinte kjo ditë. Kthehem tek çadrat ku ishin Aliu dhe Sufa. U tregoj se nuk sqarova gjë. Hani pak bukë inxhinier, e kini gati supën –mu drejtua Sufa. Mirë i them, po hamë pak me Aliun se ndoshta darka vonon e ne nuk durojmë gjerë athere, jemi të lodhur. Nga që Sufa na shërbente në kuzhinë prej disa ditësh, nuk kishim dhe shumë rezerva ushqimore, kësisoj ardhja e miqve sikur na vuri në provë. Ishte hera e parë që do të prisja mysafirë në çadër. Neve na mungonte eksperienca në shumë drejtime, jo vetën në anët profesionale që ishte diçka normale por, dhe në aspekte të tjera të jetës. Nuk kisha bërë as dy muaj punë në këtë rajon malor dhe akoma nuk i kisha mbushur 24 vjeç. Çadrat i kishim Italiane, i kishim të mira për të pritur dhe miq të rëndësishëm. Të paktën kështu i bëja qejfin vetes. Në dy të tjerat flinin punëtorët. Për vetë natyrën e punës, ato nuk mund ti mbanin pastër, falë dhe faktit se flinin katër-pesë veta në një çadër. Puna për hapjen e kanaleve të kërkimit me lëndë plasëse, me dhera e pluhura kërkonte kushte që ne si plotësonim dot në maja malesh. Shto këtu pastaj edhe natyrën lëvizëse të punës me çadra, të punës kërkimore. Ne, "udhëheqja", flinim dy veta në çadër dhe natyra e punës tonë ishte disi ndryshe, kështu mundësia për ta mbajtur pastër ishte më e madhe. Ndërsa po mendonim për të pritur mysafirët, Sufa mu drejtua duke më thënë: Sikur të bëjmë një ëmbëlsirë përpara se të na vijnë miqtë! Fitojmë kohë. Kishim vetëm një furnelë me vajguri, rumune, me dy vatra, e cila të hante shpirtin gjersa ta niveloje, përndryshe nuk bënte flakë të mirë. Mirë i them unë duke buzëqeshur, hoxhë jam, dhe hoxhallarët tek ëmbëlsira e kanë mendjen. Mos janë miq që nuk hanë hallvë -ndërhyri Aliu. Si do që të jenë, tha Sufa, nuk na vete dëm ëmbëlsira, sidomos në male. Aliu kujtonte se Sufa dinte të bënte vetëm hallvë. Sufa nuk do të na bënte hallvë. Ai do të na bënte Kabuni. Unë nuk e dija si bëhet Kabunia. E dëgjoja për herë të parë këtë emër ëmbëlsire. Megjithëse rakinë nuk e pija, në mendje bluaja diçka, kisha një brengë pse nuk e kisha ruajtur një shishe, ta kisha për mikun. Jo më kotë thonë se disa gjëra duhet të mbahen "për raste rreziku". Ndërsa dielli po perëndonte, në qafën mbi postë, në drejtimin e rrugës që vinte nga Varri i Sejmenit, Sufa dalloj ardhjen e disa njerëzve drejt nesh. Dal menjëherë nga çadra dhe shikoj duke veçuar midis tyre kokën e bardhë të Kryegjeologut Bushi, dhe dalëngadalë, me afrimin e tyre, dalloj Dekanin e Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave, Profesor Eshref Pumën, pedagogun e Petrografisë së Shkëmbinjëve Sedimentarë, profesor Jorgo Kananin, pedagogun e Vendburimeve të Mineraleve të Dobishme Metalore, profesor Andon Grazhdanin si dhe një djalë të ri që i kishte shoqëruar dhe orientuar gjatë rrugës me kafshën e tij për tek çadrat tona. Me që bazën e kishim afër postës, e patën të lehtë për të na gjetur. Përndryshe në male, kur nuk e njeh terrenin dhe vendin ku do të vesh, kur nuk ke një pikë referimi, dalin vështirësi rrugës. Pas pak të gjithë arrijnë tek baza jonë. Bukur, shumë bukur –ishin fjalët e para të dekanit Puma. Pas ritit të zakonshëm të përshëndetjeve e pyetjeve të rastit, një nga një u sistemuan në çadrën time. U ulëm ngushtë e ngushtë në të dy krevatet që ishin të vendosur në të dy anët e saj. Pasi u rehatuan pak, si i parë që isha, i pyes për vështirësitë e rrugës. I falënderova për respektin që po na bënin dhe guximin për të ardhur gjerë këtu, në lartësitë e bjeshkëve të Korabit. Ndjeva një gëzim të madh në zemër, pse jo dhe një vlerësim, që dekani së bashku me një pjesë të profesorëve të mi të fakultetit po më bënin një "vizitë" tek ekipi ku punoja dhe drejtoja unë. E konsiderova këtë një nder dhe nxitje për punët që më prisnin. Profesor Puma, një njeri i qetë dhe autoritar, ishte marrë kryesisht me kërkim- zbulimin e mineraleve të hekur- nikelit, kësisoj ishte i interesuar për kërkimet e hekurit në zonën e Korabit. Kryegjeologu Bushi na tregoj itinerarin e udhëtimit. Gjerë në Sllatinë kishin ardhur me një BJ-212, veturë kineze tip foristrade 7 vendëshe, të fakultetit, pastaj me kafshë gjerë këtu, duke u ndërruar herë pas here me njëri- tjetrin sipas rastit, kush lodhej më shumë.

Ishte një malore rraskapitëse dhe e gjatë. Rruga pothuajse kalonte vetëm nëpër gjipse. Tre orë e gjysmë udhëtim nga Sllatina e deri tek çadrat nuk ishin pak. U kënaqëm rrugës – vijoi dekani. Lodhja e ka dhe kënaqësinë brenda. Kur u ngjitëm në majën e Pelpanikut, maja më e lartë e Malit të Bardhë, mes për mes të cilit kalonte rruga këmbësore, ishte një mrekulli. Masivi gjigand gjipsor që vrojtohej nga kjo lartësi, me fenomenet erozionale dhe ato të karstit që e "shoqëronin", me Përruan e Gramës mespërmes, të krijonin një ndjesi marramendëse. Ishte me të vërtet një mrekulli e natyrës, një gjeomonument madhështor. Punëtori që na shoqëronte na tregoj për një vend në mes të gjipseve që nga banorët e zonës thirret "Pasqyrë". Dini gjë pse thirret kështu –pyeti dekani. Të them të drejtën në atë kohë as vendet nuk i njihja mirë, as për llojet gjipsore nuk kisha ndonjë njohuri specifike. Kësisoj e kalova në heshtje. Vite më vonë, kur do të ndërmerrja një studim tërësorë për evaporitet (gjipset etj.) do të mësoja se "Pasqyra" ishte nje vendburim, gjipsi tip seleniti fijor dhe fletor, në dukje i vogël, por me një perspektivë kerkimi e zbulimi të madhe. Fletët e Selenitit (lloi gjipsi) ngjajnë me xhamin dhe reflektojnë rrezet e diellit. Pra luajnë rolin e pasqyrës, ndaj nga vendasit thirrej me këtë emër kuptimplotë, emër i cili u bë shkas për gjetjen e shfaqjes së tij, dhe vënien e emrit "Shfaqja e Selenitit, Pasqyrë". Dalëngadalë biseda u fut në problemin kryesor për të cilin ne ndodheshim aty. Duke marrë fjalën dhe duke ju drejtuar flokëbardhit Bushi, Dekani Puma, tha: Kini bërë mirë që kini caktuar Inxhinier Veselin për kërkimin e mineralizimeve të hekurit në zonën e Korabit, jo vetëm për faktin se është nga këto anë dhe është i ri, por edhe për faktin tjetër se ka qenë një student i mirë dhe punëtorë. Korabi do punë, do "dije dhe gjunjë" pasi është zonë e vështirë si në kuptimin e lodhjes fizike ashtu dhe në atë profesional. Mirë do të ishte të bashkëpunonte me ndonjë specialist më të vjetër, për të pasur më shumë debat e rezultate. Si do që të vijnë punët unë kam besim tek Veseli dhe zelli i tij për tu futur në të fshehtat e profesionit të gjeologut – mbylli fjalën dekani Puma. Tek dëgjoja ato fjalë të ngrohta të dekanit, mbushesha me optimizëm dhe më largohej mërzia e shumëanshme duke harruar shumë halle e probleme që kisha.

Ndërsa biseda filloj të futet në temën kryesore, duke u interesuar në detaje për rezultatet e kërkimit nuk isha i qetë në se do të dilnin të kënaqur nga kjo vizitë. Ndjehesha i priveligjuar dhe kjo mi shtonte më shumë përgjegjësitë dhe ngarkesat emocionale. Profesor Jorgo e pinte pak rakinë, dhe këtë e dija që student. Po ashtu dhe profesor Andoni. Diçka më pak Dekani Puma dhe kryegjeologu Bushi. Neve raki nuk kishim. Bëmë disa përpjekje për ta gjetur por më kot. I kishim të gjitha por ajo na mungonte. Këtë s'na e kërkonte njeri, e kërkonte pritja, pesha e mikut dhe sedri shqiptar. E kërkonte muhabeti i ndezur e miqësor, trokitja e gotave në mes të maleve, mes shokëve e miqve, mes njerëzve fisnik të thesareve të nëntokës. Ata s'kishin ardhur as për tu ngopur me ushqim, as për të pirë raki, por në të tilla raste çdo gjë kishte vlerën e saj. Pikërisht, për këtë vlerë u shqetësova para se të na vinin mysafirët, pa e ditur se cilët do të ishin ato, mjafton që do të ishin mysafirë në çadrën tonë, në çadrën e gjeologëve. Bisedat e gjata me pyetje e përgjigje vazhduan deri vonë. Vjenë dhe çasti i darkës. Sufa na kishte shtruar darkën në ato kushte që kishim, në çadrën e guzhinës, i ndihmuar dhe nga punëtorët që flinin në ekip. Çadra e guzhinës nuk ishte Italiane, por e prodhuar në Durrës dhe ç'është e vërteta ne kohë me diell të nxehtë mbante pak erë jo të këndshme. Për nga volumi ishte me hapësira më të mëdha se ato Italiane. Në vend të rakisë kishim dhallë. Stane rreth e rrotull kishim me shumicë dhe kjo nuk përbënte problem. Darka



Specialiste të grupit të rilevimit gjeologjik në shkallë 1: 25 000, para çadrave, në një nga Bjeshkët e Korabit. Foto e vitit 1978.

INTERMEXO PËR KOLEGUN E PA HARRUAR

ALI BARDHI ishte një nga teknik gjeologët më të aftë që ka pasur Ndërmarrja Gjeologjike e Bulqizës në atë kohë dhe, në veçanti, Ekspedita Gjeologjike e Peshkopisë. Ky nuk ishte vetëm opinioni im por i masës së madhe të specialistëve që kishin pasur rastin të punonin me të. Atij i mungonte formalisht diploma e inxhinierit. Unë këtu nuk do të ndalem tek këto aftësi të Aliut. Do të sjellë në vëmendje një shqetësim të Tij, i cili më ka bërë përshtypje të madhe duke lënë gjurmë në kujtesën time. Ishte me origjinë nga Sina, një fshat në mes të maleve, në anën lindore të krahinës së Çidhnës, vendlindjen e Skënderbeut, ose më saktë vendlindjen e Kastriotëve. Kishte dëshirë të madhe ta thoshte me zë të lartë e me krenari këtë pohim. Ishim nga e njëjta krahinë dhe që të dy shquheshim pak për lokalizëm. Unë e kundërshtoja për origjinën, vetëm e vetëm për të hapur muhabet. Jo, më kundërshtonte prerë e me pasion, me një farë zemërimi të madh, sikur do të vendosej nga ne të dy se nga ishte Skënderbeu. Më gjej në ndonjë vend tjetër të botës, jo më në Shqipëri -vazhdonte me temperament dialogun Aliu duke shfryrë – dy fshatra që të kenë emrat Kastriot dhe Kukaj, të jenë 15 minuta larg njeri tjetrit siç thotë Barleti, dhe, pa marrë parasysh asnjë të dhënë tjetër, unë do ta pranoj se Skënderbeu nuk eshtë Dibran. Rreken të thonë se Kastrati ka lidhje me Kastriotin me lloi lloi akrobacisë gjuhësore. Sa injorant tregohen –thoshte Aliu. Jo me ofendime Ali, ne nuk dimë më shumë se historianët –ndërhyja butë në bisedë unë, për ta këshilluar por edhe për ta ngacmuar. Jo more, nuk është ashtu – përgjigjej prerë Aliu. Ne kemi ujkun, ato na tregojnë gjurmët. Unë kësaj nuk di ç'emër ti vendosë!!!!! Unë kam besim vetëm tek historiani Kristo Frashëri. A e ke lexuar një shkrim të Tij në Gazetën Mësuesi të vitit 1974 me titull: "Nga ishin Kastriotët ku lindi Skënderbeu". Po i them, bile e kam të nënvizuar pothuaj të gjithin. U botua në dy numra gazete. Ai ka goditur në shenjë, ai është shkencëtar, jo se ne jemi Dibran dhe nga ajo anë, por kjo është një e vërtetë e madhe që se luan topi i Allamanit, e vërtetë që mbështetet në fakte. Në krahinën tonë nuk janë të rastësishme të gjitha emërtimet që lidhen pazgjidhshmërisht me origjinën e të madhit Skënderbe. Vërtet është çështje e historianëve, e shkencëtarëve, por fakte kaq madhore nuk kanë nevojë për shumë shkencë. Po Kristo Frashëri ç'farë është? A nuk është ai shkencëtar? A nuk është ai historian e shkuar historianit? Unë ndoshta do të jem i vdekur – vazhdoj përsëri Aliu -dhe Ju do të mi kujtoni këto fjalë. Herët apo vonë këtu do të vijnë. Vdekja nuk ka radhë Ali, pastaj ju jeni ende i ri dhe s'duhet ta kujtoni atë. Për Shën Gjergj shqerrat (qingjat) ikim para deleve, ju përgjigja unë me një thënie popullore alegorike, të njohur në zonën tonë. Këtu më shumë se kudo, festohet Shën Gjergji, ditëlindja e Skënderbeut, 6 maj 1405. Kjo ditë e gëzimit për lindjen e Tij, festohet në nëntë malet e Dibrës. Kjo krahinë, nga vdekja e Skënderbeut e këtej, edhe veshjen e shajakut (tirqet e koporanen apo kajuken) e ktheu me ngjyrë të zëzë, në shenjë zie për të. Këto në esencë më patë thënë Ali Bardhi. Dhe unë po e mbaj amanetin. E riprodhova dialogun, me pak zbukurime. Ndodhi ashtu si e parashikoi ai. Në tetorin e vitit 1988, në moshën 50 vjeçare, në kulmin e pjekurisë profesionale, u nda nga jeta krejt pa pritur, nga një sëmundje e rëndë zemre. Na pikëlloi të gjithëve. Në veçanti kolegët e tij të punës e të jetës, si Xhelal Sulin, Esat Manjanin, Sakip Dautin, Selim Muçën, Nexhat Hysën, Sakip Elezin, Niko Kitën, Adli Bahollin, Isa Mandrrin, Muharrem Sturçen, Dogjan Dervishin, Safat Hoxhën, Enver Lamollarin, Emërllah Kolgjinin, Halit Kokën, Hasan Lalën, Nazif Agën, Hamedan Shkurtën, Mustaf Shkurtën, Qemal Nelin, Isuf Lelën, Bajram Pacin, Haxhi Cerrin, Isuf Dobin, Ramazan Demirin dhe sa e sa të tjerë. Punoi një jetë të tërë maleve të Mirditës dhe të Dibrës, në kërkim të mineraleve te bakrit, polimetaleve, hekurit, manganit etj. etj. duke u shquar për profesionalizëm dhe kulturë. Ky ishte në pak rreshta Ali Bardhi, i cili la pas një familje të shkëlqyer si bashkëshorten dhe fëmijët, të cilët i rriti dhe u rritën me shumë mundime, pasi, disa prej tyre ishin ende të vegjël, kur Aliu u nda nga jeta. Ata duhet të ndjehen krenar për të, e në radhë të parë, se i rriti me djersën e ballit. Ali Bardhi ishte modeli i njeriut të ndershëm dhe punëtorë.



kaloi si kaloi. Ato u kënaqen me ato çka kishte gatuar Sufa dhe dhalli u pëlqeu shumë. Më shumë ju pëlqeu Kabunia e tij. Diçka me oriz kishte sajuar Sufa, por kishte bërë një embëlsirë të mirë. Vite më vonë, kur do të veja në fakultet për ndonjë punë dhe do ta takoja dekanin, nuk do të harronte të më pyeste me humor për Kabuninë e Sufës. Njerëzit e vuajtur e me kulturë ti heqin emocionet. Ato i dinin vështirësitë e maleve dhe kushtet e jetesës së gjeologëve. Ndonëse në darkën e shtruar pati shumë gjëra të mira, u bë maksimalja që mund të bëhej për mikun në ato kushte malore, ku leku "nuk ka vlerë", e dëshirat për të pritur mikun janë për më shumë, përsëri na ngeli mangut ajo që ngrohte trupin dhe ndizte muhabetin. Sikur e teprova me këtë pije alkoolike, që vetë nuk e pi. E teprova për të vetmen arsye, se është një peng i imi i fillimeve të para të punës në gjeologji. Në orët e vona të natës ramë për të fjetur. Bëra kujdes që mysafirët të rregulloheshin mirë pasi veç të tjerave, kishin bërë dhe një rrugë shumë të gjatë. Për fat koha ishte "lot me lot" siç përdoret rëndomë nga anët tona, ose e thënë ndryshe e shkëlqyer. Qielli ishte i mbushur me yje dhe nuk lëvizte gjethja, kur i thonë. E vetmja zhurmë që dëgjohej tek- tuk ishin disa të lehura qensh nëpër stane. Kjo ishte një muzikë e zakonshme e netëve verore të freskëta të bjeshkëve te Korabit madhështor dhe hijerëndë.

* * *

Në mëngjes u ngritëm herët. Kështu ishte vendosur që në darkë, përpara se të flinim. Itinerari nga do të lëviznim, ishte shumë i gjatë, ndaj duheshin bërë mirë llogaritë për të arritur në mbrëmje në Peshkopi. Me ne do të vinte edhe Sufa. Do të vinte për furnizim dhe për të na ndihmuar rrugës. Ishte ngritur më herët se zakonisht. Kishte ushqyer mirë e mirë mushkën ose veturën siç kishte dëshirë ta thërriste dhe, kishte filluar përgatitjet për mëngjesin. Mëngjes do të hanim ne ekip dhe drekën do merrnim me vete si ushqim të thatë. Me vete morëm edhe ca konserva mish viçi që i kishin sjellë mysafirët e çadrës, pasi nuk qe nevoja të konsumoheshin atë natë, si dhe, pak Kabuni. Ishin bërë planet që në darkë vonë, të ishim në fshatin Cerjan, ku na priste makina për Peshkopi. Por, që të arrinim atje, duheshin dhjetë orë ecje normale të një këmbësori të zakonshëm e të mësuar në këto anë. Pasi u bëmë gati dhe i shtrënguam mirë e mirë pajimet personale të punës secili prej nesh, u nisëm. Do të kalonim Përruan e Shehut dhe do të vazhdonim maloren drejt Gurëve të Pëllumbave. Marshuta kalonte në formacione paleozoike të natyrës rreshpore, ndër më të vjetrat në vendin tonë, që më vonë me të dhënat e reja u "rinuan" dhe rezultuan me moshë mesozoike, të formuara para 230 milion vitesh në detin e asaj kohe. Të na falë lexuesi pasi në ndonjë rast jemi të detyruar të përdorim disa terma specifike profesionalë, duke mos pasur mundësi për t'ju shmangur përdorimit të tyre. Pas një ore marshutë, ishim tek dalja e hekurit (okside hekuri – hematite), ku kishim kryer një sërë kanalesh kërkimi kryq shtrirjes së zonës së mineralizuar. Mysafirët vrojtojnë një nga një punimet dhe rezultatet. Cilësia e mineralit ishte shumë e mirë. Coprat e kampioneve të Hematitit nuk mbaheshin në dorë prej peshës. Kishin cilësi dhe peshë specifike të madhe. Problem ishte ana sasiore dhe kushtet tekniko ekonomike të shfrytëzimit. Profesor Andoni dhe Profesor Jorgo rreken të zgjedhin disa copra të mira e të bukura. Jo shumë, se kanë peshë – ndërhynë në bisedë Aliu. Bëmë disa diskutime profesionale dhe shkëmbyem mendime të ndryshme për zhvillimin në shtrirje të zonës minerale. Me që në këtë zonë busulla çakordohej, pra kishim anomali, kishim planifikuar për tu kryer punime manjetometrike (metodë që bazohet në vetit manjetike të xeherorëve), të cilat u realizuan në shtator të po atij viti, nga kolegët ing. Zoto Rjepaj dhe ing. Aleksandër Kospiri, dy prej gjeofizikantëve të parë që kam bashkëpunuar në fillimet e punës në gjeologji. Me ing. Aleksandrin pata rastin të punoj dhe më vonë, duke patur një miqësi të sinqert dhe një bashkëpunim të frutshëm. Më vonë në verifikim të këtyre anomalive gjeofizike, u projektuan disa shpime. Në terren u arrit të realizohet vetëm një shpim. Ky shpim është realizuar në lartësinë rreth 2450 m mbi nivelin e detit. Besoj se në këtë lartësi nuk ka shpim tjetër të kryer në vendin tonë. I takonte që në zonën me malin më të lartë në Shqipëri, të ishte kryer dhe shpimi me kuotë absolute më të madhe. Lë ta lemë për një radhë tjetër këtë histori dhe të kthehemi përsëri tek marshuta jonë, me mysafirët në çadër. Dekani më pyeti se ç'mendim kisha për origjinën e xeherorit. E kam të vështirë të shprehem –vazhdova unë -por hë për hë mendoj se janë formuar në rrugë sedimentare. Ndryshe qëndron puna pastaj për ato të Avdnicës, ato mund të kenë origjinë hidrotermale (magmatike). Interesant do të ishte sikur edhe këto të jenë me origjinë hidrotermale, duke na hapur perspektivën drejt Avdanicës. Kjo do të ishte me të vërtet shumë interesante. Është ende shpejt të flasim për kushtet e formimit, duhen punime mineralogjike të detajuara –sqaron prof Andoni. Ndërhyrja e profesor Andonit sikur më shkundi pak nga emocionet dhe më lehtësoi. Nxënësi për mësuesin apo studenti për pedagogun, edhe kur bëhen burra, e ruajnë instinktivisht marrëdhënien mes tyre si në raportet fillestare. Me që koha ishte e mirë dhe sheshpamja ishte e madhe, natyra të befasonte në çdo hap. Pasi njihen mirë e mirë me shfaqjen, bëjnë disa fotografi të zonës minerale dhe të natyrës rreth e rrotull e vazhdojmë marshutën. Duke u larguar nga shfaqja e Gurëve të Pëllumbave, për në drejtim të Bjeshkës së Gramës, profesor Puma më afrohet ngadalë, duke me hedhur dorën mbi supe e duke më thënë: Mbajë shënime e bëjë dokumentime të sakta kudo që shkon për të vrojtuar, jo në copa letre, por në blloqe të rregullt. Merre sa më shumë prova e kampione, për analiza kimike, petrografike, mineralogjike, paleontologjike etj. për minerale dhe shkëmbinj. Mbaj copëra kampionesh dublikatë nga ato që dërgon për analizë, që kur të marrësh përgjigjen shkencore për emërtimin, të kesh mundësi pastaj ti njohësh vetë pa qenë nevoja për analiza. Kësisoj pasuron dijet dhe kursen shpenzimet e kampionaturës. Bëjë sa më shumë skica për çdo fenomen që vrojton dhe interpretim që bën në terren. Gjithçka ruaje se do të të duhen. Dokumenti i realizuar në terren ka vlerë të pallogaritshme dhe rëndësi të jashtëzakonshme. Mbi atë dokument do të mbështeten më vonë të gjitha përgjithësimet dhe përfundimet shkencore. Shto këtu pastaj dhe faktin që gjeologut, vështirë se i jepet mundësia të vejë dy herë në një vend. Për të ngritur baza punimesh fushore, bile të thjeshta me çadra si tuajat, ju e provuat sa mund e djersë duhet, pa llogaritur pastaj këtu se të gjithë njerëzit paguhen dhe, të gjitha materialet e punës që konsumohen janë para. Gjeologjia kërkon shumë shpenzime, ndaj duhen bërë mirë llogaritë, duke i shfrytëzuar në maksimumin e mundshëm punimet fushore, duke punuar nga zbardhja e ditës e gjerë në perëndim të diellit. Terreni kërkon punë, pak pushim e pak gjumë. Ju e dini më mirë nga unë se shumë materiale pune blihen me valutë jashtë shtetit. Duhet të pranojmë se, megjithëse jemi vend i vogël në sipërfaqe e popullsi dhe i varfër njëkohësisht, investimet në gjeologji janë të mëdha në raport me sektorët e tjerë të ekonomisë. Këto ishin në vija të përgjithshme ato që më renditi profesor Puma, tek po zbrisnim tatëpjetën e Bjeshkës së Shehut. Për të qenë i sinqertë, të gjitha porositë e tij ishin me vlerë dhe i kam zbatuar rregullisht. Praktika e punës i'a kishte diktuar ato, ndaj mi transmetonte mua. Për një gjeolog të ri këshillat vlejnë shumë. E falënderova dhe në vazhdim iu drejtova me këto fjalë: Unë, profesor, e kam pasur babën hoxhë. Vite më parë, kur feja ishte e lirë, më ka treguar se Profeti Muhamed (a.s.) ka thënë: "Ai që udhëzon një një në rrugë të drejtë, është sikur të kishte fituar tërë botën". Në një hadith tjetër -vijova përsëri unë -thotë: "Njeriu është krijuar që të mësojë dhe tu përcjellë të tjerëve atë që ka mësuar". Juve ndoshta nuk i dinit këto hadithe (thënie të profetit) por i zbatuat. Qeshi pak nën buzë dhe nuk vazhdoj më tej. Ndoshta bëra gabim thash me vete, por nuk vazhdova më tej. Profesor Eshrefi ka qenë një njeri zemërbutë, serioz dhe në përgjithësi fliste vetëm kur e kërkonte radha. Ndërsa e mbyllëm bisedën më dekanin Puma, mbyllëm dhe të tatëpjetën e Bjeshkës së Shehut. Kaluam përroin dhe filluam të ngjiteshim përsëri drejt një të përpjete tjetër, drejt Gurit të Kuq. Pasi dalin në qafën pranë tij, që ndan Bjeshkën e Abazallarëvë me Bjeshkën e Gramës, na shpalosen një nga një para nesh me tërë bukuritë dhe madhështitë e tyre Llapshniku me majën e Gramës mbi kokë, Liqeni i Gramës, Gryka e Përroit të Gramës, Gradishta, Pelpaniku, pjesërisht Lugina e Drinit të Zi dhe në horizont gjithë vargmali karbonatik perëndimor nga mali i Xharxhishtës, Gryka e Setës, Masivi ultrabazik i Lurës, mali i Pllajut, Runjës etj. etj..

Në të tatëpjetën e Bjeshkës së Gramës vrojtuam shfaqjet e oksideve të Manganit dhe pasi zbritën në pjesën e sheshtë, pushuam pak mbi Liqenin e Zonjave. Shfaqjet i kishim përballë. Kanalet e hapura çdo 25 m në shtrirje dukeshin si në pëllëmbë të dorës dhe gati në këmbë si ushtarë të rreshtuar nga që pjerrësia e shpatit ishte mbi 70 shkallë. Përdoret dhe fjala gradë, pos kjo sipas meje nuk është e drejtë, më gradë matet rakia. Nga që kishte shumë barë bjeshka, kanalet të orientonin, për vendndodhjen e trupit xeheror. Ishin dy shfaqje xeherore me trashësi e cilësi jo të madhe, 200 – 300 m larg njëra- tjetrës. Mua më duket se kanë bërë një punë të mirë dhe i kanë zgjeruar goxha konturet e kërkimit – ndërhyri në bisedë kryegjeologu Bushi. Cilësia e kryerjes së punimeve në terren dhe dokumentacioni që mbajnë është në lartësinë e duhur dhe unë ngelëm i kënaqur. Ndërsa shijova fjalët e mira të kryegjeologut, copërat e gurëve nëpër bjeshkë nuk më pëlqenin. Ç'është e vërteta në atë kohë problemet e mjedisit nuk trajtoheshin ose e thënë ndryshe nuk bëhej zhurmë si sot, ndonëse ajri ka qenë më i pastër. Kjo vlen vetëm për qytetet. Dëmtimet në bjeshkë kanë qenë të mëdha. Sa do që bënim kujdes, copërat e gurëve dhe masat e dheut që fluturonin minat, nuk mund ti komandonim. Kësisoj bjeshka dëmtohej shumë. Në këtë drejtim pranoj se ne gjeologët kishim një farë lirie të tepruar, ndoshta me ligje nuk e kishim, duke përfituar nga mungesa e kontrollit ne thellësi të maleve dhe fshehja pas mineralit, aq i kërkuar në atë kohë. Profesor Jorgos i bëri përshtypje kjo gjë, ndaj mu drejtua mua si veçmas, e me zë të ulët. Dëgjo Vesel, shumë e kini dëmtuar këtë perlë të natyrës Shqiptare. Unë kam shëtitur Shqipërinë, por si këto vise nuk gjen kund. Po -i them profesorit, të drejtë kini. Ne duhej të hapnim kanalet dhe ishim të detyruar në një farë mënyre. Të them të drejtën në atë kohë nuk kisha këto mendime që kam sot për mjedisin, e shikoja në këndvështrim tjetër. Minerali na i kishte errësuar sytë në kuptimin e mirë të fjalës. Faj duhej kërkuar më thellë. Kjo llojë edukate në atë kohë na mungonte dhe problemet e mjedisit ishin disi mënjanë.

Vazhdojmë të ecim -na ngacmon Sufa, jemi ende larg. Më që një pjesë e rrugës ishte e sheshtë Dekani si më i moshur, hypi në mushkë. Në afërsi të Vendit të Keq, siç thirrej nga banorët vendas, pjesa e rrugës mespërmes shpatit gati vertikal të Llapshnikut, Dekani zbret nga mushka. Para nesh nuk ishte vetëm Vendi i Keq, por shpalosej me madhështi edhe një nga fenomenet më klasike në botë, ai i alloktonizmit. Mbi evaporite, (gjipse e jo gipse, pasi në gjuhën shqipe ashtu duhet shqiptuar) vendosen formimet rreshpore të Paleogjenit (emërtohet një periudhë kohore gjeologjike që ka zgjatur rreth 60-65 milionë vjetë). Mbi këto, në marrëdhënie jo normale (ne gjeologët themi tektonike), shtrihen në formë mbulesore formime më të vjetra, të njohura si formacioni vullkanogjeno – sedimentarë i Gramës, ose mbulesa e Gramës. Një shfaqje e shkëlqyer e alloktonizmit, fenomen ky i trajtuar vite më parë nga arkitekti i parë i zonës së Korabit, profesor Vangjel Melo. Ato vendosen njëra mbi tjetrën, sikur ti kishte vendosur dikush me dorë. Formacione shkëmbore të vjetra, vendoset gati horizontalisht mbi formacione shkëmbore me moshë më të re. Bukur, bukur i ka vrojtuar këto dukuri profesor Melo –u shprehen po thuaj njëherësh profesorët Kanani dhe Grazhdani. Profesor Melua e njihte mirë që në atë kohë këtë zonë dhe ishte pionieri i saj. Kishte qenë para nesh me çadra e me mushka ngarkuar nëpër këto vise të thella malore. Por le të vazhdojmë marshutën tonë me mysafirët në çadër. Kalojmë me mjaftë vështirësi "rrugën e vdekjes" e cila kalonte përafërsisht pranë kontaktit të gjipseve me shkëmbinjtë e vendosur sipër tyre. Ishte një rrugë e ngushtë. Nga sipër nga çasti në çast mund të vinin gurë, e, duhej kujdes. Nga poshtë, pak të dilje nga rruga apo të të rrëshqiste këmba, fluturoje në humnerë, 200 deri 300 m, derisa të përfundoje në shtratin e Përroit të Gramës, në afërsi të Dersës. Pasi kalojmë Vendin e Keq dhe dalim në Qafë të Malit, bëjmë një ngjitje të vogël dhe arrijmë në vendin ku ishte posta verore e Cerjanit, mbi Llapshnik, një ballkon natyrorë ku mund të vrojtoje gjysmën e Dibrës së Poshtme. Aty bëjmë një pushim. Rrugën më të vështirë e kaluam -na thotë plotë gëzim, Sufa. Tani nuk kemi malore. Pjesën e mbetur e kemi në zbritje. Ora po shkonte 16^{00} dhe asnjeri nuk u kujtua për të ngrënë diçka. Dukuritë gjeologjike që takonim rrugës dhe diskutimet që bëheshin rreth tyre na e kishin larguar vëmendjen nga buka. Pasi freskohemi një nga një, tek burimi i postës, hamë dreke me çfarë na kishte përgatitur Sufa. Lodhja, Bjeshka dhe Ujët e Ftohtë e hanë ushqimin. I mbaruam të gjitha ato që patëm. Në fund hëngrëm dhe kabuninë e Sufës. E shikon Sufë -ju drejtua Aliu - tu shitë malli. Pse kotë më zgjodhët mua Ju – e mbylli me humor bisedën Sufa. Në pjesën e mbetur të marshutës kishim pak gjëra interesante për të parë. Mbulesa e Gramës ishte një formacion ku zhvilloheshin punime kërkim vlerësimi kryesisht për bakër dhe shoqërues. Rrugës ndaluam pak vetëm në prerjen e Hirisimit, mbi Cerjan, ku ju tregova në vija të përgjithshme për disa rezultate dhe pozicionin e zonës së mineralizuar në këtë seri. Edhe këtu dukej mirë rrafshi mbulesor i kësaj serie mbi formimet e paleogjenit dhe marrëdhëniet e këtyre të fundit me evaporitet. Një dukuri e tillë ka vlera unikale botërore dhe do ti vijë dita për vizitorët e shumtë gjeolog e jo gjeolog, vendas dhe të huaj. Kjo do të kërkojë pak kohë, kur rruga e makinës të jetë e pranishme në këtë anë dhe në anën e Bjeshkës së Gramës - përfundoi dekani. Edhe unë kam besim të madh se një ditë do ti vijë radha dhe këtij gjeomonumenti, kësaj dukurie të rrallë me rëndësi botërore të gjeologjisë Shqiptare.

Pas Hirisimit arrijmë në fshatin Cerjan. Për të pushuar pak, sa për të pirë një kafe, sipas zakonit të Dibrës i ftoj në shtëpinë e mikut tim Mexhit Paci, një personalitet i kohës, një filozof i fjalës së lirë në odën dhe mexhlisin dibran. Nuk kundërshtuan. Ishte mese normale dhe në kohën e duhur. U futëm me radhë të gjithë. Për fat, në atë buzëmbrëmje, ndodhej aty dhe goca e hallës time e martuar me djalin e Mexhitit. Ajo banonte në Qytetin e Peshkopisë por, vinte herë pas here për ti parë prindërit e burrit. Në atë kohë ato akoma jetonin në Cerjan, pasi më vonë dhe ata zbritën në Peshkopi për banim. I prezantova një nga një mysafirët.

Faleminderit shumë mik, mu drejtua mua zotni Mexhiti, ma mbushe shtëpinë me njerëz të ditur. Njerëzit e ditur –vazhdoj ai -apo profesorët a shkencëtarët siç i thërrisni Ju, janë afër Zotit, më shumë se Pejgamberët. Po na e bën qejfin si shumë – e mori fjalën në bisedë Dekani por pa u pozicionuar me besimin që shpaloste zotni Paci. Në fenë që besoj unë, vazhdoj përsëri zotni Mexhiti, njerëzit e ditur dhe dituria kanë vlerësime maksimale. Më bëhet qejfi shumë që djali i mikut tim, Veseli, bashkëpunon me Ju. Shpesoj se do të këtë sukses në punë në Korab në se do të vazhdoj të këshillohet me njerëz të mençur dhe ekspert (këtu ai kishte parasysh mysafirët). Ndërsa kushërira ime, Semihaja, po na shërbente kafenë, muhabeti sikur ndizet pak. Në bisedë futet dhe flokëbardhi Bushi. Dakord zotni Mexhiti. Ato që thoni Ju janë më se të vërteta. Ndonëse ne nuk e lidhim problemin me fenë, besojmë tek natyra dhe mrekullitë e saj. Njeriu nuk duhet ta hedhë farën në tokën që nuk mbin, nuk duhet të qëndroj me ato që nuk dinë të çmojnë veten dhe duhet të ketë frikë nga ai që nuk ka frikë as natyrën. Bukur, bukur e the or matjanë, ju drejtua zotni Bushit – Mexhiti. (Vite më vonë do të më thoshte se ai flokëbardhi e besonte zotin dhe me natyrën ai Zotin nënkuptonte, por kishte frikë ta thoshte). Pasi e pinë të gjithë kafenë, profesorët kërkojnë leje. Mexhiti na ftoj të rrinin për darkë. As për të fjetur mos kini merak. Nuk jemi, as në çadra dhe as në male, ju drejtua të gjithëve duke buzëqeshur. Dhe për veturën e Sufës kemi vend. Mysafirët pasi e falënderuan për të gjitha, u takuan me njerëzit e familjes dhe në fund edhe me Mexhitin. U ndanë me dashuri me të, sikur të ishin njohur prej vitesh. I tillë ishte ai njeri, i zgjuar dhe bujar. Kur Mexhit Paci do zbriste nga Cerjani e të banonte në Peshkopi, në qytet, do ta takoja më shpesh. Midis të tjerave, në ato takime më ka mbetur në mendje kjo thënie: Sa kohë që njeriut i venë mysafirë në shtëpi, qoftë dhe në çadrat e tua, është mirë. Po tu rralluan mysafirët, punët nuk i ke mirë. Fjalët e tij ishin fjalë zemre dhe domosdo do të preknin edhe zemrën time.

Në orën e caktuar shoferi na kishte dalë përpara. Zotni Musa Hoxha, poqese nuk e ngatërroj emrin, e kishte larë e pastruar mirë e mirë makinën, dhe priste në gatishmëri të plotë në vendin e duhur. U përshëndetëm me të, të gjithë, dhe u futëm në makinë. U rehatuam dhe u nisëm. Sufa, pasi u përshëndet me të gjithë duke buzëqeshur, u nis në një drejtim tjetër me veturën e tij, në një rrugë më të shkurtër. Kështu u mbyllë kjo marshutë e gjatë dhe e lodhshme, por e paharruar. Të nesërmen na priste një marshutë tjetër.

** Autori i shkrimit mban gradën shkencore "Doktor", dhe është punonjës shkencor në Institutin e Gjeoshkencave, Universiteti Politeknik i Tiranë*

Letra që Kol. Shefki Shatku, Komandant i Përgjithshëm i Xhandarmërisë i dërgoi Mbretit Zog, mbi veprimtarinë e komunistëve në Shqipëri.

Çfarë dinte **MBRETI ZOG** për veprimtarinë komuniste në Shqipëri?

Dokument i pa botuar i dt. 05.10.1936 (Komanda e Përgjithshme e Xhandarmërisë, Tiranë)

Nga: **SAIMIR SHATKU ***



Nalt Madhnija e Tij, Zog I dhe Komandanti i Përgjithshëm, Kol. Shefki Shatku

Duke iu referuar Arkivit Qëndror të Shtetit Shqiptar, në fondin nr.658, dosja nr. 4, fleta 1-8 e vitit 1936, na jep të dhëna mbi veprimtarinë ilegjitime dhe të fshehtë të propagandës komuniste në Shqipëri. Ndër të tjera të dhënat që serviren tregojnë fleksibilitetin dhe aftësinë e lartë të Xhandarmërisë në periudhën e Mbretërisë Shqiptare, për të parandaluar, goditur dhe penguar përhapjen e këtyre grupimeve famëkeqe në Shqipëri. Komandanti i Përgjithshëm i Xhandarmërisë së Mbretëris Shqipëtare, Kol. Shefki Shatku, i drejtohet me këto fjalë Mbretit Zog, më dt. 5.10.1936, duke i analizuar ndër të tjera gjëndjen e situatës së përhapjes së komunizmit në qytetet Shqipëtare, dhe se kush ishin pjesmarrës në këto grupime. Ndër të tjera letër-raportimi fillon me këto fjalë protokollare:

Nalt-Madhni !

Kam nderin e lartë t'i parashtroj Nalt-Madhnisë së Juaj, hetimet që kam zhvilluar mbi jetën dhe tendencat e djalërisë. Propaganda komuniste po ndjehet mjaftë në rrethet e djalërisë, por jo deri në atë shkallë të anarkizmit dhe të revulucionizmit. Fakti është se kjo propagandë ka filluar të rrënjoset në formë letrare, dhe kryesisht në literaturën artistike. Krerët e këtyre organizatave këtu në Mbretëri, duke parë pamundësinë e një lufte të deklaruar idesh anarkiste dhe duke vënë re, se një organizatë e fshehtë nuk do të kishte jetë të gjatë nga survejimet e vazhdueshme që u bëhet , vendosën që të pranojnë leteraturën si mjet të vetëm propagande, që kështu të arrijnë qëllimet e tyre. Vihej re nga shërbimet sekrete të Komandës së Xhandarmërisë, se pjesa më e madhe e aktivistëve komunist ishin të rinjë të cilët ishin bërë komunist si një " modë " e kohës, por dhe duke u manipuluar nga kundërshtarët e mbretërisë dhe pseudointelektualëve te cilët kundërshtonin politikat e mbretërisë Shqiptare. Mesa duket të rinjtë komunist kishin rënë viktimë e ideve që shpalosnin në ato kohë grupe të caktuara shoqërore të cilat kundërshtonin mbretërinë dhe donin një sundim tjetër në vënd. Kjo vihet re në vazhdimin e letrës që Kol. Shefki Shatkut, i raporton Mbretit zog, në vitin 1936. Ndër të tjera thuhet se: Dhe kjo mënyrë propagande ka filluar të japë frytet e saju duke u shtuar në djalërinë e shkollave të mesme, për të cilat thonë se 80% e tyre kanë rënë viktimë e kësaj letërsie komuniste. Në analizën që Kol. Shatku, i bënë situatës së përhapjes së ideologjisë komuniste në Shqipëri, i parashtron Mbretit Zog, se kjo lëvizje ka karakter letrar dhe kulturor, por është përhapur gjerësisht në disa rrethe letrare dhe pamfleta të kohës. Letër-raporti tregon se këto lëvizje janë të përçara dhe janë tërsisht në kontrollin tonë, por përderisa janë disa lëvizje ato mund të kthehen në një rrezik dhe kërcënim për mbretërinë. Raporti i Komandantit të Xhandarmërisë, Kol. Shefki Shatku, përmbante dhe revistat dhe librat të cilat ishin me ideologji komuniste. Për shembull: Revistat " Flaga ", "Rilindja ", si dhe librat " Ne burg " dhe " Nëna " të shkrimtarit Maksim Gorgi dhe të përkthyer nga Tajar Zavalani, ishin mjetet më me zë të kësaj propagande. Ndër të tjera raporti i drejtuar Mbretit Zog më, 5.10.1936 ka hetuar me imtësi dhe vëndet dhe prefekturat e përfshirjes së këtyre lëvizjeve komuniste. Kështu Prefektura e Korçës, ajo e Tiranës, klasifikohen nga hetimi sekret si zona me një shkallë të lartë të lëvizjeve komuniste, kurse gjëndja parashikohet jo shumë shqetësuese në Prefekturën e Vlorës, e cila është quajtur në këtë raportim si " shkallë e dytë e veprimtarisë së organizatave komuniste ".

Kol. Shefki Shatku, e informon ndër të tjera Mbretin Zog, se kjo djalmëri komuniste është e organizuar dhe e përfshirë në tre kategori:

Në kategorinë e parë bëjnë pjesë: Komunistët e vërtëtë apo ideologjik.

Pra në këtë grup bënin pjesë komunistët me ideologji ekstreme, te cilat mernin rolin e organizatorëve dhe udhëheqësve të lëvizjeve komuniste në vënd.

Ne kategorinë e dytë, merrnin pjesë të rinjë që thonin se janë komunista vetëm për modernizëm dhe për tu dukur në publik (reklamista). Pra bëhet fjalë për komunista me emër, që nuk e kanë idenë se ç'përmban kjo ideologji. Ato janë të ushqyer nga forca e masës, dhe e shoqërisë që kanë për të nxitur njëritjetrin për tu bërë komunista për modernizëm, dhe për tu dukur si njerëz që kanë ide të reja në shoqëri. Kol. Shefki Shatku, i quan këto grupime komunistash ne letër-raportimin si " kominista reklamista ", pra i bëjnë reklamë një lëvizje të cilën nuk e njohin në përmbajtje dhe në thelb, se ç'farë rreziku real shfaqë për shoqërinë kjo lëvizje. Në kategorinë e tretë bëjnë pjesë, grupi i të rinjëve që spekulonin duke u hequr komunist për interesa materiale dhe përfitime të tjera sociale. Kështu të rinjtë që mernin pjesë ne këto lëvizje siguronin përfitime dhe në të holla materiale, si dhe kishin mundësi te bëheshin dhe prijës te grupimeve dhe aktiviteteve të ndryshme social-kulturore dhe rretheve politike.

Zonat më të rinjë që kishin këto ide komuniste sipas letër-raportimit të Kol. Shatkut, ishin Prefektura e Tiranës, Prefektura e Korçës, dhe më pak ajo e Vlorës. Kurse në Prefekturat e qyteteve veriore të vëndit si Dibra, dhe Prefektura e Kosovës (sot qyteti Tropojë), po sipas këtij raportimi ato nuk ishin të vëzhguara dhe hetuara. Mbetet ende pikëpyetje fakti se përse Xhandarmëria nuk ushtroj kontroll mbi zonat e Prefekturës së Dibrës dhe atë të Tropojës, ndoshta për faktin se popullata e këtyre zonave e kanë parë gjithnjë komunizmin si një rrezik real për vëndin dhe se gjithashtu popullsia e këtyre qyteteve verire nuk mbështesnin të tilla ideologji famëkeqe, apo mos ndoshta këto zona veriore konsideroheshin si bastione apo mbështetës të zjarrtë të sistemit të monarkisë, dhe të vetë Mbretit Zog. Ndër të tjera Kol. Shatku, fletë për krerët e këtyre organizatave, planet e tyre dhe metodologjinë e fraksinizimit të tyre në dy grupime, dhe përse operojnë në këtë mënyrë. Gjithashu Kol. Shefki Shatku, i parashtron Mbretit Zog, dhe listën e emrave të personave të cilët bënië pjesë në këto grupime komuniste. Ku konstatohen personalitete si: profesorë, mësues, mjek, avokat, tregëtar, zanatçinjë, ish-ushtarak e deri tek studentët.Kështu ai thotë se: " Djalëria apo rinia komuniste, si dhe krerët e saj, ende nuk janë të organizuar dhe të grumbulluar rreth një personi të vetëm, por janë të përçar duke ndjekur secil metodat e veta. Këto grupe janë të ndarë në dy fraksione: Nëri fraksion me qëndër në Korçë, e fraksioni tjetër me qëndër në Tiranë, duke patur secili sipas mendimit tim (thotë Kol. Shefki Shatku), një revistë ose aktivitet tjetër artistik si mjet propagande. Grupi i kryeqytetit, i Tiranës, sipas hetimeve dhe përshtypjeve që dëgjohen, ka si mjet propagande revistën e Branko Merxhanit, e cila do të filloj të dalë këto ditë me titullin " Përpjekja Shqiptare ". Kurse grupi komunist i Korçës ka caktuar si mjet propagande revistën " Bota e re ". Në përfundim të këtij dokumenti raportues, Shefi i Xhandarmërisë së Mbretërisë Shqiptare, Kol. Shefki Shatku, informon Mbretin Zog, me listën e emrave të personave të implikuar në këto lëvizje komuniste, duke i komunikuar se: " Kam bindjen e plotë se këto grupe janë jo vetëm komunist por dhe propogandojnë për komunizmin. Në mbyllje të kësaj letëer-raportimi, Kol. Shefki Shatku nënvizon se " Në Prefekturën e Korçës, thuhet se, ka një shumicë të madhe të kësaj kategorie, të cilët jam duke i ndjekur për t'i zbuluar intesivisht ".

Pra siç duket qartë në këtë dokument-raportim, të vjeshtës së vitit 1936, janë hapat e para të hedhjes së tentakulave të ideologjisë komuniste në vëndin tonë. Pasi infektojë ndjeshëm vëndet e Europës Lindore dhe duke u qartësuar definitivisht pas luftës së dytë botërore, dhe duke e ndarë botën në dy kampe e duke vendosur ndërmjet daj ideologjinë e luftes së ftohtë dhe të një perde të hekurt, e cila do të pëefundonte me një kosto të lartë morale, politike, ekonomike dhe sociale, për një varg shtetesh lindore, fati i së cilës përkojë që të vuante dhe vëndi ynë, për një periudhë gjysëm shekullore. Ky material ka si qëllim të apelojë ndaj qytetarëve shqiptar, që të mos kthejnë më kujtesën e tyre nga e kaluara e hidhur e vëndit tonë, dhe të ndërgjegjsojmë vetveten se e ardhmja e jonë, dhe e vetë kombit tonë është drejtë familjes së vlerave demokratike, dhe të vëndeve të lira. Drejtë Institucioneve, si Nato dhe BE-ja, që vëndi ynë pritet që shumë shpejtë të aderoje ndër këto organizma.


Autori është për studime master në Universitetin e Studimeve të Torinos (Alma Universitatis Taurinensis)

Kush ishte Kolonel Shefki Shatku

Shefki Shatku, lindi në Dibër te Madhe më 19.05.1896 në një familje patriotike e atdhetare. Gjatë kësaj kohe përfundoi shkollën pesëvjecare në Dibër. Pas emigracionit të madh të dibranëve si pasojë e dhunës Serbe të vitit 1912 ai së bashku me familjen e tij transferohet në Turqi. Atje ai perfundon gjimnazin ushtarak " Kuleli " në Stamboll. Pas përfundimit të shkollës së mesme, kryen Akademinë Ushtarake në Stamboll duke u diplomuar në vitin 1918. Emërohet si instruktor i mësimit "armë e qitje" në shkollën e oficerave në Stamboll. Në vitin 1916 mori pjesë në luftrat e Siris, duke u bërë dhe komandant i kompanisë sulmuese. Për shërbimet e shquara u gradua toger. Mori pjesë dhe në te tjera luftime dhe u dekorua tri herë për trimërit e treguara dhe në fund u emërua " Oficer Ordinanc " i komandantit të qëndrës në Stamboll. Në vitin 1920 vjen në Shqipëri për të kontribuar për ruajtjen e trojeve Shqiptare nga pushtimi Serb. Hyri në shërbim me gradën toger. Merr pjesë në luftën e Mirditës, më 13 tetor 1921 ku Shefkiu plagoset nga forcat Serbe. Për merita të veçanta në këtë lëvizje gradohet kapiten i kl. II më 1922. Emërohet në periudhën e Republikës Shqiptare si kryetar i gjyqit politik (1925-1927). Në vitin 1927 gradohet major dhe vazhdoi një kurs aplikimi në shkollën e lartë të luftës në Torino. Kur u kthye në atdhe mori detyrën e komandantit të shkollës së A'spirantavet në Tiranë. Gjatë periudhës së Mbretërisë Shqiptare nga viti 1931 deri në 7 prill 1939 Shefki Shatku u emërua Komandant i Përgjithshëm i Armatës së Xhandarmërisë Shqiptare. I shquar për aktivitetet e tij dhe aftësitë organizative, më 28.XI.1938 mori gradën N/kolonel, kurse në vitin 1933 u dekorua prej mbretit Zog I me dekoraten "Komandor i Urdhnit Skënderbeg". Në vitin 1937 u dekorua prej mbretit Viktor Emanuelit të II T'Italisë me medaljen Oficer i Madh i Kurorës së Italisë. Ishte një ndër anëtarët e grupit nismëtar për kthimin e eshtrave të poetit tonë të madh " Naim Frashërit " në Shqipëri në vitin 1937 së bashku me Ministrin e Arsimit Kombëtar, Shk. e Tij, z.Faik Shatku dhe intelektual të tjerë. Ndërroi jetë në Stamboll ku u përcoll per në banesën e fundit me nderime nga bashkëkombasit e tij Shqiptar.

profil

Filozofi, poeti, diplomati, burri i shtetit, Riza Tefik Dibrani ka hyrë në fondin e kulturës turke dhe asaj botërore.



RIZA TEFIKU - poeti, prozatori dhe filozofi dibran që ka hyrë në fondin e kulturës botërore

Nga: **MOISI MURRA**

Me rastin e 140-vjetorit të lindjes Poeti, prozatori, filozofi i parë turk në kuptimin modern, Riza Tefiku, kishte lindur në vitin 1869 [1]. Ishte i biri i Hoxhë Mehmet Tefikut nga fisi Bylykbashi i Dibrës së Madhe. Hoxha Mehmeti kishte mbaruar kolegjin fetar "Fatih" të Stambollit dhe fakultetin e administratës po në Stamboll. Falë intelektit të tij kishte mësuar vet filozofinë e vjetër greke në atë nivel që u kishte dhënë mësim dhe njerëzve të mëdhenj të Turqisë si Riza Pashës e Reshid Pashës [2]. Ka shumë mundësi, që i biri, filozofi i ardhshëm Riza Tefiku, shkëndijat e para të filozofisë t'i ketë marrë nga i ati, Hoxha Mehmeti.

Mehmet Tefiku ishte martuar me një zonjë nga Cekrezi i qytetit Tsaribrod afër Andrianopojës (Edrenesë). Më vonë, vet Riza Tefiku, do të tregonte me mburrje për origjinën e tij:

Bilmeyen varsa bilsin herkes
Babam Arnavut anam çerkez
(Kush nuk e di, tash le ta dijë
Babanë e kam shqiptar, nënën çekreze)[3]

Diku tjetër ai do ta lokalizonte origjinën e tij në Dibër:
"... Babai është nga Shqipëria
Në Dibër ka lindur vetë,
Nënën e kam nga Çekrezia
Kush s'e dinte kujtim ta ketë..." [4]

Nga këta pak vargje mësohet se Riza Tefiku duhet të ketë lindur në Turqi dhe jo në Dibër siç pohojnë disa autorë. Sepse po të kishte lindur në Dibër, do ta thoshte po me atë krenari, siç dëshmon për babain e tij.

Hoxha Mehmeti, duke qenë njeri i mësuar si dhe nënprefekt i qytetit të Edrenesë, u kujdes që dhe i biri, Rizai, të arsimohej. Shkollën e mesme e vazhdoi në liceun e qytetit të Galata Sarajt, pasi kishte bërë për disa kohë dhe atë të Jodhenjëvet. Mësimet e larta i nisi në fakultetin "Mulkiyyee-i Sultaniyye" për administratë, por më vonë, s'dihet se për ç'arsye e ndërpreu [5].

Në vitin 1890 u regjistrua në fakultetin e mjekësisë e, pas mbarimit u emërua mjek dogane [6]. Pastaj bëhet anëtar i Këshillit të mjekëve të Stambollit. Për një kohë pat ndenjur në Arnautkoi, në shtëpinë e Ismail Qemalit.

Ishte dhe anëtar i organizatës "Itihad ve Terakki" (Bashkim dhe Përparim), por shumë shpejt ra në kundërshtim me drejtuesit e saj, duke e paguar dhe me burg.

Në parlamentin e turqve të ri ishte zgjedhur deputet i Edrenesë, por për shkaqe politike ishte tërhequr dhe kishte kaluar në opozitë. Po këtë vit, 1908 boton vjersha, kritika dhe hyn në "Organizatën e Re Kulturale" që ishte formuar në Stamboll [7].

Riza Tefiku tani e kishte krijuar personalitetin e një eruditi që çmohej. Një gjë të tillë e pat vënë në dukje dhe Mustafa Qemali i cili, në një kartolinë që i dërgonte, më 26 mars 1909, i shkruante: "Kjo kartolinë e thjeshtë, që i paraqitet vështrimit tuaj depërtues, mund të jetë një motiv habie, mirëpo një zemër që mahnitet nga dijet e larta, mund të përfitojë nga dijet kulturore dhe mendojë se mund të përfitojë nga një zotëri si ju, që i keni të gjitha virtytet dhe dijet" [8].

Deri në vitin 1918 u muar, kryesisht, me shkrime dhe filozofi të cilat i botonte në revistën "Maalumat" (Njohinime). Në kabinetin e Damand Ferit Pashës, 1918, caktohet ministër i arsimit e më pas kryetar i komisionit legjislativ.

Mori pjesë në Konferencën e Parisit, më 1919, si i dërguar i posaçëm. Në vitet '20, e gjejmë profesor i filozofisë në Universitetin e Stambollit, por me që nuk ishte idhtar i Revolucionit Kombëtar Turk që udhëhiqej nga Mustafa Qemali, fitoi urrejtjen e studentëve dhe u detyrua të largohet.

Pas triumfit të Revolucionit turk, u largua nga Turqia dhe u rikthye pas vdekjes së Ataturkut, më 1943, duke qëndruar plot 20 vjet n ëmërgim.

Filozofi dibran, Dr. Riza Tefiku, botoi një seri veprash si: "Abdyl Hak Hamid ve mulahazati felsefijesi" (Abdyl Hak Hamidi dhe mendimet e tij filozofike), më 1913; "Felesefe Dersleri" (Mësime filozofike), më 1914; "Myfessal kamusi Felesee" (Fjalor me hollësi filozofike) në dy vëllime, por që në të vërtetë doli nga shtypi vetëm vëllimi i parë me 1200 faqe në vitin 1914.

Në vitin 1922 me bashkautor Hysejn Danishën, nxorën nga shtypi, të përkthyer nga persishtja, në turqisht "Rubairat" e Omar Kahjamit.

Riza Tefiku botoi dhe një përmbledhje vjershash me titull "Serabi Umruni" (Rrjedhjet e tjetës e time) në vitin 1934 në Qipro, të cilat i ribotoi dhe një herë disa ditë para se të vdiste, më 1949, në Stamboll [9].

Në vitin 1948, botoi në gazetën "Jemi Sabah" (Mëngjesi i ri) kujtimet e tij me titull "Të flas pak dhe unë".

Pavarësisht nga larmia e shumtë e veprave, Riza Tefiku, njihet si themelues i filozofisë moderne turke. Me shumë interes është studimi, interpretimi dhe klasifikimi i pikëpamjeve filozofike të Hasan Tahsinit, në revistën "Shqiptari" të Stambollit, në vitin 1911 që dilte nën drjetimin e Dervish Himës. Duke vlerësuar personalitetin e fuqishëm intelektual të Hasan Tahsinit, diku në numrin një të revistës "Shqiptari", ai shkruante: "... Në qoftë se ky njeri (Hasan Tahsin MM), plot mirësi, nuk mundi t'i shërbente sa duhet dhe si duhet atdheut, ky është dënim i pameritуar i atyre që kanë pasur fatin e keq të kenë lindur para kohe... Ky mendimtar lartësohej me nivelin e epokës" [10].

Filozofi dibran gjykonte se në veprat e Hoxha Tahsinit, kryesisht, në "Psikologjinë" "Ka diçka të rëndësishme dhe është ajo se, në këta vepra liria e besimit qëndron në shkallën më të lartë dhe nuk ndihet aspak erë skolastike..." [11].

Sa qe gjallë, Dr. Riza Tefikun, e akuzuan se kishte rënë në ateizëm e volterjanizëm. Është e vërtetë se ai ishte kundër injorancës dhe fanatizmit fetar, por ama nga pikëpamja e ndërgjegjes gjeti të përshtatshëm bektashizmin, si më tolerantin kundrejt dijes dhe shkencës. Ai u dorëzua myhib nga Edib Harabi, Babai i Teqesë së Merdivinë Qoijit të Stambollit dhe arriti të merrte dhe titullin "Baba". Shkroi shumë poezi të stilit bektashian e një ndër këta pranon si fillesë dorëzimin myhib nga Edib Harabi Babai.

"... Tek qendër e dashuruesve gjeta unë dëfrimin,
Harabit Babait i dhashë unë besimin,
Por si uj' Qevtheri kishte bisedimin,
Unë tashti Parajsës, gëzimit i hyra..." [12]

Edhe Fan Noli e ka vlerësuar Dr. Riza Tefikun. Noli që në planet e tij parashikonte të ngrinte Akademinë Shkencore në Shqipëri, kishte parasysh organizimin dhe drejtimin e saj nga Dr. Riza Tefiku. Noli e donte se filozofi dibran, që njihte tetë gjuhë, të vjetra dhe të reja, do të bënte shumë në këtë drejtim.

Riza Tefiku edhe pse ishte deputet i Edrenesë, mbrojti me guxim më se njëherë çështjen shqiptare në parlamentin turk. Duke folur në një debat parlamentar, në dhjetor të vitit 1910, ndërmjet të tjerave theksonte: Unë u deklaroj të gjithëve... se në çështjen shqiptare nuk ka asgjë reaksionare... shqiptarët thuhet se ecin të armatosur edhe unë kam një; në Paris gjithë popullsia ecën e armatosur, e pastaj? [13].


Dy vjet më vonë ai do të dënonte politikën mashtruese dhe masat brutale të turqve kundër shqiptarëve: "... populli ka ardhur në dëshpërimet e fundit... kurrë s'është derdhur kaq shumë gjak..." [14].

Filozofi, poeti, diplomati, burri i shtetit, Riza Tefik Dibrani, pas një jete privacionesh, vdiq në Stamboll, më 30 dhjetor, ditën e premte, të vitit 1949, duke lënë një korpus veprash me vlerë, që kanë hyrë në fondin e kulturës turke dhe asaj botërore.

Referencat

1) Hasan Kaleshi, "Kontributi i shqiptarëve në diturinë islame", Prizren 1922, f. 12).
2) Baba Rexhepi, "Misticizmi islam dhe bektashizmi", Tiranë, 1995, f. 280.
3) H. Kaleshi, vepër e cituar, f. 12.
4) Baba Rexhepi, vepër e cituar, f. 280.
5) H. Kaleshi, vepër e cituar, f. 36.
6) Po aty.
7) Baba Rexhepi, vepër e cituar, f. 218.
8) Enver Neziri, "Riza Tefiku, filozof me origjinë shqiptare", në gazetën "Kosova", 27 tetor, 1991.
9) Baba Rexhepi, vepër e vituar, f. 282.
10) Revista "Shqiptari", Stamboll, nr. 1, viti 1911.
11) Po aty.
12) Baba Rexhepi, vepër e vituar, f. 283.
13) Gazeta "La Nazione Albanese", nr. 23.15 dhjetor 1910.
14) Gazeta "Dielli", nr. 132, 11 janar 1912.

Janë në qarkullim nga shtëpia botuese "M&B"




Botimet "M&B"
ISBN 978-99956-04-19-6
Çmimi: 700 lekë

Mund ti porosisni
me tel:
+ 355 4 2 233 283

Botimet "M&B"
ISBN 978-99956-04-12-7
Çmimi: 1000 lekë






Botimet "M&B"
ISBN 978-99956-04-14-1
Çmimi: 500 lekë

Mund ti porosisni
me email:
mbbotime@gmail.com

Botimet "M&B"
ISBN 978-99956-04-13-4
Çmimi: 1200 lekë



BËHUNI PJESË E GAZETËS!
www.dibra.org

"Për çdo oroe që i bahet këtij punimi, përpiluesi ka me u gëzue, pse kështu dalin në dritë sende që s'ka mujtë me i ditë".



Bleta jep mjaltin dhe mbron mjedisin

Në organizim të Shoqatës Bletare "Apikultura"- Dibër e Madhe dhe me mbështetje financiare të Qeverisë së Maqedonisë dhe pushteti vendor, më date 1 mars 2009 në Dibër të Madhe , u mbajt seminari me temë "Edukimi i bletarëve për të qenë konkurues në tregun e Unionit Evropian". Në këtë seminar merrnin pjesë bletarë dhe udhëheqës të shoqatave të bletarëve nga Maqedonia, Shqipëria dhe Dibra e Madhe .

Argëtim Fida, kryetar i komunës së Dibrës Madhe , duke përshëdetur të pranishmit, theksoi se,"Ndërsa bletaria dje paraqiste hobi, sot bletaria është bërë pasion me leverdi finaciare.Si pushtet vendor ne po angazhohemi maksimalisht tu ndihmojmë bletarëve tanë për aplikime në drejtim të fitimit të subvencioneve të ndryshme".

Prof.Dr. Hrisula Kiprijanova paraqiti temën "Bletaria organike", duke spjeguar shkencërisht kriteret dhe mënyrën e prodhimit, kontrollit, depozitimit dhe certifikimit të mjaltit organic. Ajo më tej shtoi se,"për të prodhuar mjaltë organik bletët nuk duhet të ushqehen me ushqimin konvencional, ato duhet vendosur larg zonave industriale, deponive dhe ndotësve tjerë.Këto bletë duhet të jenë larg spërkatjeve, të jenë nën kontrollin e vazhdueshëm të inspetorëve përkatës gjatë procesit të prodhimit të mjaltit , shitjes dhe që sëmundjet te bletët të trajtohen me medikamente natyrale".

Ass.Magjistër Aleksandër Uzunov, trajtoi temën "Mbarështrimi i bletëve në stinën pranverore". Ai shtoi se në Maqedoni ka 10 mijë bletarë me afër 20 mijë familje bletësh ku prodhohet 1300 tonelata mjaltë, ndërsa konsumi vjetor I mjaltit është 300 gram për frymë.Ai edhe praktikisht nëpërmjet kosherve dhe kornizave demonstroi mënyrën e trajtimit të bletëve gjatë dimërimit dhe në pranverë, duke shtuar se,"për të qenë më efektiv është e nevojshme gjatë tërë vitit të ndiqet dinamika e zhvillimit të bletëve, të ushqyerit, ajrosja, lagështia dhe mbrojtja nga sëmundjet".

Mr. Maksud Kërluku, foli për temën "Hapat që duhet të ndërmerren për eksportin e mjaltit në Unionin Evropian", duke vënë theksin në rritjen dita ditës të prodhimit të mjaltit në botë.A me këtë rast foli për procedurat, mënyrën e menaxhimit të shitjes së mjaltit në Evropë me respektimin e kritereve dhe standardeve specifike të vënies në praktikë të planit rezidual të prodhimit të mjaltit të pastër ekologjikisht.

Prenk Pepa, kryetar i bletarëve të Shqipërisë, foli për rëndësinë e këtyre takimeve në shkëmbimin e përvojave dhe në thellimin e bashkëpunimit në tërë rajonin, sepse sipas tij bletaria përveç përfitimeve financiare luan rol të rëndësishëm në shëndetin e njeriut nëpërmjet përdorimit të mjaltit dhe standardeve në ruajtjen e ambientit.

Siç tha Prenk Pepa, në Shqipëri ka 8 mijë bletarë, 170 mijë koshere me bletë, prodhohen 2 mijë tonelata mjaltë, ndërsa konsumohet 700 gram mjaltë për frymë, ndërkaq në vendet evropiane konsumohet deri 2,5 kilogram në vit për frymë.

Me këtë rast nëpërmjet videobimit bletarët nga Shqipëria shfaqën një material shkencor për mënyrën dhe trajtimin e bletëve.

Rexhep TORTE

Pajtohuni
në gazetën
"Rruga e Arbërit"

Tel. (04) 22 33 283.
E-mail: rrugaearberit@gmail.com.
Numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit.
Për ata që duan që gazeta t'ju shkojë me postë në shtëpi, ju lutem konfirmoni në redaksi adresën e saktë

www.**dibra**.org

Qeram Cibaku boton librin "Thanita e Dibrës dhe shpirtëra në qiell"

E PARA FJALË E THËNIES...

Nga: **QERAM CIBAKU**

Thatina e Dibrës ose Sohodolli, shtriqet ndër gushën shkëmbore të gjipseve damarhinjtë të Vranj's, mbi troje pellazgjike-peneste, që fshikulloheshin mizorisht nga erërat e forta të veriut, veçmas në dimër. Tamam peizazh interesant natyror me kolazhe malesh të vithisur, ku infiltrojnë rrafshina të begata e lugina që rrëshqasin pjerrtas e butë, duke ekspozuar format përballë kaltrinave fundosëse të ujërave akull, rrëmues e shkumëbërës, ballas gurësh të lëmpitë... Sohodolli-vise e kumte të mbrujtur me ajete kuranore, me rite pagane, klasicizëm e iluminizëm tokësor .

Një falangë rrjepacake malli, më ndez e më përplas në ato vise ngahera, ndaj si pelegrin i bindur zbatoj dogmën rituale të përuljes për dheun e shenjtëruar, ku prehen e dergjen qetueshëm eshtrat e të dashturve të mi. E pra, ky qenka dheu që turbullon njeriun.

"**Përsa kohë që vete e vjen nëpër vendin tënd të lindjes,** të duket se rrugët janë të rëndomta, se dritaret, pullazet e dyert nuk janë asgjë për ty, se muret janë të huaja, se pemët janë pemët e para që të zë syri, se shtëpitë ku ti nuk hyn s'kanë të bëjnë me ty, se pllakat e rrugës ku ecën janë gurë.

Më vonë, kur nuk je më aty, atëherë e kupton se këto rrugë janë të dashura, se ke mall për këto pullaze, këto dritare e këto dyer, se këto mure të janë bërë të domosdoshme, se këto pemë janë të dashurat e tua, se në këto shtëpi ku nuk hyje, në fakt kishe hyrë përditë dhe se në këto pllaka të rrugës ke lënë një pjesë të trupit, të gjakut dhe të zemrës sate. Të gjitha këto vende, që njeriu s'i shikon më, që nuk do t'i shikojë ndoshta kurrë dhe për të cilat ruan ninëzën në kujtesën e vet, marrin një hijeshi të dhimbshme, i rikthehen ndër mend me melankolinë e një fanitjeje, ia bëjnë tokën e shenjtë, të dukshme dhe janë, madje, si të thuash vetë fytyra e atdheut;ti i do e i sjell ndër mend ashtu siç janë, ashtu siç ishin, dhe ngul këmbë në këtë gjë dhe nuk do që të ndryshohet asgjë, sepse me fytyrën e atdheut ti je i lidhur si me fytyrën e nënës"[1].

Ndaj malli, si meridian i tharë, qepet në tambarin e stoftë të të lindurit-atë-vend. E përpos pluhurosjes bezdisjellëse që mërzit kalimtarin, shtyj shkallaren e zhegut e mësyj gjithë shkulm të përpij murrizat erëmirë e jeshillëkun e pasos.

* * *

Teksa përmblidhesh me ngut, të hedhësh në letër rreshta për vendin e lindjes-pasaportën kapistall që s'të shqitet në të gjallë!, indin dimension te identitetit farefisnor -["ID Atë"], strukesh nga dilemat e rrapëllimat oshëtuese mitike, që gulojnë prej honeve të unit dhe shquan: aureola gëzimesh e zizime gjamash, që tkurren nga një membranë imcake fati. Përmendesh, vjen në vete dhe bëhesh tokësor se ty, të teprojnë të tuat halle, por prapë dridhesh nga lëngata e zërit kufi.

E, atëherë ti, i i kapur nga ndërshtypja e brendshme, zvetënon heshtjen mistrece, kthen fytyrën nga identiteti yt. Gjithçka: një rrotëqerreje që rrokulliset nga agu në ag, një shumatore sferike; këtu datohen e daltohen simbolikat: rracë + zakon + pushkë + qiri + parmendë + qefin!



Një falangë rrjepacake malli, më ndez e më përplas në ato vise ngahera, ndaj si pelegrin i bindur zbatoj dogmën rituale të përuljes për dheun e shenjtëruar, ku prehen e dergjen qetueshëm eshtrat e të dashturve të mi.

Botimet "M&B"
ISBN 978-99956-04-28-8
Çmimi: 500 lekë

Enkas, ngul bërrylat mbi makthin tahmaqar e diz'harmonik të fatit, zgjat qafën ku je strukur në pajtonin e fatit që të shpie kushediseku, e mandaj sundon makthin e frikës sate dhe dalldis si Don Kishot i paarsyeshëm se:Jam gjallë!

* * *

Përkundruall ajkës së legjendave dhe egocentrizmit të personalitetit, rrekem t'u hap sfratin këtyre piklave historie kombëtare e ti fal dritë ketij doracaku (libër xhepi) mbi fshatin Thatinë (Sohodolli i sotëm). Njësyresh, shpresoj se ndofta ky doracak do ta lejojë lexonjësin e vlertë të avancojë dó dije mbi një trevë etno-histroke shqiptare. I ndollëm dokumentet e i mbrujtëm si uji i paktë. Asish, letrat e reja, si mehlemi i degëthanës, do mehledisin plagë të djegies së hershme, por të "pamjekuara ende", sepse pelini politik e ka zeherin djegagjatë, aq sa të dalin "gjaca –sysh"!

Iniciativa vetmitare a fillikate pa ndihmën bujare, esencialisht të vlerësueshme të një plejade të mrekullueshme studiuesish kompetentë e miqsh të devotshëm, në mos shterpë, do të ish' asuksesive.

Kësish, në prolog të rreshtimit mirënjohës, shtrohen për idetë kreative e të pashterra dhe sugjerimet pa kursim Prof. As. Dr. Adem Bunguri, Prof. Dr. Ferit Duka, Prof. Dr. Nuri Abdiu, Dr. Agron Tufa, etj.

Veçanërisht shkojnë falenderime të sinqerta kah ekspertja dinjitoze e Sizmologjisë, znj. Shpresa Shubleka, që me gatishmëri kontribuoi në mbushjen e oazit të informacionit shkencor sektorial.

Për qasjet e këndvështrimet specifike, orientimin bibliografik e idetë e vlerëta, padyshim u shpreh mirënjohje studiuesve dibranë Iljaz Kaca, Moisi Murra, Luan Kaba, Moisi Kamberi e Xhemal Domi, punonjësve të shtypit Fatos Daci e Shaqir Skarra dhe përgjegjësit të zyrës së gjendjes civile pranë Prefekturës, z. Arif Dauti etj.

I bindur, se pa shqipërimin nga turqishtja dhe osmanllishtja të disa fragmenteve të Defterit Arvanid nga Anisa e Ramadan Çipuri, diçka do të mbetej e pathënë, prandaj e çmoj fort ndihmesën e tyre miqësore.

I cilësuar, e krejt i veçantë është kontributi i z. Sefedin Xharri, ish-arsimtar e studiues i historikut të Sohodollit. Me durim ai ka mundur të mbledhë në një dorëshkrim materiale mbi ngjarje, kujtime e hulumtime historike, gojëdhëna ndër mexhelise e konaqe burrash, nga Oda e Sohodollit gjer në vitin 1988. Sinqerisht, i shpreh mirënjohje!

Pa më të voglin dyshim, kryerreshti i mirënjohjes i përket z. Shuaip Methasani, kulmari i parë që i fali gjithë suitën e dritës kësaj treve fisnike lirie, përmes botimit në vitin 2004 të monografisë me karakter etno-folklorik "Sohodolli i Dibrës", për fshatin që quhej "Thatina"!

* * *

Një libër qep kapilarët e kujtesës fragmentare të civilizimeve, paçka se shkronjësi i tij asnjëherë s'arrin të mbledhë e ngjizë vetëdijshëm gjithë këto vena e aorta komunikimi.

Gjithqysh, e ushqej mendimin se plotësimet për detaje të pashkelura dhe arsyetimet më të kujdesshme, i ndihmojnë ribotimit të mëvonshëm të tij. U lutem gjeneruesve të rinj ideorë, t'i postojnë idetë avangardë që e bëjnë më të realizuar këtë bukë idesh, në adresën elektronike: qcibaku@yahoo.com. Kam dëgjuar se "më ngushtë në këtë botë virane bien njeriu i mirë kur rrethohet nga njerëz të këqinj dhe librat që nuk lexohen kurrë".

* * *

Fjala e parë e thënies (rreth qenies), më qëllon e patakatë, pa huajtur argatë, tempujt e dy mendimtarëve, visare shqiptare.

-Andaj mora borxh fjalët e **Haxhi Shkozës**, Inspektorit të Oborrit Mbretëror, i cili kur shkroi në vitin 1935 studimin "Financat e Shqipërisë" cektas shënon se:

@ "Tue lutë këndonjësin të më falin për mungesat që prej gjansisë së landës , kanë mujtë me më kalue, uroj që ky libër të plotësojë, qëllimin e tij modest. . . "

-Pinjolli i familjes së gazullarëve, **Dom Nikollë Gazulli**, teksa i linte në dorë lexuesit fjalorin e gegnishtes, modestish vuri këtë shënim përmbyllës:

@ "Për çdo oroe që i bahet këtij punimi, përpiluesi ka me u gëzue, pse kështu dalin në dritë sende që s'ka mujtë me i ditë".

(Marrë nga libri)

skica

Aktorit te sajë, njeriut, i bie per pjesë te loz rolin e të zgjuarit, të të varfërit, të të pafatit etj. E ai a është idetyrur që në skenat e jetës ti luaj ato natyrshëm apo si ja dikton mjedisi natyror, shoqëror apo ekonomik.

Ndahet nga jeta historiani Rakip Sinani

Këto ditë u nda nga jeta, Rakip Sinani, një nga shokët tanë më të mirë , një nga dibranët më të vendosur që ju përkushtua Dibrës dhe historisë së saj, një ushtarak që derisa doli me nder në pension shërbeu me devotshmëri për mbrojtjen e atdheut.

Rakip Sinani lindi në Smollik të rrethit të Dibrës. Mbas studimeve të para kreu shkollën e mesme pedagogjike. Shërbeu si mësues për disa vjet në fshatrat e Gollobordës. Gjatë shërbimit ushtarak eprorët vunë re aftësitë e tij organizuese dhe e dërguan në Shkollën e Oficerëve ku u diplomua si oficer artilerie.

Shërbeu për vite të tëra në repartet e artilerisë në Bulqizë dhe Peshkopi, në Degën Ushtarake etj.

Por krahas detyrës së tij si oficer ai ju kushtua edhe një pasioni të veçantë studimit të historisë së artit ushtarak dhe të historisë së Dibrës..

Ai botoi dhjetra artikuj në gazetat dhe revistat e vendit si në gazetat "Ushtima e Maleve" "Dibra" Rruga e Arbërit" "Luftëtari" "Ushtria" , në revistën "Për mbrojtjen e Atdheut " etj.

Shtëpia Botuese e Ushtrisë botoi librin e tij "Betejat e Skënderbeut" , ndërsa studimet e tij për Dibrën i përmblodhi në librin e tij "Dibra dhe dibranët".

La në dorëshkrim shumë libra të tjerë si dhe shumë artikuj.

Me humbjen para kohe të Rakip Sinanit, Dibra humbi një historian shumë të mirë të saj që e thoshte me plot gojë të vërtetën dhe me fakte historike. Historiografia humbi një studiues të saktë dhe të devotshëm.

Sakip Cami

Ngushëllim

Redaksia e gazetës "Rruga e Arbërit" u shpreh ngushëllimet familjarëve dhe miqve të z. Shehat Marku.
Ai ka qenë një mik i mirë dhe një bashkëpunëtor e lexues i rregullt i gazetës.

(Vijon nga numri i kaluar)

Skica nga Selman Meziu

MATURIA

Çështë nënë si të gjitha nënat. Ka kënduar këngën e Duçes imperator kur në moshën nëntë vjeçare, udhëtonte me një anije në ujin e kaltër të Adriatikut. Ishin rreth dhjetë vajza nga ky fshat. Mesuan këngë,, si të gatuajnë e si të duan fashizmin Italian. Ishte viti njëmijë e nëntëqindë e dyzetë. Lufta e dytë botërore kishte ndezur gjakrat e njerëzve të thjeshtë, politikaneve e ushtarëve me gjeneral.

Martohet me shkuesi. Jeta bashkeshortore vazhdon e lumtur. Se amvise e mirë duke bere punët e shtëpisë. Duke mjelur dhentë, dhitë lopën e përpunuar qumështin. Vitet rridhnin si ujët nën urë. Lind nje cucë. Ndërsa kunata bëhet me katër djem e nje gocë.

Fëmija thonë rriet si fieri. E kështu ndodhi vërtetë. Por….

Iu desh të lodhet duke i larë e krehur, mëkuar e arnur rrobat. Duhesh herë pas here të shkonte të shkulte kërcuna për të hapur toka të reja, të gjëlvoshkte misrin e korrte grurin në zhegun vapës së qërshorit. Paguhesh tridhjetë lek për ditë pune. Sa shumë djersë, lodhje po aq sfilitje të shpirtit . Buka e misrit më shëllirë e groshë të zier në vorbë, ishin ushqimi i zakonshëm i familjes. Formula e jetës. Nëna Sibe i mëkoi, edukoi, trajtoi me gjithë forcën e shpirtit të gjithë njëlloji.

Kufijtë u hapën. Forma e pronësisë dhe e marrdhënive ndryshuan. Gocat njëra pas tjetrës martohen. Djemt po kështu. E si bleta kur lëshon në pranverë, doln nga zgjoi. Di kush në Itali, te tjerë ne Greqi, djemve u humbi vula. Pleqëria erdhi e vështir, e trishtueshme, e mërzitshme, me shumë brenga e halle. Ujët e Drinit e Murres, deshmitare shekullore e jetës së njerëzve të këtyre anëve.

Nuk deshironte te leviste nga fshati, blegerima e qingjave, cicerimat e zogjve, vlaga e tokes perbenin simfonine e jets shume vjeçare. Prane oxhakut ajo kerkonte te shijonte jeten, por shpirti i donte e pleqeria i kerkonte qe dikush nga nuset e djemve, ti rrinte prane. Nuk i ngrohesh zemra e as shpirti me tingujt e zerave qe i vinin nga telefoni.

Sëmundia e azmës po i rëndohesh. Vështirësitë për gatim, pastrim te vetëvetes e shrbime te tjera bëheshin çdo ditë e të pamundura. Shpresat i kishte te djemtë e kunatës. E si të veprohesh? Ajo i lajmëron, duke iu thënë që me nje pension kooperative unë smundem të vazhdoi me tej. U kthyen . Filluan bisedimet. Ato ishin tashmë me gra e fëmijë e sicili fliste sipas interesit. Shatin secili e tërhiqte nga vetia. Pas ore e ore shkapetje mendimesh, azgje pozitive. U fut ne mes kanuni. Sa më shumë kalonte koha, biseda bëhesh më nervose, me të bërtitura e deri në sharje. Te gjitha këto e shqetësuan pa mase nënën. Me zemër të thyer e shpirt të këputur, vendosi të ndërhyjë

Ajo mori fjalën, me një qetësi të admirueshme, me gjakëftotësi e maturi, tha se une do marr cucën e cucës, edhe pse ajo vazhdon shkollën. Kjo per tre muaji, djali i vogël të rikthehet nga Italia. . Kështu u tha e kështu u veprua. Dy pika lot i rrodhën nga sytë e futur brënda nga pleqëria e mundimet e shumta. Uli kokën e filloi të marrë frymë me vështirësi. Nje heshtje pllakosi te gjithë. Ç'kohë të vështira për pleqtë e kurbetelinjtë. Jeta një shkolle me prova të shumta, këto fjalë nëna i belbëzoi me zë të ngjirur nga dhimbja që i vinte nga thellësitë e shpirtit të plagosur nga kjo jetë e organizuar në këtë mënyrë.

PALLAT E MALIT TË KRUJËS

Pasi lëmë Fushë- Krujën rruga gjarpëron përmes një gjelbërimi pemësh frutoe e ullinjsh. Ndërsa vilat dykatëshe e shtëpitë i shtojnë peisazhit bukuri emocionuese. Në ecje e sipër papritur, mjedisi humbi të gjelbërtën e thellë, ngjyra e grijtë e një re pluhuri dukesh kudo. Ç'far ndodhi? Inxhinier Muharremi më shpejgoi:Shtatëdhjet ndërmarrje për prodhim, guri, çakulli e çimentoje, punojnë në shpatet e malit të Krujës. Ndërkoh dy çentaura gjigande të ngarkuara po vinin drejt makinës tonë. .

Peisazhi u bë i trishtueshëm. Shtëpi e vila shum të bukura, të braktisura. Çshtë mundi, lodhja, e djerssa çurg e emigrantëve. Nuk shihen as zogjtë në fluturim, as ndonjë tufë me dele e lopë. Gjallesat e natyrës e kishin braktisur shtëpinë e tyre. Sigurisht edhe ndonjë turist i rrall, kur shikon këto''mrekulli,, tmerrohet, largohet i deshpëruar.

Përball na shfaqet nje gropë gjiganteske. Punëtor, skavator të mëdhenj, makineri qe grinin gurin. Nga sipër përmes pluhurit të dendur këto na dukehin si miza përdhese. Këto janë kafshime të përmasave ciklopike. Njeriu që shkatërron. Te tjerë në rrethinat dhe qytetet e Durrësit, Tiranë e deri në Lushnje që ndërtojn rrugë, pallate, shtëpi banimi, karburante etj, etj. . Të kundërtat perballen. E pishnajat gri të mbjelluara në vitet shtatëdhjet vuajn nga nje azëm e tmerrshme. Inxhinier Muharremi bëri projektin e pyllëzimeve me kolegët e zbatoi për disa dhjetëvjeçare. E tashmë në Krastën e Krujës, zgavrat e shkatërrimit të natyrës, plagë gjigande të hapura pa dëshirën e tijë.

Ngjitemi në një kthesë ku shohim një plantacion ullishteje shekullor. Përballë hapet peisazhi bukuri ndjellës i qytetit të gurt me kalanë madhështore. Janë të shumt historianët, shkrimtarët udhëtarët të vendit e të huaj te cilët kane derdhur në letër mendimet e tyre mbi luftërat e Kastrotit të madh e mjedisit përreth. Në këmbë kalojmë rrugicat e kalldrëmta që të çojnë në hyrje të kalas. Mjeshtëria zejtare, me shije të hollë e finesë është derdhur në prodhimet e tregëtareve Krutan. Janë prej bakri,, leshi, druri ullirë, etj. Ndërkoh ndodhemi përballë nje bregu të lart. Mbi të lartësohet kulla e vrojtimit, e muret e kalasë me bedenat e tyre.

Eveçanta ishte, se në gjithë gjatësin ne nje distance një metër e gjysëm ishin ngulur në dhé drurë të trash, Pse vallë kjo ndërhyrje? Nuk u desh shumë të kuptohesh. . Plasaritje të bregut në drejtim horizontal e vertikal, kishin detyruar ekspertët shqipetar të thërrisnin një ndërmarrje italiane, për të mbajtur këtë masiv gjigand pa rrëshqitur.

Hedh vështriminn masiveve shkëmbore të malit të Skënderbeut e Krastës së Krujës me qytetin. E pyes veten. Cilën kompani apo shtet, do të thërras Ministria e mjedisit për ti vën pallat që të mbajë në këmbë gjithë këto? Kratere vullkanike të cilët në shekuj do të vjellin vetëm helm, lot, dhimbje e strese . Sembëlltyrë e brezave të papërgjegjshëm. Ç'katastrofë e tmerrshme ekologjike!Breza e breza njerëzish do ta paguajne shume shtrejt këtë masakër të natyrës.

LULEKUQE MBI ASFALT

Nga sheshi Qemal Ataturku, në kryeqytet, të gjitha drejtimet ndarja e rrugëve automobilistike është bërë me shkurren zbukuruese Oleandr. Këto vitet e fundit ka fituar qytetarine tiranse, për vet kërkesat modeste të mjedisit për jetes. Vijat e bardha si shenja për të kaluar njerezit nga njëri krah në tjetrin janë të svenitura. Njerëzit duhet të kalojn përmes degëve të shkujdesura e plotë lule të kësaj shkurreje e të ndodhen në anën tjetër. Makina të madhësive e markave të ndryshme gumëzhijn. Nuk janë të paktë motorrat, biçikletat, tëkerlekat, karrocat etj. Lëvizje intensive. Si në qytetet prendimore. Pse jo!

Ne këto kalime duhet vëmendje e sytë hapur, këto përbëjnë binomin e jetës. Se perndryshe mund te biesh viktime. Arsya se projektuesi inxhinier rrugësh, zbatuesi gjeometër, lulishtari si mbjellës, kane menduar gabimisht! Përse?

Ishte ditë e zakonshme, fund Korriku. Asfalti reflektonte mbi trupin tonë, nxehtësi. Njeriu. qoftë ky burre apo grua, djalë apo vajzë, i ngarkuar me streset e ditës, gabon.

E kështu unë pashë një skene të tillë, ku Gëzmimi u ndodh …. . Dëgjova kërcitje frenash, e rrëshqije gomash . Gjithëçka u paralizua. Britma të dhimbshme që të thernin në shpirt, të djaloshit . Njerëz qe ofshanin, qanin e mallkonin. Ecilin! Gjaku i tijë i dorës e këmbës së majtë skuqi asfaltin. Pranë luleve të rëna të oleandrit rridhte gjaku i purpurt i djaloshit. Më pas sirenat e makinave teë policisë e ambulancës. Vall, përse duhet të ndodh kështu? Sa mund të jenë lule jete të këputura në orë, ditë, javë, po në vite? Vargu i shifrave e tregon këtë, një, pesë, gjashtëmbëdhjetë…

GEOGRAFËT E BRAKTISUR

Në ish ndërtesen e institutit të elektronikës, pran Piramidës, tashmë ndodhet personeli i dy ministrive. Ajo ka një konstrutim modest e me një lulishte që të tërheq vëmendjen për nga ngjyrimet e shumta të luleve. . Ngjitim shkallët, e pastra, prej guri e i kërkojme policit përballë se ku është Instituti i kërkimeve gjeografike.

Ne katin e dytë, kerkoj, me shume dëshir të takoi inventarizuesit e, maleve, kodrave, lumenjëve, përrenjeve fushave e pllajave. Por më kotë. Shtyjë një derë paksa të hapur. Llahtari e vërtet. Dhome pa asnjë mobilje, dritare gjysëm të hapura, dyshemeja e mbushur me letra, te natyrave te ndryshemtë zhubrosura, shkresa, bordoro, gazeta të çara. Pluhuri e gjurmët e atyre që kanë krkuar diçka në këtë katrahu të vërtet. Mbyll, derën, vazhdoi koridorit për të gjetur, doktorët e shkencave, profrsorët, topografët, laboratorin e përgatitjes e shtypjes së hartave, atlaseve etj. Pesimizmi, e ndjesitë e njeriut të pashpres, me shtërnguan në fyt si një ankth i tmerrshëm.

Në ato dyer që gjeta të hapura i njëjti peisazh i hidhur e marramendës, në disa të mbyllura, nuk shihja gjë. Provova fatin e trokita në njërën Pa pritur, nga brënda u dëgjua një zë: Hyrë. E më erdhi nga thellësitë e kujtesës shprehja nxënësit të Galileut, Toriçelit: Eureka (e Gjeta). Trup madh e me një shprehje qetësie në sy e fytyrë, drejtori i Institutit, kishte mbetur si gjenarali që pas një beteje të përgjakshme mbetet pa ushtri. Kur e pyeta: Përse i vetëm? Ai më pergjigjet shkurt: Po transferohemi. Para dy vjetësh mora këtu me njëqind lek volumin e dytë të Gjeografisë fizike. Ndërsa generali pa ushtri më dha volunin e parë nga biblioteka e tijë.

Ne çdo qeveri ky institut nderron zyra. ç'komoditet!c'fare qetesie e kushtesh per te punuar! Qeveritë e pas vitev nëntëdhjetë i trajtojne ata si mos më keq. Zyra me rrota.

Edhe pse geografia historike, ajo fizike, e politike jane ende ne shkronjen ''A,, Nuk ka ende një hartë turistike. Eh, ç'të bësh ndodh edhe kështu.

STUDIO QË VAJTON

Udhëtojm për në Tiranën e Re. Zbresim nga makina. Të shoqërauar nga investitori Grezdanas, economisti Zaim Korsi. I rrëmbyer nga Heroi i Motit të Madh me gjithë forcën e shpirtit, të mençurisë e të forcës së argumentit.

Hym në një studio artistësh. Mbi një skelë, shohim skulptorin e popullit Muntas Dhrami. Përball tijë, shtatoria në perfundim e sipër e shkrimtarit të brezit të viteve tridhjet, Lasgush Poradeci. Artisti skulptor me njeshtrine e tije te derdhjesedaltës i jep jetë krijuesit të poezis, tregimit, dramës etj. Emocionohemi nga kjo madhështi, ngjizje artistike e plastikës së fytyrës e ballit të menduar. Kështu një krijes e tillë të jep jetë, të gjallëron të frymëzon.

Më tej shtatoria madhështore e Gjergj Kastriotit, dyzetëvjeçar, E punur nga skulptori shkodran Sadik Spahia. Duart i ka të baltosura, në fytyren e ballin e gjërë njollëza e pikla, e kështu i mozaikuar ai fillon të na shpejgoi. Se çfar shpreh shtatore gjigande. Stoizmi i heroit, mesazhin që sjell për Dibranët e vetë. Sytë i shkëlqejne nga një krenari e ligjshme. Të ringjallësh një hero qëi dha emrin një shekulli, nuk është e lehtë.

Pozicioni i trupit, shprehja e fytyrës, mënyrae mbajtjes së perkrenares e të shpatës etj. Flet me plot emozion e pathos e sikur ai ta kishte parë heroin në takimin e parë me Dibranët kur kthehet nga Nishi. Secili nga ne japim vlerësime e mendimet tona, sipas shijeve e këndëvështrimit artisiko-historike.

Papritur dëgjojm një bobullim, e zhurmat e pikave te shiut. Por ato i ndjejm edhe, ne kokat tona në trup etj. Ngremë instiktivish kokat lart. Ç'te shohësh në lartësinë mbi dhjetë metra mbulesa prej eterniti, i çarë në figura të ndryshme. . Punëtorët e dy skulptarave filluan ti mbulojnë me shkathtësi ato. Kjo lloji mbulese, prodhon helm, shkakton sëmundjen më te rrezikshme, kancerin. E në botën e qytetëruar me ligje të veçanta eterniti është i ndaluar si material ndërtimi e prodhim industrial. Burrokracia, pakujdesia, mos interesimi ndëshkon heronjt e shkrimtarët e djeshëm dhe artistët e paepur e njerëzit e thjesht të ditëve tona. .

Aktorit te sajë, njeriut, i bie per pjesë te loz rolin e të zgjuarit, të të varfërit, të të pafatit etj. E ai a është idetyrur që në skenat e jetës ti luaj ato natyrshëm apo si ja dikton mjedisi natyror, shoqëror apo ekonomik.

Triumf i vëllezërve Keta, njëri trajner dhe tjetri sportist në Gjermani



Gjetan Keta, bëhet kampion i Gjermanisë në KIK dhe TAJBOKS

Në Mynyh, djaloshi nga Bulqiza ka mposhtur rusin, Nikolay Mertes, duke u ngjitur në podin e fituesit I mbështjellë me flamurin kuq e zi. Në stadium qindra shqiptarë.

Nga: *DEFRIM METHASANI*

Lajmi sportiv me interesant i ditëve të fundit, vjen nga Gjermania, aty ku një tjetër emër shqiptar, bëhet kampion i madh i një vendi me një sport shume të zhvilluar, siç është Tajboksi. 25 vjeçari, Gjetan Keta, që një vit më parë u shpall fitues i një turneu europian zhvilluar në Tiranë, tashmë ka ngjitur shkallët e nivelit të tij, duke u bërë i famshëm në këtë sport, që jo vetëm gjermanët, por në shumë vende të botës, po bëhet nga të parët. Historia e Ketës është tejet interesante, kur mendon djalin emigrant në Greqi, që startoi të bëhej i njohur falë mbështetejes dhe stërvitjes mjaft profesionale, nga i vëllai i tij, Ismail Keta, dikur nënkampion bote dhe kampion në Gjermani.

Vëllezërit Keta, falë një përkushtimi të një lloj krejt të veçante, ia dolën mbanë, pa as më të voglën mbështeteje. Pas Ismailit, që në Gjermani njihet si Jonny Keta, vjen koha e Gjetanit, i cili shpërtheu së fundi, duke fituar përballë një kundërshtari tepër të fortë që mbante prej kohësh titullin më të lartë në Gjermani.

Ndeshja, e transmetuar edhe në stacionet televizive gjermane, ngjalli interes dhe pallati i sportit ishte i mbushur plot. Përgatitja e bërë dhe kurajoja e madhe e këtij sportisti, nuk e shpërdoroi besimin e vëllait-trajner, dhe u shpërblye me kurorën e artë të kampionit.

Gjetan Keta është i peshës së mesme dhe ka fituar bindshëm, duke detyruar jurinë të vendosë menjëherë për verdiktin e superndeshjes së vitit.

Interesant ishte fakti që Keta në krah dhe pjesën e shpatullës, mban një tatuazh me figurën e madhe dhe historike të Shqipërisë, Skenderbeut. Ndërkaq, të gjithë janë befasuar, kur ai është ngjitur në ring, duke shpalosur flamurin tonë kuq e zi dhe ka merituar duartrokitjet dhe entuziazmin e gjithë shqiptarëve të pranishëm.

Tashme, pas fitores, të tjerë emra të mëdhenj, siç ishte rusi Mertes, kanë vendosur të maten me shqiptarin e fortë, që është bërë shumë i njohur në Federatën Gjermane dhe atë Europiane e Botërore.

Me 7 prill, një tjetër sfidë e pret Gjetan Ketën, sepse ai do të ndeshet me një kampion gjerman, i quajtur Kai Gamolla.

Kush është Gjetan Keta?


Është 25 vjeç. Është nga fshati Koçaj i Fushë – Bulqizës. Rrjedh nga një familje shumë fisnike dhe atdhetare. Pasioni për sportin lindi nga vëllai i tij, Ismail Keta, i cili që në vitin '97 shkon në Gjermani dhe starton si sportist në Kik dhe Taiboks. Fillimisht ai nis të stërvitet për hobi dhe kënaqësi trupore në Greqi, ku ishte emigrant. Por duke parë cilësitë e tij, vëllai Ismaili, e tërheq në Gjermani në vitin 2005. Aty nis të përgatitet dhe fillon me sukses të fitojë ndeshje, si amator dhe tani si profesionist. Ka zhvilluar 32 ndeshje, prej të cilave ka fituar 28 dhe ka humbur vetëm 4. Të qënit shqiptar, nuk e ka penguar aspak këtë djalosh të arrijë kulme të tilla. Flamuri ynë kombëtar, është "arma" që asnjëherë nuk e harron ta marrë me vete, qofte në takimet që zhvillohen në Gjermani, por edhe në sfidat e rangur europian, apo botëror. Në kampionatin e fundit botëror, është renditur në 16 më të mirët e botës dhe vetëm nje dëmtim në gju e largon atë nga e drejta për të fituar titullin botëror.

Vëlla dhe trajner

Ismail Keta është vëllai i Gjetanit. Që nga viti 2005, ai është një emër shumë i njohur në federatën gjermane dhe atë europiane. Ismail Keta, që ndryshe njihet edhe me emrin Jonny Keta, është shpallur kampion Gjermanie pas vitit 2000 dhe nënkampion bote në vitin 2002. Në Mynyh, ka ndërtuar një Akademi Sportive dhe stërvit 300 njerëz të moshave të ndryshme. Një grup prej tyre, kanë motiv sportin profesionist dhe ai bashkë me vëllain Gjetanin, bën stërvitje me disa nga këta sportisë kurajozë dhe të guximshëm. Ismaili ka qenë i ftuar në disa spektakle dhe emisione televizive në Tiranë dhe qytetin e lindjes, Bulqizë. Thjeshtësia dhe karakteri burrëror, janë cilësi që e kanë ndihmuar në rritjen e personalitetit të tij të padiskutueshëm.

Ndeshja e rradhes per te mbrojtur titullin

Më 4 prill, do të ringjitet në ring. Tashmë për të rimbrojtur titullin e fituar me aq mund, por edhe me dinjitet, falë një epërsie të padiskutueshme me rusin. Në përballjen e radhës, do të jetë një kundërshtar po nga Gjermania. Ai quhet, Kaj Gamolla. Sipas trajnerit Ismail Keta, tashmë titulli do të mbrohet, sepse Gjetani gëzon formën e tij më të mirë në këto vite. Më tej, ai mendon për titullin kampion europe dhe kampion bote.



DIBRA NË SHTËPINË TUAJ

DEBAT - OPINIONE - INFORMACION - DIBRA TV -

Bëju pjesë e komunikimit virtual...

www.dibra.org

Në këtë faqe mund të gjeni gjithë arkivin e gazetës "Rruga e Arbërit"